

ANALIZA E SITUATËS SË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE NË SHQIPËRI

Qershor 2021



Autorët:

Kevin Byrne, Ilir Gedeshi dhe Eliona Kulluri

Redaktimi:

Iain F Wilson

Dizenjimi Grafik:

Grid Design

Falenderime të veçanta nga autori kryesor, Kevin Byrne:

Ky raport nuk do të ishte realizuar pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e stafit të UNICEF Shqipëri, veçanërisht Elda Denaj, e cila mbështeti mbarë procesin. Një falënderim i veçantë shkon për partnerët vendorë, Ilir Gedeshi dhe Eliona Kulluri, të cilët kontribuan në këtë proces me njohuritë dhe përvojën e tyre të pasur. Së fundi, falënderimet shkojnë edhe për të gjithë informuesit kyç, të cilët shpenzuan kohën e tyre, jo vetëm për të siguruar të dhëna dhe informacione, por edhe për të shkëmbyer përvojat, mendimet dhe pikëpamjet e tyre. Për këtë arsye, ne jemi përpjekur të respektojmë konfidencialitetin e tyre, dhe jemi rezervuar që të mos bëjmë falënderime personale për ta në këtë raport.

SQARIM

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo pikëpamjet e UNICEF-it.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materialin e këtij raporti në botimet e tyre. Si zotërues i të drejtave të autorit, UNICEF Shqipëri kërkon citimin përkatës dhe një kopje të botimit.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:

Zyra e UNICEF-it në Shqipëri

Rruga "Skënderbej", Godina e OKB-së, Kati i tretë

Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 4548400

Email: tirana@unicef.org

Citimi i rekomanduar:

Byrne K., Kulluri E., Gedeshi I., 2021. *Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Adoleshentëve në Shqipëri*. UNICEF Shqipëri, Tiranë



ANALIZA E SITUATËS SË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE NË SHQIPËRI

Qershor 2021

Përmbajtja

	Përmbledhje e përgjithshme	8
01	Hyrje	12
02	Përmbledhje rreth vendit	14
	2.1 Profili demografik	14
	2.2 Qeverisja dhe Ekonomia Politike	16
	2.3 Varfëria dhe Papunësia	17
	2.4 Profili i Rrezikut Humanitar dhe Përgjigja	18
	2.5 Profili Gjinator	20
	2.6 Mjedisi Mundësues për të Drejtat e Fëmijëve	21
03	Të drejtat e fëmijëve	24
	3.1. E drejta për Kujdes Shëndetësor	24
	3.2. E drejta për mirëqenie	33
	3.3 E drejta për arsimim, argëtim dhe aktivitete kulturore	40
	3.4 E drejta për Mbrojtje, Mjedis Familjar dhe Përkujdesje Alternative	51
	3.5 E drejta për Pjesëmarrje, të Drejta Civile dhe Liri	62
	Bibliografia	64

Shkurtesa

SHLA	Shkalla e Lindjes së Adoleshentëve
SDSH	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri
AFH	Arsimimi në Fëmijërinë e Hershme
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BE28	Vendet anëtare të BE-së
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DHNGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
Eurofound	Fondacioni Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe të Punës
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
GRETA	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
HIV / SIDA	Virusi i pamjaftueshmërisë imunitare njerëzore. Është virusi që mund të shkaktojë sindromën e pamjaftueshmërisë imunitare të fituar/SIDA.
ICMW	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
IPM	Instituti i Politikave Mjedisore
IST	Infeksione Seksualisht të Transmetueshme
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
KB	Kombet e Bashkuara
KKBDF	Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijës
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KKDMF	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor

LGBTI	Lezbike, Gej, Biseksualë, Transgjnorë dhe Interseks
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MP	Mjek i përgjithshëm
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihma Ekonomike
NJQP	Njohuritë, Qëndrimet dhe Praktikrat
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SHASF	Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual i Fëmijëve
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale
RPU	Rishikimi Periodik Universal
SESK	Statusi Ekonomik, Social dhe Kulturor
SMS	Strategjia e Mbrojtjes Sociale
SSHFMSH	Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijët në Moshë Shkollore
SHSFUT	Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve në Udhëtim dhe Turizëm
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TLAS	Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
UNHCR	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

Përmbledhje e përgjithshme

Shqipëria ka bërë zhvillime të mëdha gjatë dy dekadave të fundit, dhe nga një vend i varfër dhe i izoluar ka marrë statusin e një vendi me zhvillim të lartë dhe të ardhura mesatare. Shqipëria ka patur një mjedis relativisht të qëndrueshëm politik dhe rritje ekonomike të vazhdueshme, si dhe është pranuar si një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Vendi është angazhuar në të gjitha traktatet e rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe qeveritë e njëpasnjëshme kanë mbështetur nisma për reforma që kanë synuar kalimin drejt një shoqërie të hapur, demokratike dhe pluraliste. Pavarësisht ekzistencës së kuadrove legjislative dhe të politikave bazuar në të drejta, ato nuk përkthehen lehtësisht në veprime praktike. Zbatimi mbetet pas politikave, dhe barrierat sistemike dhe strukturore ndaj aksesit të plotë në të drejta, veçanërisht për popullatat e cenuseshme, janë akute dhe kronike. **Pabarazia është një element i pandarë i modelit të zhvillimit në Shqipëri.** Rritja ekonomike është shoqëruar nga papunësia, pagat e ulëta, pasiguria në punë, dhe rritja e migracionit të të rinjve. Diskursi për zhvillimin në Shqipëri priret të theksojë pabarazitë ndërmjet qarqeve të vendit, dhe popullatës në zonat rurale dhe urbane, por një nga dallimet më të mëdha në shoqërinë shqiptare vërehet te personat që jetojnë në varfëri dhe ata që nuk jetojnë në varfëri. Varfëria në familje ndryshon nga qarku në qark, dhe hendeku midis kuintilëve të statusit ekonomik mund të luhatet me kalimin e kohës, por **niveli i përgjithshëm i varfërisë është i konsiderueshëm.**

Vlerat e të drejtave të njeriut nuk janë rrënjësor ende në shoqërinë shqiptare. **Shqiptarët shfaqin nivele të larta të mosbesimit tek institucionet qeveritare dhe nivele të ulëta të angazhimit në çështje sociale.** Popullsia shqiptare po plaket dhe normat shoqërore priren të pasqyrojnë vlerat tradicionale, konservatore dhe patriarkale. Kohezioni social është i fortë, dhe komunitetet drejtohen për nga homogjeniteti, **por çdo gjë që konsiderohet 'si ndryshe' në shoqëri, shoqërohet me stigmë.** Familjet rome dhe egjiptiane¹ vuajnë veçanërisht

¹ Ky tekst synon të jetë në përputhje me përdorimin e miratuar të termit rom nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Termi, siç përdoret në dokumentet zyrtare të BE-së, Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), përfshin romët, egjiptianët, endacakët, sintit dhe grupe të tjera që shpesh etiketohen në mënyrë të pasaktë si "ciganë". Për efekt leximi, mbiemri "rom" në këtë dokument iu referohet romëve në tërësi, si grupe, ose si individë (p.sh. fëmijë romë, familje rome), ndërsa "romani" iu referohet gjuhës dhe kulturës. Lexuesit duhet të kuptojnë që përdorimi i termit "rom" nuk synon të mohojë diversitetin midis romëve, egjiptianëve, endacakëve, dhe grupeve të tjera.

nivelet e larta të paragjykimit, diskriminimit dhe veçimit, çka i bën të jetojnë në varfëri dhe të jenë të privuar. Situata me personat me aftësi të kufizuara (përfshirë fëmijët) është e ngjashme.

Përkushtimi ndaj familjes është i fortë dhe familjet (e zgjeruara) tradicionale përbëjnë elementet bazë të strukturës së komuniteteve. Ky aspekt është përgjithësisht pozitiv, por duhet vërejtur se mjedisi familjar dhe komunitar është gjithashtu hapësira ku gruaja vazhdon të nënvlerësohet, dhuna vazhdon të tolerohet, dhe fëmijët vazhdojnë të kenë një status më të ulët nga të tjerët. Perceptimi social i detyrimeve familjare lidhur me kujdesin për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara ul padyshim kërkesën për shërbimet dhe lehtësirat e duhura, si dhe i kufizon gratë brenda roleve tradicionale, duke penguar kontributin e tyre të mundshëm në shoqëri, dhe rrjedhimisht duke reduktuar mundësinë për ndryshim social. **Është e rëndësishme që të bëhen përpjekje të mëdha drejt ndryshimit të normave sociale, sidomos kur flitet për të zbatuar qasje që bazohen në të drejtat e fëmijëve, të cilat lidhen veçanërisht me sfidat për ndryshimin e qëndrimeve publike ndaj romëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe grave e vajzave.** Do të ishte mjaft e rëndësishme që të shfrytëzohej potenciali i grave si drejtuese të komunitetit, duke sfiduar stereotipat patriarkalë ekzistues, duke i dhënë jehonë zërit të grave dhe duke mbështetur në mënyrë aktive drejtimin nga gratë, jo vetëm lidhur me të drejtat e fëmijëve, por edhe me diskursin e zhvillimit kombëtar në përgjithësi.

Emigracioni redukton edhe më shumë kapitalin shoqëror të Shqipërisë. Megjithëse remitancat përbëjnë një kontribut vjetor të konsiderueshëm në thesarin kombëtar dhe ofrojnë një rrjetë sigurie për shumë familje të varfra, largimi i vazhdueshëm i të rinjve dhe të rejave frenon ndryshimin social dhe pengon novacionin, sipërmarrjen e biznesit, angazhimin qytetar dhe zhvillimin e komunitetit, duke përforcuar në këtë mënyrë faktorët nxitës të migracionit për grupin e ardhshëm të nxënësve që do braktisin shkollën. Shumë shërbime, duke përfshirë shëndetësinë dhe arsimin, ndodhen përpara përballjes me kriza të mëdha të mangësive në personel, kur i gjithë grupi i profesionistëve të kualifikuar dhe me përvojë të arrijnë moshën e daljes në pension në shërbimin publik. Ndonëse varfëria dhe papunësia janë padyshim faktorët kryesorë që shpien drejt emigrimit të shqiptarëve, numri në rritje i familjeve që largohen nënkupton se qytetarët nuk besojnë se Shqipëria është vend i përshtatshëm për të rritur fëmijë dhe kërkojnë një cilësi më të mirë jetese për brezin e ardhshëm. E njëjta prioritet negative vërehet në migracionin e brendshëm, që do të thotë se njerëzit largohen nga komunitetet e thella rurale dhe zhvendosen në qyteza e qytete. Urbanizimi në rritje po thëllon pabarazitë rajonale ekzistuese, dhe familjet rurale po izolojnë gjithnjë e më shumë nga shërbimet shëndetësore, arsimore, dhe ato të përkujdesit shoqëror. Nevojitet më shumë punë kërkimore për të përcaktuar faktorët e migracionit, të brendshëm dhe të jashtëm, që nuk lidhen me të ardhurat, në mënyrë që të planifikohet një përgjigje me në fokus fëmijët, e cila mbështet dhe forcon familjet shqiptare, kudo ku ato jetojnë.

Përfitimet e konsiderueshme ekonomike të vendit janë të papërfillshme përpara niveleve të larta të borxhit të huaj, që kufizon investimet sociale. Mesa duket, modeli aktual i zhvillimit industrial nuk është i përshtatur për të zbutur nivelet e larta të papunësisë dhe varfërisë së familjeve, ndërsa struktura aktuale e pagave dhe niveli i lartë i punësimit informal tregojnë se punësimi nuk garanton daljen nga varfëria. Në këto rrethana, është jetike që të rriten nivelet e Ndihmës Ekonomike për familjet derisa, së bashku me përmirësimin e aksesit në shërbime cilësore të kujdesit social, të funksionojë si një instrument i vërtetë i reduktimit të varfërisë. Modeli i mbrojtjes sociale në tërësi mund të ketë nevojë për rishikim, në kuadër të progresit të ngadaltë dhe sporadik të Shqipërisë drejt punësimit të plotë dhe pavarësisë ekonomike, si dhe rritjes së mundshme të nivelit të varfërisë në dy vitet e ardhshme për shkak të COVID-19.

Pengesa më e madhe në praktikë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri është refuzimi i vazhdueshëm i qeverisë për të investuar në shërbimet për fëmijët. Për vite me radhë, qeveritë kanë nënfinancuar shëndetësinë, arsimin, mbrojtjen dhe mirëqenien, duke arritur një nivel nën atë të shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Bashkimit Evropian, si dhe shteteve të tjera në rajon. Kjo prioritet është vëzhguar edhe pas rritjes së Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe pasi Shqipëria mori statusin e një vendi me të ardhura mbi mesataren. Në mënyrë të pashmangshme, kjo mungesë ka shkatërruar infrastrukturën, ka penguar novacionin, ka ulur standardet e cilësisë, ka nxitur korrupsionin në nivele të ulëta të shërbimit dhe ka ulur gjithnjë e më shumë përshtatshmërinë e shërbimeve me qëllimin përkatës. Me shumë gjasë, vitet e ardhshme do të jenë

mjaft të vështira për fëmijët dhe familjet, pasi vendi po përballlet me një rënie të pritshme të PBB-së, si rrjedhojë e pandemisë botërore. Ka gjasa që shërbimet për fëmijët, të cilat nuk janë në standardet e duhura, të kenë vështirësi për të reaguar. **Është e rëndësishme që të garantohet jo vetëm reduktimi i mëtejshëm i buxheteve lidhur me fëmijët, por edhe të përmbysset modeli kombëtar i investimit të ulët për fëmijët, si dhe të mbrohen, të zgjerohen dhe të forcohen shërbimet për ta dhe familjet e tyre.** Është jetike që të ndërmerret sa më shpejt të jetë e mundur një analizë e përgjithshme e buxhetit me fokus fëmijët për të mbështetur përgjigjen, rehabilitimin ndaj emergjencave dhe planifikimin pas COVID-19. Në të njëjtën kohë, pandemia ka nxjerrë në pah kapacitetin e vërtetë të qeverisë për të reaguar, si dhe ka evidentuar qartësisht pikat e forta dhe të dobëta të shërbimeve të ndryshme lidhur me fëmijët.

Një tjetër pengesë afatgjatë për ofrimin e shërbimeve sociale cilësore është progresi i ngadaltë në zhvillimin dhe zbatimin e një modeli decentralizimi koherent dhe konsistent, i cili mbështet autoritetet vendore në përmbushjen e përgjegjësi të tyre të deleguara për të planifikuar, për të prokuruar dhe për të ofruar një portofol gjithëpërfshirës të shërbimeve sociale përkatëse me në qendër fëmijët. Tashmë, bashkitë kanë më shumë përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve, por nuk u janë deleguar ende burimet ose autoriteti për të përmbushur mandatin e tyre. Burimet e disponueshme financiare të njësisë të qeverisjes vendore (NJQV) janë të pamjaftueshme, dhe mekanizmi i fondit social nuk është ende plotësisht funksional. Qeveria qendrore alokon te NJQV-të vetëm rreth një për qind të PBB-së², që është niveli më i ulët në Ballkanin Perëndimor.³ Shumica e bashkive kanë një bazë të ulët taksash, ndaj kapacitetet e tyre për të ofruar shërbime publike cilësore janë të kufizuara, dhe me shumë gjasë do të mbeten të tilla për një kohë të gjatë. Është e rëndësishme që kjo pengesë lidhur me alokimin e burimeve të kapërcehet dhe të krijohen shpejt mekanizmat për të siguruar shpërndarjen e drejtë dhe në kohë të fondeve dhe burimeve të nevojshme, me qëllim sigurimin e ofrimit të duhur dhe të barabartë të shërbimeve për fëmijët dhe familjet në të gjitha bashkitë.

Qasjet e veçara sektoriale e bëjnë më të vështirë planifikimin, zhvillimin dhe menaxhimin në terren të qasjes gjithëpërfshirëse me në qendër fëmijët dhe me kosto efikase. Planifikimi ende pengohet nga mungesa e të dhënave të besueshme, mekanizmat e dobët të koordinimit, dhe konsultimi i pamjaftueshëm me palët e përshtatshme të interesit. Sistemet sektoriale dhe në nivel bashkie për menaxhimin e informacionit jo vetëm që nuk përfitojnë nga investimet e duhura financiare dhe njerëzore, por prodhojnë kryesisht raporte me të dhëna lidhur vetëm me performancën e institucioneve. Nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për situatën e fëmijëve dhe adoleshentëve më të cenueshëm, kjo sjell si pasojë afatgjatë mënjanimin dhe mospërmbushjen e nevojave të këtyre grupeve të fëmijëve.

Mekanizmat koordinues dhe llogaridhënës të dobët dhe mungesa e burimeve të nevojshme për fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor, kombinuar me qasjet e izoluara që ndiqen nga vendimmarrësit dhe profesionistët, dëmtojnë suksesin e masave të ndërmarra dhe ndalojnë dialogun me komunitetet, familjet, dhe palët e tjera të interesit. Komunitetet nuk e kanë plotësisht kulturën e kërkesës ose ankesës, si dhe as shoqëria civile dhe as media nuk janë ende mjaftueshëm të forta për t'i kërkuar llogari qeverisë në nivel vendor ose kombëtar. **Sistemet e kontrollit të cilësisë dhe llogaridhënies vertikale dhe horizontale duhet të forcohen dhe të zgjerohen përmes krijimit të kulturës së hapur organizative, duke u angazhuar në mënyrë aktive për të dëgjuar fëmijët, adoleshentët, dhe prindërit.**

Ndonëse të gjitha palët e interesit e pranojnë nevojën për më shumë koordinim strategjik ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisë, nevoja për të forcuar dhe për të zgjeruar dialogun dhe angazhimin me shoqërinë civile mbetet më pak e përmendur. Megjithatë organizatat jofitimprurëse (OJF) shihen si një ofruar i madh i shërbimeve për fëmijë në nivelin vendor, kuadri ligjor që rregullon aksesin e tyre në financim mbetet i paplotë. Rrjedhimisht, shumica e strukturave të shërbimit social financohen

² Komisioni Evropian, 2019a. *Staff Working Document: Albania 2019*. [Dokument Pune për Stafin: Shqipëria 2019.] Raport DPS, 215, 2019 (në këtë dokument, Progres Raporti 2019). Bruksel, i disponueshëm në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

³ Me Ballkan Perëndimor nënkuptohen Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i zi, Maqedonia e Veriut, dhe Serbia ose kombinime të ndryshme të këtyre vendeve.

nga organe ndërkombëtare nëpërmjet projekteve, dhe ekziston shqetësimi se me anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në BE, financimi nga donatorët do të bjerë në mënyrë të pashmangshme. Qeveria ka ngarkuar Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile me ofrimin e mbështetjes financiare për shoqërinë civile, por është shënuar vetëm progres i kufizuar në zbatimin e Udhërrëfyesit të Politikës së Qeverisë për të Krijuar Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2015,⁴ i cili është dokumenti strategjik që orienton politikën e qeverisë për shoqërinë civile. **Të gjitha strategjitë që synojnë të përmirësojnë dhe të zgjerojnë ofrimin e shërbimeve lidhur me fëmijët duhet të përfshijnë forcimin e shoqërisë civile dhe përdorimin e potencialit të saj, jo vetëm në rolin e kontraktueses, por edhe të novatores, advokueses, sipërmarrëses, dhe vëzhgueses.** Për këtë qëllim mund të nevojitet ripërcaktimi i marrëdhënies së saj me autoritetet statutorë. Krahas kësaj, duke pasur parasysh kufizimet e mundshme financiare për veprime qeveritare gjatë viteve të ardhshme, do të kishte kuptim që **të punohej për të forcuar dhe për të zgjeruar grupime të tjera të mbështetjes për të drejtat e fëmijëve në vend, duke përfshirë sektorin privat** (bizneset).

Për ta përmbledhur, pavarësisht angazhimit real të qeverisë dhe shoqërisë së gjerë ndaj fëmijëve në Shqipëri, mbetet ende shumë punë për t'u bërë në drejtim të realizimit të të drejtave të fëmijëve në vend. Kuadrot e duhura ligjore dhe të politikave kryesisht ekzistojnë, por zbatimi i tyre është penguar nga investimi i ulët i vazhdueshëm në shërbime për fëmijë, si dhe mosalokimi i burimeve dhe kompetencave të institucionet e duhura / përgjegjëse. Kjo ka sjellë uljen e numrit të personelit me përvojë; shkatërrimin e infrastrukturës, pamjaftueshmërinë e strukturave, pajisjeve dhe furnizimit, menaxhimin e dobët, si dhe uljen e standardeve profesionale. Kjo situatë duhet të shihet me ngutshmëri duke pasur parasysh faktin që Shqipëria përballet me kërcënime kritike të fatkeqësive të mundshme natyrore dhe mjedisore, si dhe me rreziqe të shëndetit publik. Për rezultate të menjëhershme dhe afatgjata, shumë elemente do të varen nga gatishmëria e qeverisë dhe palëve të tjera të interesit për të njohur dhe për të trajtuar këto pengesa përmes qasjes me në qendër fëmijën.



@UNICEF Albania Milkani 2021

⁴ Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

KAPITULLI 1

Hyrje

UNICEF Shqipëri e porositi këtë studim për të siguruar një analizë të pavarur të situatës së fëmijëve dhe adoleshentëve dhe të drejtave të tyre në Shqipëri, e cila mund të përdoret nga të gjitha palët e interesit në vend për të identifikuar dhe për të adresuar pengesat dhe mundësitë për realizimin e plotë të çdo të drejte të çdo fëmije. Ky studim synon të pasurojë planifikimin e programeve, advokacinë për politikën, dhe përpjekjet për partneritet të UNICEF-it. Një tjetër synim i tij është të kontribuojë në hartimin e Dokumentit të Programit të UNICEF për Shqipërinë 2022-2026, Analizën e Përbashkët të Situatës së Shqipërisë nga Organizatat e Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe në Kuadrin e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2016 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe OKB-së. Studimi kërkon të kontribuojë në formësimin e agjendës kombëtare për zhvillim dhe të përshpejtojë arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) me barazi.⁵

Raporti ndjek një qasje bazuar në të drejtat e njeriut⁶, e cila përqendrohet te fëmija dhe realizon analiza duke u mbështetur në nenin 1.2 të Konventës të KB për të Drejtat e Fëmijës (KKBDF),⁷ që garanton: “të drejtat e përcaktuara në këtë Konventë, pa asnjë formë diskriminimi, pavarësisht racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, bindjeve politike apo të tjera, kombësisë, origjinës etnike apo shoqërore, pronës, aftësisë së kufizuar, lindjes apo statuseve të tjera të fëmijës, apo prindit ose kujdestarit të tij/saj⁸”. Gjatë shqyrtimit të situatës së të gjithë fëmijëve në Shqipëri, ky raport përqendrohet tek ata më të disavantazuarit.

⁵ Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development Resolution 70/1 adopted by the 70th meeting of the United Nations General Assembly on 25 September 2015 [Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm Rezoluta 70/1, e miratuar në mbledhjen e 70-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 25 shtator 2015], e disponueshme në <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>

⁶ Sikundër përvijohet në Garde M., Parameswaran S., Tso S-YK, et al, 2019. *Core Guidance: New Generation Situation Analysis* [Udhëzime Bazë: Analiza e Situatës së Brezit të Ri], UNICEF, Maj 2019. NY.

⁷ Convention on the Rights of the Child adopted by the General Assembly of the United Nations on 20 November 1989 hereafter ‘the Convention’ or UNCRC [Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, në vijim “Konventa” ose KKBDF]. Për tekstin e plotë, shihni <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

⁸ Shihni Hodgkin R., Newell P., 2002. *Implementation Handbook for the Convention on the Rights of the Child* [Udhëzim për Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës]. UNICEF. Nju-Jork, f. 19–38.



Metodologjia përfshin:

- Shqyrtimin e studimeve, anketave, statistikave dhe të dhënave për legjislacionin, politikat dhe programet e hartuara nga Qeveria e Shqipërisë, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, OECD-ja, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), organet e BE-së, agjencitë e OKB-së, institucionet akademike, OJF-të, dhe burime të tjera. Raporti përfshin të dhëna dhe analiza zyrtare të qeverisë, të mbështetura me evidenca të dokumentuara nga burime të pavarura.
- Intervista gjysmë të strukturuar me informues kyç nga qeveria, shoqëria civile dhe bota akademike, si dhe konsultime me staf kyç nga UNICEF Shqipëri. Inputi nga informuesit kyç u kombinua me të dhëna nga burime të tjera. Asnjë deklaratë në këtë raport nuk mund t'i atribuohet një informuesi të vetëm.

Baza kërkimore lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri është e fragmentuar, jokonsistente dhe e pakrahasueshme. Autorët iu dhanë përparësi studimeve pas vitit 2015, dhe në rastet kur nuk gjetën të dhëna të disponueshme, u mbështetën edhe te studimet e mëhershme. Aty ku ishte e mundur, analiza u kategorizua sipas moshës, gjinisë, dhe etnisë (megjithatë një pjesë e konsiderueshme e të dhënave kombëtare nuk është e kategorizuar mjaftueshëm, sidomos sipas etnisë). Është bërë çdo përpjekje për të arritur një ekuilibër të drejtë midis pikëpamjeve të qeverisë dhe shoqërisë civile, ndonëse koha dhe COVID-19 kufizuan grupin e të anketuarve. Pikëpamjet e prindërve dhe komuniteteve janë veçanërisht të papërfaqësuar mjaftueshëm, ndonëse informuesit për këtë raport folën me ne si prindër dhe qytetarë të shqetësuar, ndërkohë që ruanin rolin e tyre zyrtar. COVID-19 e bëri të pamundur konsultimin e drejtpërdrejtë me fëmijët. Për këtë arsye, raporti u bazua te një shqyrtim i kohëve të fundit i 23 studimeve⁹ rreth qëndrimeve, mendimeve dhe përvojave të fëmijëve, me përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë. Mbledhja dhe analiza e të dhënave për studimin u konceptuan në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me Procedurat e UNICEF-it për Standardet Etike në Kërkim, Vlerësim, Mbledhje dhe Analizë të Dhënash.

⁹ Cuninghame C., 2020. *Child Rights Issues in Child Participatory-Focused Documents – a Short Review*. [Çështjet e të Drejtave të Fëmijës në Dokumentet e Përqendruara te Pjesëmarrja e Fëmijës: Një Shqyrtim i Shkurtër]. UNICEF Shqipëri. Së fundmi, UNICEF Shqipëri ka kryer një shqyrtim të 23 dokumenteve, të botuara në Shqipëri pas vitit 2016 që përfshinin një farë niveli të pjesëmarrjes nga fëmijët, e disponueshme në https://www.unicef.org/albania/media/3421/file/Review_child_views_Albania.pdf. Autorët e kësaj Analize Situata zgjodhën një kampion pas vitit 2015, duke përfshirë “*Children’s World*”—A National Survey of Children’s Well-Being” [Bota e Fëmijëve - Anketim Kombëtar i Mirëqenies së Fëmijëve], Save the Children, Universiteti “Marin Barleti”, 2018. Tiranë; Departamenti i Cilësisë së Ministrisë, World Vision Shqipëri dhe Kosovë, *Baseline & Action Research Report Youth Standing Up for Human Right in Albania* [Raport Kërkimor Bazë rreth Veprimeve, të Rinjtë për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri]. World Vision (2019). Tiranë. Stephenson P., 2018. *Children’s Consultations on Child Friendly Materials Albanian National Child Rights and Protection Law 18 Findings and Recommendations* [Konsultimet e fëmijëve për materiale miqësore për fëmijët Ligji Kombëtar Shqiptar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës 18 Gjetje dhe Rekomandime] UNICEF Tiranë. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, 2018. *Mid-Term Implementation Report of the National Agenda for the Rights of Children* [Raporti i Zbatimit Afatmesëm të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve]. UNICEF Shqipëri. Tiranë.

KAPITULLI 2.

Përmbledhje rreth vendit

2.1 PROFILI DEMOGRAFIK

Popullsia e Shqipërisë në vitin 2021 është 2,829,741 banorë, duke pësuar një rënie të lehtë prej 0,6 për qind krahasuar me vitin 2020.¹⁰ Për qindja e shqiptarëve të grupmoshës 0 - 17 vjeç ra nga 23 për qind në vitin 2016 në 21.2 për qind në vitin 2019.¹¹ Në vitin 2021, grupmoshat përbëhen nga: 5.1 për qind - 0-4 vjeç; 5.7 për qind - 5-9 vjeç; 5.7 për qind - 11-14 vjeç; dhe 6.7 për qind - 15-19 vjeç. Në vitin 2021, përqindja e varësisë së të rinjve (raporti i popullsisë 0-14 vjeç me popullsinë 15-64 vjeç) ra në 24.2 për qind nga 24.6 për qind në vitin 2020, ndërsa përqindja e varësisë së të moshuarve (raporti i popullsisë 65+ me popullsinë 15-64 vjeç) u rrit nga 21.6 për qind në 22.3 për qind në të njëjtën periudhë. Raporti i seksit në lindje është 107, çka do të thotë se për 100 lindje vajzash, lindin 107 djem. Ky raport është më i lartë sesa raporti natyror, që është 105.¹²

Prirja demografike e Shqipërisë pasqyron urbanizimin në rritje: numri i popullsisë në zonat rurale ra me 2.4 për qind në vitin 2017,¹³ e cila është një rënie më e shpejtë sesa ajo e vendeve fqinje ose e BE-së (0.7%), por ruan një bazë të fortë rurale: në vitin 2018, rreth 40 për qind e popullsisë shqiptare jetonin në zona rurale, krahasuar me mesataren e OECD-së prej 22 për qind.¹⁴ Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave (INSTAT), prefektura e Tiranës tani përbën 32.2 për qind të popullsisë së përgjithshme, dhe vetëm Tirana dhe Durrësi panë rritje të popullsisë në vitin 2020, ndërsa qarqet e tjera panë

¹⁰ Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, shifrat janë marrë nga INSTAT-i *Popullsia e Shqipërisë* (1 janar 2021), i disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/media/8305/population-on-1-january-2021.pdf>. Shifrat para vitit 2015 bazohen në të dhënat nga *Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011*. INSTAT, 2012. Tiranë, i disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/en/census/census-2011/census-data.aspx> cituar në Byrne K. *Analysis of policies and reforms affecting the situation of children in Albania* [Analiza e politikave dhe reformave që ndikojnë në situatën e fëmijëve në Shqipëri] UNICEF, 2014. Tiranë, i disponueshëm në http://www.unicef.org/albania/Analyses_of_policies_and_reforms_affecting_the_situation_of_children_Alb2014.pdf.

¹¹ INSTAT, 2021b. *Children, Adolescents and Youth-Focused Well-being Indicators 2016-2019* [Treguesit e Mirëqenies me në qendër Fëmijët, Adolehentët dhe të Rinjtë] Tiranë, i disponueshëm në http://www.instat.gov.al/media/8433/instat_unicef_2021_statistics_publication_en.pdf.

¹² INSTAT, 2021a. *Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021*. Tiranë, i disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/media/8696/grate-dhe-burrat-ne-shqiperi-2021.pdf>.

¹³ Të dhëna të Bankës Botërore, të disponueshme në <https://data.worldbank.org/indicator/SP.RUR.TOTL.ZG?locations=AL>.

¹⁴ Vërejtur në Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analizë e Vlerësimit dhe Vlerësimit* në Arsim: Shqipëri]* OECD, Paris, e disponueshme <https://doi.org/10.1787/d267dc93-en>.



rënie. Ky ndryshim vjen pjesërisht për shkak të rënies së shkallës së lindjeve gjatë periudhës 2008 - 2018. Sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2017-2018 (SDSH në Shqipëri 2018),¹⁵ shkalla e përgjithshme e lindshmërisë në Shqipëri është 1.8 fëmijë për grua, shifër kjo nën shkallën e zëvendësimit prej 2.1 fëmijë për grua. Duke qenë se moshë mesatare në martesën e parë për gratë e grupmoshës 30-49 vjeç ka mbetur praktikisht e pandryshuar për një dekadë, shkalla në rënie e lindjeve mund të jetë e lidhur me intervalet mesatare më të gjata të lindjes. Duhet vërejtur se shkalla e lindjeve në adoleshencë (përqindja e grave të grupmoshës 15-19 vjeç që kanë filluar lindjen e fëmijëve) është rritur nga 2.8 për qind në vitin 2008 në 3.5 për qind në vitin 2018¹⁶. Krahas kësaj, shkalla e vdekshmërisë foshnjore (nën moshën 1 vjeç) po rritet paska, sipas raporteve të INSTAT-it rreth 10,5 vdekjeve për 1,000 lindje të djemve dhe 9.5 për vajzat në vitin 2020.¹⁷

Migracioni është një faktor i rëndësishëm në rënien e numrit të popullsisë së vendit. INSTAT-i¹⁸ vlerëson se gjatë periudhës 2011 - 2019, emigracioni përfshinte 22.1 për qind të familjeve shqiptare, nga të cilat 29.8 për qind emigronin si një e tërë. Numri i meshkujve ishte më i lartë sesa ai i femrave dhe grupi aktiv i popullsisë (20–44 vjeç) përbënte 74.3 për qind të fluksit. Gjatë të njëjtës periudhë, rreth 95,964 persona u kthyen nga emigracioni, nga të cilët më shumë se 85 për qind e tyre u kthyen nga Greqia, Italia dhe Gjermania. Megjithatë, më shumë se një e treta e tyre shprehen se dëshirojnë të emigrojnë sërish.

Nëse nuk hartohen politika për të adresuar emigracionin dhe shkallën në rënie të lindjeve, me shumë gjasa popullsia shqiptare do të vazhdojë të bjerë. **Emigracioni i të rinjve jo vetëm që redukton në mënyrë të pashmangshme dhe eksponenciale shkallën kombëtare të lindjeve, por edhe ka ndikuar negativisht në ekonomi, mekanizmat e kujdesit social dhe modelet familjare, si dhe ka penguar rritjen dhe zhvillimin ekonomik duke gërryer kapitalin shoqëror të vendit.** Një studim i kohëve të fundit¹⁹ evidentoi se fëmijët dhe prindërit e shohin emigracionin si një zgjedhje pozitive. Vendimi i thujse 60% të maturanëve për të studiuar jashtë vendit²⁰ pasqyron jo vetëm vlerësimin që kanë lidhur me perspektivat e tyre ekonomike, por edhe sistemin arsimor kombëtar.

Ndonëse raporton se numri i emigrantëve ra me 12.3 për qind në vitin 2019, INSTAT-i vërejt²¹ një rritje prej 9.7 për qind në numrin e të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Me shumë gjasa, kjo mospërputhje shkaktohet nga numri në rritje i azilkërkuesve në vend.

Shqipëria njihet nëntë pakica kombëtare: arumunët, boshnjakët, bullgarët, egjiptianët, grekët, maqedonasit, malazezët, romët, dhe serbët. Në censusin e vitit 2011 u regjistruan vetëm 8,301 romë dhe 3,368 egjiptianë, çka përbën thjesht 0.42 për qind të popullsisë. Në korrik 2012, Këshilli i Evropës vlerësoi që romët përbënin deri në 3.5 për qind të popullsisë së përgjithshme²², ndërsa Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 - 2020 i referohet tërthorazi burimeve të informacionit për një popullatë më të madhe. Çështja e numërimit të plotë të popullsisë rome nuk është zgjidhur ende, dhe pritet të zgjidhet me censusin e vitit 2022.

¹⁵ Instituti i Statistikave, Instituti i Shëndetit Publik, KNF, 2018. *Albania Demographic and Health Survey 2017–18* [Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2017-2018]. Tiranë, i disponueshëm në <https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf>

¹⁶ Po aty.

¹⁷ INSTAT, 2021a. *Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021*. Puna e cituar.

¹⁸ INSTAT, IOM, 2021. *Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2021/national-household-migration-survey-in-albania/>

¹⁹ King R., Gedeshi I., 2020. *The actual and potential migration of students from Albania: a putative brain drain* [Migracioni faktik dhe i mundshëm i nxënësve nga Shqipëria: migrim i pranuar i trurit] Fondacioni F. Ebert, i disponueshëm në <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17258.pdf>

²⁰ Po aty. Maturantët iu përgjigjën pyetjes: “Ku dëshironi të studioni?”

²¹ Shihni INSTAT, 2019. *Të huajt dhe azilkërkuesit në Shqipëri*. Gusht 2019, i disponueshëm në <http://instat.gov.al/media/6181/foreigners-and-asylum-seekers-2018.pdf>

²² Këshilli i Evropës *Estimates on Roma population in European countries* [Përlllogaritje të Popullsisë Rome në Vendet e Evropës], sikundër renditet në Dokumentin e përgatitur nga Ekipi Mbështetës i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Çështjet Rome <https://www.coe.int/en/web/roma-and-travellers/publications>

2.2 QEVERISJA DHE EKONOMIA POLITIKE

Shqipëria ka një sistem demokratik parlamentar shumëpartiak, për të cilin Kushtetuta e vitit 1998 parashikon kuadrin institucional të qeverisjes demokratike. Pushteti ligjvënës i përket Parlamentit të Shqipërisë, i përbërë nga një dhomë e vetme dhe i njohur si Kuvendi, që ka 140 përfaqësues të zgjedhur përmes një sistemi përfaqësimi shumëpartiak dhe përpjesëtimor. Ndonëse Shqipëria ka ruajtur një demokraci të qëndrueshme për dy dekada, procedurat e fragmentuara parlamentare²³ mund të vonojnë reformën, mund të pengojnë zhvillimet ligjvënëse dhe mund të kufizojnë mbikëqyrjen. Grupi ad-hoc parlamentar “Miq të Fëmijëve” vepron për të iniciuar dhe për të mbështetur legjislacionin lidhur me të drejtat e fëmijëve, si dhe për t’i bërë institucionet përgjegjëse dhe llogaridhënëse për zbatimin e tij. Gjyqësori është i pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës. Reforma gjyqësore është në vazhdimësi dhe BE-ja tregon se ka progres të ngadaltë²⁴. Sipas një sondazhi²⁵ të kohëve të fundit, gjykatat shihen si institucioni më pak i pavarur për vitin e tretë radhazi. Shqipëria ndahet në dymbëdhjetë prefektura, që më pas ndahen në 61 bashki (njësi të qeverisjes vendore të nivelit të parë, NJQV), si rrjedhojë e Reformës Administrative-Territoriale (RAT). Reforma u shoqërua me miratimin e një ligji të ri për vetëqeverisjen vendore, një strategji të re për decentralizimin, dhe delegimin e funksioneve të reja pranë nivelit vendor. Raporti KE-së i Progresit të Vendit (Progres Raporti) 2019 vëren se RAT-it kërkon konsolidim të mëtejshëm.

Si rrjedhojë e sfidave aktuale, **NJQV-të dhe palët e tjera vendore të interesit duhet të aftësohen në përgatitjen e planeve bazuar në evidenca, që adresojnë nevojat e fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre; në zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e planeve për ofrimin e shërbimeve vendore; si dhe në zhvillimin dhe ekzekutimin e buxheteve vendore efikase, të efektshme, dhe të barabarta.**

Gjatë tri dekadave të fundit, Shqipëria ka arritur statusin e një vendi me të ardhura mbi mesataren. Vendi u rendit i 69 në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor (IZHNJ) për vitin 2020²⁶, duke u futur në kategorinë e Zhvillimit të Lartë Njerëzor me një pikëzim të përgjithshëm prej 0.795, pas Greqisë (32), Malit të Zi (48), Turqisë (54) dhe Serbisë (64). Pikëzimi i Shqipërisë në IZHNJ bie me thuajse njëmbëdhjetë për qind në 0.708 kur përllogaritet duke marrë parasysh pabarazinë dhe bie pas në renditje me 7 vende. Koeficienti Gini për periudhën 2010–2018 ishte 33.2 për qind,²⁷ ndërsa INSTAT-i përllogariti një shifër prej 34.3 për qind në vitin 2019,²⁸ me një rënie prej 1.1 pikë përqindjeje nga viti i mëparshëm.

Banka Botërore (BB)²⁹ raporton një Produkt të Brendshëm Bruto (PBB) për vendin prej 15.3 miliardë dollarësh amerikanë në vitin 2020. Sipas Progres Raportit 2019³⁰, PBB-ja për frymë u rrit nga 30.4 për qind të mesatares së 28 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE28)³¹ gjatë periudhës 2010-2015 në 32.2 për qind në vitin 2018. Megjithatë, edhe gjatë rritjes ekonomike, kapaciteti i qeverisë për të investuar në shërbimet për fëmijë është kufizuar nga borxhi. Ndoshta si rrjedhojë, Shqipëria nuk e ka reduktuar ende pabarazinë e të ardhurave me BE-në dhe mbetet një nga vendet më të varfra në

²³ Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

²⁴ Po aty.

²⁵ Vrugtman L., Bino B., 2021. *Opinion Poll 2020: Trust in Governance Survey Report [Sondazh opinionesh 2020: Raport mbi Sondazhin rreth Besimit në Qeverisje]*. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, IDM. Tiranë, i disponueshëm në <https://idm-albania.org/trust-in-governance/>

²⁶ UNDP, 2021. *Human Development Report 2020; The next frontier: Human development and the Anthropocene [Raport për Zhvillimin Njerëzor 2020; Fronti i radhës: Zhvillimi Njerëzor dhe Antropocen]*. Nju-Jork, i disponueshëm në [hdr2020.pdf\(undp.org\)](hdr2020.pdf(undp.org))

²⁷ Po aty. Koeficienti Gini mat pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave, ku vlera 0% shpreh barazinë e përsosur në të cilën të gjithë kanë të njëjtin nivel të ardhurash, ndërsa koeficienti Gini me vlerë 100% shpreh pabarazi të plotë sipas së cilës një person ka të gjitha të ardhurat.

²⁸ INSTAT (2021) *Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017–2019*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/media/8364/income-and-living-condition-2019.pdf>. Këto shifra rrjedhin nga rezultatet kryesore të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri, e zhvilluar në përputhje me metodologjinë e Eurostat-it, që përdoret në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

²⁹ Banka Botërore në Shqipëri. Përmbledhja e disponueshme në <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>

³⁰ Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

³¹ Dokumentet e rishikuar për efekt të këtij studimi janë hartuar përpara se Mbretëria e Bashkuar të dilte nga BE-ja. Ndaj, dokumenti vazhdon t’i referohet shkurtimit BE28.

Evropë.³² Thatësira e ngadalësoi rritjen në 2.2 për qind në vitin 2019³³, dhe më pas tërmeti, duke vijuar me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19 detyruan që të mbylleshin sektorë të mëdhenj të ekonomisë. Sipas INSTAT-it,³⁴ PBB-ja në vitin 2020 ra me 3.31 për qind krahasuar me vitin 2019. Gjithsesi, kjo shifër është më pozitive sesa ajo e parashikuar në fillim të pandemisë.

2.3 VARFËRIA DHE PAPUNËSIA

Sipas të dhënave nga INSTAT-i³⁵, shkalla e rrezikut të varfërisë³⁶ në Shqipëri për vitin 2019 ishte 23 për qind, duke shënuar një rënie prej 0,7 për qind nga viti 2017. Privimi material u përllogarit të jetë 37.1 për qind përkundrajt 38.3 për qind në vitin 2018, një rënie prej 1.2 pikë përqindjeje. Pavarësisht rënies së vogël të shkallës së varfërisë të grupmoshat 18 - 64 vjeç dhe 65 vjeç e sipër, grupmosha 0 - 17 vjeç pësoi një rritje prej 01 për qind, duke arritur nivelin 29.7 për qind. Familjet me fëmijë vijuan të ishin në rrezik më të madh për të qenë të varfër sesa kushdo tjetër, dhe mesa duket ky hendek po zgjerohet. Në vitin 2019, përqindja e rrezikut të varfërisë për familjet pa fëmijë në varësi vlerësohej të ishte 14.2 për qind, duke shënuar një rënie nga 15.9 për qind që ishte në vitin 2017, por përqindja e përllogarit e varfërisë ndërmjet familjeve me fëmijë në varësi ishte 27.2 për qind, një rritje e lehtë nga 26.9 për qind në vitin 2017.

Për sa i përket varfërisë absolute, BB-ja në vitin 2019³⁷ vlerësoi se 34.4 për qind e popullsisë shqiptare jetonte me më pak se 5.5 dollarë amerikanë për person në ditë (pragu i varfërisë për vendet me të ardhura mbi mesataren). Megjithatë niveli i varfërisë absolute në Shqipëri ra gjatë periudhës 2012-2019, si rrjedhojë e rritjes së PBB-së dhe papunësisë së ulët, Shqipëria mbetet në krye të listës së vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket varfërisë absolute. Në kontekstin e COVID-19 dhe sfidat e përgjigjes ndaj tërmetit të vitit 2019, shkalla e varfërisë pritet të përkeqësohet nëse qeveria nuk merr masa të menjëhershme.

Në vitin 2019, numri më i lartë i familjeve që përfitonin Ndhimë Ekonomike (NE)³⁸ ndodhej në Kukës (37%), Dibër (29%) dhe Elbasan (21 %).³⁹ Vlera e NE-së është e vogël,⁴⁰ dhe INSTAT-i tregon se transfertat sociale që përjashtojnë pensionet për të moshuarit dhe familjet ulin shkallën e rrezikut të varfërisë me vetëm 11.3 për qind,⁴¹ krahasuar me normën e BE28-ës prej 32.2 për qind. **Varfëria e të ardhurave duhet të shqyrtohet së bashku me privimin, përjashtimin social, dhe çështjet gjinore, në mënyrë që të krijohet një tablo realiste e mënyrës se si të ardhurat ndikojnë te fëmijët dhe familjet,**⁴² por është e qartë se në lidhje me varfërinë e të ardhurave, aksesit në shërbime dhe izolimit social, familjet në zonat urbane dhe rurale po përjetojnë forma të ndryshme të varfërisë.

³² Leonikas T. et al., 2019. *Life and society in the EU candidate countries, European Quality of Life 2016 series [Jeta dhe shoqëria në vendet candidate për në BE, seritë rreth Cilësisë së Jetës në Evropë 2016]*. Eurofound. Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg.

³³ Banka Botërore, 2020. *An Uncertain Recovery. Regular Economic Report on the Western Balkans No. 18. [Një Rimëkëmbje e Pasigurt. Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor Nr. 18]* | disponueshëm në <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/34644>

³⁴ [Produkti i Brendshëm Bruto, T4 - 2020 | INSTAT](#)

³⁵ INSTAT, 2021. *Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017–2019*. Puna e cituar.

³⁶ Përqindja e rrezikut të varfërisë është 60% e medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara. Rritja ose rënia e këtij pragu ndikon në përqindjen e rrezikut të varfërisë.

³⁷ Banka Botërore, 2019a. *Western Balkans Regular Economic Report No. 15. Reform Momentum Needed*. [Raporti Ekonomik Periodik për Ballkanin Perëndimor Nr. 15. Kërkohet Momentum me Reformën]. Spring 2019.

³⁸ Ndhimja Ekonomike, skema e ndihmës sociale financiare të qeverisë për të mbështetur familjet e varfra.

³⁹ Të dhënat e INSTAT-it për mbrojtjen sociale janë të disponueshme në <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab2>

⁴⁰ Nikoloski Z., 2019. *Mapping Social Protection Transfers to Poor Households in Albania* [Hartëzimi i Transfertave të Mbrojtjes Sociale të Familjet e Varfra në Shqipëri]. UNICEF Tiranë, i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

⁴¹ INSTAT, 2021. *Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017–2019*. Puna e cituar.

⁴² Shihni Komisioni Evropian, 2004. *Joint Report on Social Inclusion 2004*, D-G Employment and Social Affairs, Unit E.2. [Raporti i Përbashkët për Përfshirjen Sociale 2004, D-G Punësimi dhe Çështjet Sociale, Njësia E.2] Bruksel.

INSTAT-i vëren⁴³ se shkalla e punësimit në vitin 2019 te grupmosha 15 - 64 vjeç ishte 60.1 për qind për burrat dhe 46.9 për qind për gratë. Megjithatë, vetëm 25.5 për qind e grave ishin të punësuar në pozicione me pagesë, ndërsa 14 për qind e tyre bënë punë të papaguar në biznesin e familjes, dhe mbipërfaqësorshin në sektorin e punës informale. Hendeku zyrtar gjinor në paga është 10.7 për qind,⁴⁴ por këtu përjashtohen gratë që punojnë në sektorin joformal; hendeku në paga i përlogaritur nëpërmjet të dhënave nga anketimet ishte rreth 15.2 për qind.⁴⁵ Sipas *Anketës së Forcave të Punës*⁴⁶ në vitin 2018, përqindja e punësimit barsvlerëse me kohën e plotë ishte 40.2 për qind për gratë dhe 54.6 për qind për burrat, çka tregonte një hendek gjinor prej 14.4 për qind. Duke qenë se e drejta në përfitimet e mirëqenies bazohet në tregun formal të punës, është e pashmangshme që gratë të jenë të disavantazuara. Më shumë gra sesa burra janë të punësuar në bujqësi (përkatesisht, 42.3% 33.5%), por toka vazhdon të regjistrohet kryesisht në emër të burrave. Më shumë se gjysma (52%) e burrave të grupmoshës 15-59 vjeç kanë në pronësi një shtëpi krahasuar me vetëm 31 për qind të grave, dhe 28 për qind e burrave kanë në pronësi tokë⁴⁷ krahasuar me 14 për qind të grave. Po ashtu, gratë janë kryesisht përgjegjëse për punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët në shtëpi. Të dhënat nga *Anketa e Përdorimit të Kohës 2011*⁴⁸ tregojnë se mbi 90 për qind e grave, pavarësisht statusit të punësimit, kryejnë punë të papaguar, krahasuar me më pak se 50 për qind të burrave. Gratë e punësuar i kushtojnë rreth katër orë punëve të papaguara në shtëpi krahasuar me më pak se një orë që shpenzojnë burrat e punësuar. **Duke qenë se gratë përbënin vetëm 41 për qind të fuqisë punëtore në vitin 2019⁴⁹ dhe janë të mbipërfaqësuar në pozicione me pagë të ulët,⁵⁰ është e rëndësishme që të vlerësohet situata e familjeve me gra kryefamiljare në vend.**

2.4 PROFILI I RREZIKUT NDAJ FATKEQËSIVE

Shqipërisë i kanoset rreziku i tërmeteve, përmytjeve, thatësirave, dhe erozionit bregdetar.⁵¹ Rajoni përreth vendit pëson të paktën një tërmet me magnitudë ≥ 6.5 ⁵² në vit. Në nëntor 2019, një tërmet, me magnitudë 6.3 Richter, shkaktoi shpërnguljen e të paktën 20,000 personave, duke përfshirë 9,000 fëmijë. Rreziqet mjedisore përfshijnë shpyllëzimin, rrëshqitjet e dheut, dhe ndotjen e ujit nga shkarkimet industriale dhe familjare.⁵³ Sipas Vlerësimit të Performancës Mjedisore⁵⁴, ka pasur disa përmirësime në cilësinë e ajrit dhe është reduktuar përdorimi i lëndëve djegëse, por ndotja e ajrit mbetet një problematikë e madhe mjedisore në qytetet e vendit. Rrjeti aktual për monitorimin e cilësisë së ajrit është i pamjaftueshëm dhe sipas Indeksit të Performancës Mjedisore 2020, Shqipëria renditet e 62-ta, me një pikëzim prej 49/100,⁵⁵ dukshëm nën mesataren rajonale në shumicën e parametrave.

⁴³ INSTAT *Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2020*. Tiranë, f. 77. Puna e cituar.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ INSTAT, 2020. *Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020*. F. 11. Tiranë, i disponueshëm në http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ INSTAT, 2011. *Anketa e Përdorimit të Kohës 2011*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/time-use-survey>.

⁴⁹ World Bank Data and Gender Profile: Albania. [Të dhëna të Bankës Botërore dhe Profili Gjinor: Shqipëri]

⁵⁰ INSTAT, 2020. *Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2020*. Puna e cituar. F. 71.

⁵¹ Shihni Pacara E., 2015. *Coastal erosion in Albania* [Erozioni bregdetar në Shqipëri]. Instituti i Politikave Mjedisore, IPM. Tiranë, i disponueshëm në <https://iep-al.org/test/wp-content/uploads/2016/02/Coastal-erosion-in-Albania.pdf>

⁵² Matur në Shkallën Evropiane Makrosizmike (EMS, 1998) prej 12 gradësh nga Komisioni Sizmologjik Evropian.

⁵³ Shihni Pacara E., Kalemaj I., 2010. *Albania's Struggle to Meet EU Environmental Criteria and Public Perception [Sfidat e Shqipërisë në Përbushjen e Kriterëve Mjedisore të BE-së dhe Perceptimi Publik]*. IPM Tiranë, i disponueshëm në http://iep-al.org/docs/Albanias_Struggle_to_Meet_EU_Environmental_Criteria_and_Public_Perception.pdf

⁵⁴ UNECE, 2018. *Environmental Performance Review of Albania Third Review* [Vlerësim i Performancës Mjedisore të Vlerësimit të Tretë të Shqipërisë]. Gjenevë, i disponueshëm në https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/epr/epr_studies/ECE.CEP.183_Eng.pdf

⁵⁵ Indeksi i Performancës Mjedisore, 2020. Rezultatet e EPI-së, <https://epi.yale.edu/epi-results/2020/component/epi> Accessed 07 July 2020.

Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001, "Për Emergjencat Civile" u shfuqizua nga Neni 74 i Ligjit Nr. 45/2019, datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile". Ligji i ri prezantoi koncepte të reja në sistemin shqiptar, duke përfshirë planet e emergjencave vendore dhe kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Krahas kësaj, parashikoi edhe ngritjen e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile (aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile). Megjithatë, aktualisht Agjencia nuk i ka kapacitetet administrative që të zbatojë asnjë nga funksionet e saj. Deri tani, nuk ka miratuar asnjë plan apo strategji kombëtare ose vendore.

Është jetike që çdo Plan kombëtar për Gatishmërinë për Emergjenca (PGE) ose/dhe Strategjia për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë të njohin plotësisht cenueshmërinë, rimëkëmbjen dhe potencialin e fëmijëve.

Shqipëria është e cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike.⁵⁶ Gjatë 15 viteve të fundit, temperaturat janë rritur, reshjet, përmytjet, dhe thatësitë⁵⁷ janë ulur, si dhe është shtuar numri i ditëve me temperatura mbi 35°C.⁵⁸ Në dekadën e fundit, numri i ditëve me temperatura tepër të larta është katërfishuar. Parashikimet tregojnë një ulje të reshjeve në verë me rreth 20 për qind deri në vitin 2050, çka rrezikon sigurinë energjetike dhe kërcënon shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve. Temperaturat e larta kanë nivele të larta të gastroenteritit. **Ka gjasa që fëmijët të preken negativisht nga këto ndryshime klimatike, por nuk është kryer ende asnjë Analizë e Situatës Klimatike. Shqipëria ka arritur njëfarë niveli të përgatitjes për ndryshimet klimatike, por përafrimi me *acquis* të BE-së mbetet i kufizuar. Strategjia kombëtare për ndryshimet klimatike duhet të marrë parasysh se si të zbutet ndikimi i mundshëm të fëmijët i fatkeqësive klimatike ose të shkaktuara nga njeriu, dhe si të forcohen aftësitë ripërtëritëse dhe kapacitetet e familjeve dhe komuniteteve për të shmangur, për të mbijetuar, dhe për t'u rimëkëmbur nga pasojat e këtyre fatkeqësive.**

Qeveria prezantoi një Plan Veprimi për Parandalimin dhe Përgjigjen ndaj COVID-19 në maj 2020. Ky plan përmban tri shtylla veprimi: parandalimi, përgjigja, dhe rimëkëmbja, me qëllim vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për të gjithë popullsinë.⁵⁹ Shqipëria mori masa të paprecedent për të ngadalësuar përhapjen e pandemisë, duke përfshirë kufizimin e udhëtimeve dhe mbylljen e detyruar të vendeve publike, duke përfshirë edhe shkollat. Pavarësisht përgjigjes së shpejtë, deri në fund të muajit korrik 2021, Shqipëria konfirmoi në total 132,490 raste me koronavirus, duke përfshirë 2,454 vdekje⁶⁰. Humbjet e vendeve të punës për shkak të COVID-19 kanë ndikim të drejtpërdrejtë në siguri ushqimore, strehim, akomodim dhe akses në shërbime, si dhe përkeqësojnë cenueshmërinë e grave dhe fëmijëve, sidomos të atyre që jetojnë në vendbanime informale dhe kushte të varfra.⁶¹ Gjithashtu, ekziston rreziku që pandemia të pengojë progresin drejt OZHQ 4 për arsimin në Shqipëri. Nga 20 për qind deri në 49 për qind e fëmijëve shqiptarë mund të jenë të disavantazuar nëse iu duhet të mbështeten në të nxënit në distancë përmes internetit,⁶² dhe mungesa e tejzgatur në shkollë ka gjasa të ulë shkallën e vijueshmërisë dhe diplomimit, si dhe të përkeqësojë rezultatet e të nxënit, sidomos për fëmijët që janë tashmë të disavantazuar. Fëmijët e rrezikuar nga dhuna dhe abuzimi kanë gjasa të bëhen edhe më të cenueshëm.

⁵⁶ Shihni <https://www.worldbank.org/en/country/albania/brief/climate-change-in-albania>

⁵⁷ UNECE, 2018. Puna e cituar.

⁵⁸ Periudhat kur, për më shumë se gjashtë ditë rresht, temperatura e ajrit është të paktën 5°C më e lartë sesa temperatura mesatare afatgjatë për këto ditë.

⁵⁹ Plani i veprimit, i disponueshëm në https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf

⁶⁰ <https://shendetesia.gov.al/>

⁶¹ Korunovska N., Jovanovic Z., 2020. *Roma in the COVID-19 Crisis* [Romët në Krizën e COVID-19]. Fondacioni Shoqëria e Hapur, OSF Berlin. Studimi mbuloi Bullgarinë, Hungarinë, Italinë, Rumaninë, Sllovakinë, dhe Spanjën.

⁶² Dunja A., Gjergji O., Gvineria D., Hallkaj E., dhe Verzivolli I. 2019. *One Click Away: Children's Experience of Internet Use in Albania*. [Një klikim larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri]. UNICEF, IPSOS Strategic Marketing. Tiranë, i disponueshëm në https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2020-01/report_oneclickaway.pdf. Përqindjet janë përlogaritjet nga autori dhe i referohen përgjigjeve të dhënave nga fëmijët mbi pyetjen e frekuencës së aksesit në internet.

2.5 PROFILI GJINOR

Në vitin 1993, Shqipëria ratifikoi Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), dhe në vitin 2012 Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). Në vitin 2014, Qeveria dorëzoi raportin e saj të katërt periodik në komitetin e CEDAW-së; raportin e parë të saj për zbatimin e Konventës së Stambollit në vitin 2017, dhe Raportin Kombëtar për Zbatimin e Platformës së Pekinit +25 për Veprim në vitin 2019. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka përgatitur një plan veprimi që pasqyron rekomandimet e marra.

Shqipëria është renditur në vendin e 20 nga 153 vendet në Indeksin e Hendekut Gjinor Botëror⁶³ në vitin 2020, në vendin e 51-të nga 162 vendet në Indeksin e Pabarazisë Gjinore⁶⁴ në vitin 2019 dhe mori 60.4 pikë në Indeksin e Barazisë Gjinore⁶⁵ në vitin 2017, shtatë pikë nën mesataren e BE-28 (67.4), me përjashtim të fushës së fuqisë (60.9), ku Shqipëria shfaq barazi më të lartë gjinore. Në qershor 2021, gratë përbëjnë 29.3 për qind të anëtarëve të parlamentit, duke shënuar një rritje nga 23.5 për qind në vitin 2017, dhe 57 për qind të qeverisë, e cila është një rritje nga 42 për qind në vitin 2013.⁶⁶ Nënkomisioni parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave mbikëqyr zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe raporton për situatën e dhunës në familje dhe diskriminimin ndaj grave.

Ekziston edhe Aleanca e Grave Deputete që promovon barazinë gjinore në legjislacion, por në përgjithësi, **burrat janë të mbipërfaqësuar në nivelin drejtues të shërbimit publik, madje edhe në sektorin e shëndetësisë, sektorin e arsimit dhe atë social ku gratë përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore.**⁶⁷

Neni 18 i Kushtetutës parashikon që askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, Ligji Nr. 9970/2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" parashikon ngritjen e institucioneve për mbrojtjen nga diskriminimi, dhe Ligji Nr. 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare", ndryshuar me Ligjin Nr. 47/2018, garanton mbrojtjen nga dhuna në familje.

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është edhe kryetari i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, organi më i lartë këshillimor lidhur me barazinë gjinore. Çdo ministri linje dhe bashki ka një pikë fokale për çështjet gjinore. Po hartohet një Strategji e re Kombëtare dhe një Plan Veprimi për Barazinë Gjinore. **Pavarësisht faktit që barazia gjinore ka një kuadër të fuqishëm institucional, gratë në Shqipëri vazhdojnë të kenë akses të kufizuar në asete, tregje, burime, dhe procese vendimmarrëse. Krahas kësaj, ato përballen me diskriminim në formën e statusit të padrejtë hierarkik midis burrit dhe gruas, si dhe ekspozimit ndaj dhunës, abuzimit, dhe shfrytëzimit.**

Ndonëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ligjërisht konsiderohen si kriminale, Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (DHGV)⁶⁸ në Shqipëri, e botuar nga INSTAT-i, konstatoi se 52.9 për qind e grave kanë përjetuar një formë dhune, dhe 3.1 për qind e grave të grupmoshës 18 - 74 vjeç

⁶³ Shihni <https://jp.weforum.org/reports/gender-gap-2020-report-100-years-pay-equality>

⁶⁴ RZHNJ 2010 prezantoi IPGJ-në, që pasqyron pabarazitë gjinore në tri aspekte: shëndeti riprodhues që matet nga vdekshmëria e nënave dhe shkalla e lindjes në adoleshencë, fuqizimi që matet nga numri i vendeve në parlament që mbajnë gratë dhe arritjet në arsimin e mesëm dhe të lartë për secilën gjini, si dhe aktiviteti ekonomik që matet nga shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës për gratë dhe burrat. Për më shumë detaje rreth IPGJ-së 2020 për Shqipërinë, shihni https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/gender_equality_index_albania.pdf

⁶⁵ Indeksi i Barazisë Gjinore mat barazinë gjinore në një shkallë nga 1 (pabarazi e plotë) deri në 100 (barazi e plotë) në gjashtë fusha bazë: puna, paratë, njohuritë, koha, pushteti dhe shëndetësia, si dhe dy fusha shtesë: pabarazitë dhe dhuna që ndërthuren me njëra-tjetrën.

⁶⁶ INSTAT, 2020. *Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020*. I disponueshëm në http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf.

⁶⁷ Shihni INSTAT, 2020. *Gender Equality Index of the Republic of Albania 2020*, [Indeksi i Barazisë Gjinore i Republikës së Shqipërisë 2020] f. 7, dhe World Economic Forum, *Global Gender Gap Report 2020* [Forumi Ekonomik Botëror, Raporti Global i Hendekut Gjinor 2020]

⁶⁸ INSTAT, 2019. *Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri* (DHGV 2019) UNDP, UN Women, Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2019/violence-against-women-and-girls-in-albania-2018/>

raportuan se janë abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë. Dhuna me bazë gjinore jo vetëm që është gjerësisht e përhapur, por edhe e pranuar nga shoqëria. E njëjta anketë zbuloi se 50 për qind e grave besonin se dhuna në familje është një çështje private, 46,5 për qind e grave mendonin që duhet ta toleronin dhunën për të mbajtur familjen e tyre të bashkuar, dhe 26,1 për qind e tyre besonin që duhet të ndiheshin të turpëruara për të folur për përdhunimin e tyre.

Ndonëse legjislacioni për dhunën në familje është përgjithësisht në përputhje me Konventën e Stambollit, vendi nuk adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse format e tjera të dhunës ndaj grave, duke përfshirë përndjekjen, ngacmimin, dhe dhunën seksuale. Legjislacioni nuk krijon hapësirë që viktimat e këtyre formave të dhunës të përfitojnë nga masat e mbrojtjes dhe të parandalimit, apo nga shërbimet që iu ofrohen viktimave të formave të tjera të dhunës. Krahas kësaj, kodi penal shqiptar duhet të jetë në përputhje të plotë me Konventën e Stambollit lidhur me përkufizimin e përdhunimit.

2.6 MJEDISI MUNDËSUES PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Shqipëria ka ratifikuar nëntë traktatet ndërkombëtare bazë për të drejtat e njeriut⁶⁹, dhe Neni 122 i Kushtetutës parashikon që marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, duke përfshirë KKPDF-në, të jenë pjesë e legjislacionit vendas. Traktatet e zbatueshme direkte mund të zbatohen nga gjykatat, por marrëveshjet ndërkombëtare që nuk janë vetëzbatues kërkohen legjislacion kombëtar për t'i zbatuar. Dispozita të caktuara të Konventës nuk janë përcaktuar mjaftueshëm që të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëse Konventa kundërshton legjislacionin kombëtar, ajo që duhet zbatuar është Konventa. Ndoshta **nevojitet një vlerësim proaktiv gjithëpërfshirës i legjislacionit me në qendër fëmijët për të identifikuar hendeqet dhe për të garantuar përputhshmërinë me instrumentet ndërkombëtare, dhe mes tyre.** Shqipëria ka ratifikuar⁷⁰ gjithashtu Protokollet Opsionale të KKPDF -së dhe është një nga vendet e pakta evropiane⁷¹ që ka ratifikuar Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (ICMW).

Qeveria dorëzoi Rishikimin Periodik Universal⁷² (RPU) në vitin 2019, ku rithekson angazhimin e saj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Harmonizimi i legjislacionit të Shqipërisë me traktatet ndërkombëtare është në proces e sipër, por në vitin 2012,⁷³ Komiteti i KB për të Drejtat e Fëmijës doli në përfundim se pengesa kryesore për realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri është zbatimi i dobët i legjislacionit dhe i politikave. Tanimë, qeveria ka dorëzuar raportin e saj

⁶⁹ Ato janë: [Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor](#); [Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike](#); [Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore](#); [Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave](#); [Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit dhe Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese](#); [Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#); [Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Punonjësve Migrantë dhe Familjeve të tyre](#); [Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë](#); dhe [Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#). Disa nga traktatet plotësohen me protokolle opsionale që merren me shqetësime specifike.

Shihni <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CoreInstruments.aspx>

⁷⁰ Shihni Bazën e të Dhënave për Traktatet për të Drejtat e Njeriut nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, e disponueshme në https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=173&Lang=EN

⁷¹ Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Turqia kanë ratifikuar ICMW-në dhe Mali i Zi e ka nënshkruar. Shihni https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-13&chapter=4&lang=en

⁷² National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21* Albania [Raporti kombëtar i dorëzuar në përputhje me pikën 5 të shtojcës pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut, rezoluta 16/21* Shqipëri] Shkurt, 2019 I disponueshëm në <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx>

⁷³ UNCR, 2012. *61st Session Consideration of reports submitted by States parties under article 44 of the Convention. Concluding Observations*:

Albania. [Seanca e 61-të për shqyrtimin e raporteve të dorëzuara nga Shtetet Palë në kuadër të nenit 44 të Konventës. Vëzhgime Përfundimtare: Shqipëri]. Gjenevë

të pestë dhe të gjashtë periodik⁷⁴ pranë Komitetit të KB për të Drejtat e Fëmijës, por nuk është kryer ende seanca dëgjimore. Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” hyri në fuqi në qershor të vitit 2017. Parashikon detyrat, institucionet, strukturat dhe mekanizmat për të garantuar respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individit, familja dhe shteti, duke forcuar në të njëjtën kohë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi.

Nga raporti i fundit monitorues⁷⁵ i Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (AKDF) 2017 - 2020, rezultoi që 39 për qind e treguesve të dakordësuar janë arritur, 44 për qind janë arritur pjesërisht, dhe 87 për qind e shpenzimeve të parashikuara janë kryer, nga të cilat shteti ka mbuluar 59 për qind dhe donatorët kanë financuar 41 për qind. Megjithatë, raporti konstatoi se 71 për qind e treguesve përmbanin informacione të pamjaftueshme për matjet fillestare (vlera bazë), 81 për qind nuk kishin të paktën një nga vlerat bazë dhe synimet afatmesme ose afatgjata, si dhe 12 për qind ishin të pamatshme. Krahas kësaj, në shumicën e rasteve, institucionet raportuese ofruan vetëm informacione të thjeshta rreth nivelit të ecurisë së aktiviteteve, duke krijuar vështirësi në kryerjen e një analize të vërtetë të ecurisë. Në përgjithësi, raporti konstatoi se informacioni për çështjet e fëmijëve është i fragmentuar, çka pasqyron qasjen sektoriale ndaj zbatimit të të drejtave të fëmijëve. **Agjenda e re Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, e cila po hartohet aktualisht, duhet të adresojë ndërhyrjet kryesore nga pikëpamja e bashkëpunimit ndërsektorial për të arritur rezultate për fëmijët. Forcimi i mekanizmave të qeverisjes për zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe kapaciteteve për të prodhuar dhe për të përdorur të dhëna cilësore në nivelin kombëtar dhe vendor duhet të jenë shtyllat kryesore të Agjendës së re.**

MSHMS-ja është autoriteti përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e progresit në zbatimin e politikave përkatëse dhe zbatimin e ligjeve, strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për fëmijët. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF) është organi më i lartë këshillimor, i ngritur me urdhër të kryeministrit për të koordinuar veprimet rreth çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. Ai përbëhet nga anëtarë të qeverisë, OJF-ve dhe institucioneve të pavarura, si dhe ka mekanizma për pjesëmarrjen e fëmijëve si vëzhgues. **KKDMF duhet të rigjallërohet, të forcohet, si dhe të ketë burime më të mira për të kryer rolin e tij, duke përfshirë promovimin e një qasjeje bazuar në të drejtat e fëmijës dhe drejtësi, në kuadër të zhvillimit dhe reformave kombëtare.** Sektori i biznesit duhet të angazhohet (nga institucionet përgjegjëse) për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe një shoqëri më të drejtë e më të barabartë, që mbështet çdo fëmijë në realizimin e potencialit të tij të plotë.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, e ngritur në vitin 2011, është organi ekzekutiv pranë MSHMS-së i cili është përgjegjës për koordinimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës sipas politikave kombëtare, si dhe për monitorimin e zbatimit të AKDF-së. Në përgjithësi është pranuar⁷⁶ se Agjencia ka burime të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore. Struktura, autoriteti, dhe mandati i **Agjencisë duhet të forcohen dhe të zgjerohen, në mënyrë që të lehtësojnë hartimin e strategjive të qarta ndërsektoriale për të adresuar përjashtimin social të popullsisë veçanërisht të cenushme, duke përfshirë fëmijët romë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët migrantë, dhe fëmijët në paraburgim apo kujdes rezidencial.**

Në vitin 2014, u ndryshua Ligji për Avokatin e Popullit, me ngritjen e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve brenda institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një Komisioner për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe tre ndihmës komisionerë. Plani Strategjik 2019 - 2022 i institucionit i konsideron fëmijët prioritet, sidomos fëmijët nga grupet

⁷⁴ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 2019. Consideration of reports submitted by States parties under article 44 of the Convention on the Rights of the child Fifth and Sixth Periodic Reports Convention, and its two optional protocols (State Report 2019) [Konsideratat e raporteve të dorëzuara nga Shtetet Palë sipas Nenit 44 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Raporti i Pestë dhe i Gjashtë, Konventa dhe Protokollat e saj Opsionale (Raporti i Shtetit 2019)] Tiranë, i disponueshëm në https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/SessionDetails1.aspx?SessionID=801&Lang=en

⁷⁵ MHSP, 2021. *Raporti 4-Vjeçar i Zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 - 2020*. Prill, 2021. Tiranë, i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>

⁷⁶ Shihni Progres Raporti, 2019, f. 29, dhe Raportin Shtetëror për Komitetin e KB për të Drejtat e Fëmijës, 2019, pika 27.

e cenueshme. Në vitin 2020, Parlamenti miratoi ndryshime në Ligjin kundër Diskriminimit, të cilat përmirësojnë efektshmërinë e punës së Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke përfshirë pjesëmarrjen dhe aksesin e fëmijëve në masat korrigjuese që jep Komisioneri. Megjithatë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe institucione të tjera të pavarura ende përballesh me zbatimin e dobët të rekomandimeve të tyre nga administrata shqiptare. Është e nevojshme të forcohen kapacitetet e këtyre institucioneve në trajtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut, veçanërisht të ndryshojë buxhetimi i mjaftueshëm për të përmbushur funksionet e tyre.⁷⁷

Gjatë periudhës 2015 - 2019, rritja e PBB-së në Shqipëri arriti një mesatare prej 3.26 për qind në vit.⁷⁸ **Megjithatë, rritja e të ardhurave kombëtare nuk është përkthyer në përmirësimin e arsimit, shëndetësisë, ose mbrojtjes sociale, dhe qeveritë e njëpasnjëshme nuk kanë investuar mjaftueshëm në shërbimet për fëmijë. Shpenzimet publike për arsimin arritën vetëm 3.3 për qind të PBB-së në Shqipëri në vitin 2019, që është më pak se mesatarja e OECD-së (5.4%) dhe BE-së (4.6%) në vitin 2018. Shpenzimet publike në shëndetësi si përqindje e PBB-së arritën vetëm në 3.05 për qind në vitin 2019, ndërsa shpenzimet në shëndetësi si përqindje e shpenzimeve totale publike ishin 10.41 për qind⁷⁹. Shqipëria u rendit e fundit në Indeksin Evropian për Shëndetin e Konsumatorit në vitin 2018,⁸⁰ për shkak të alokimit të ulët shpërpjesëtimor të burimeve drejt kujdesit shëndetësor parësor (KSHP), veçanërisht për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Ka hapësira të dukshme për të rritur të ardhurat e disponueshme për fëmijët, edhe në kontekstin e rënies së PBB-së për shkak të COVID-19. Aktualisht, Shqipëria mbledh taksa të barasvlershme deri në rreth 27.3 për qind të PBB-së së saj⁸¹ kundrejt një mesatareje të vendeve të OECD-së prej 34 për qind në vitin 2018.⁸² Humbja e taksave nëpërmjet tregut informal të punës është një tjetër fushë e reformës fiskale që mund të përdoret për përfitime direkte të familjeve, ashtu si dhe rikuperimi i fondeve të humbura nga korrupsioni dhe keqmenaxhimi.**

Ndonëse OJF-të në nivel vendor shihen si partnerë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale, kadri i paplotë ligjor vijon të kufizojë aksesin e tyre në fonde të qeverisë vendore. Në përgjithësi, këto organizata e kanë të pamundur të ofrojnë shërbime të mjaftueshme për të gjithë ata që kanë nevojë për to dhe nuk mund të rikuperojnë kostot e ofrimit të shërbimeve. Shumë përfitues e kanë të pamundur të paguajnë për shërbimet dhe OJF-të kanë akses të pamjaftueshëm në burime të tjera të mbështetjes financiare për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit. Ndërkohë, po bie interesi i donatorëve për të mbështetur ofrimin e shërbimeve. **Numri i OJF-ve të angazhuara në ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë mirëqenien, arsimin, dhe shëndetësinë është rritur gradualisht dhe tanimë ofron larmishmëri. Megjithatë strukturat shtetërore në nivel qendror dhe vendor e vlerësojnë rolin që mund të luajnë OJF-të në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht të atyre që synojnë grupet dhe individët e cenueshëm, është shënuar progres i kufizuar në drejtim të ofrimit të mbështetjes financiare të vërtetë dhe të qëndrueshme nga tyre.**

⁷⁷ Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

⁷⁸ Banka e Shqipërisë, 2020. *Raporti vjetor 2019*. Tiranë.

⁷⁹ INSTAT, 2021b. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adolehentëve dhe të Rinjve 2016–2019*. Puna e cituar, f. 17

⁸⁰ Health Consumer Powerhouse, 2019. *Euro Health Consumer Index 2018 Report* [Raporti për Indeksin Evropian të Shëndetit të Konsumatorit 2018]. 25 shkurt 2019.

⁸¹ Banka e Shqipërisë, 2020. *Raporti vjetor 2019*. Tiranë.

⁸² Të dhëna të OECD-së. Të ardhurat tatimore, të disponueshme në <https://data.oecd.org/tax/tax-revenue.htm>

KAPITULLI 3

Të drejtat e fëmijëve

3.1 E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR⁸³**Konteksti i përgjithshëm**

Pavarësisht rreziqeve lidhur me mjedisin, higjienën dhe mënyrën e jetesës, 69 për qind e burrave dhe 52 për qind e grave në Shqipëri raportuan⁸⁴ se gëzonin shëndet të mirë në vitin 2016, çka përbën një përqindje më të lartë sesa disa shtete anëtare të BE-së. Sipas SDSH në Shqipëri 2018, gjysma e grave të grupmoshës 15-49 vjeç kanë një indeks normal të masës trupore, 4 për qind kanë trup të dobët, ndërsa 45 për qind janë mbipeshë ose obeze. Vetëm 5 për qind e femrave dhe 2 për qind e meshkujve të grupmoshës 15-49 vjeç konsumonin porcionin e rekomanduar të frutave dhe perimeve, dhe vetëm afërsisht 1 në 10 femra dhe meshkuj të asaj grupmoshe kryenin aktivitet të rregullt fizik. Përqindja e grave të grupmoshës 15 - 49 vjeç që vuajnë nga anemia u rrit nga 19 për qind në vitin 2008 në 23 për qind në vitin 2018. Më shumë gra raportojnë rrezik depresioni (35%) sesa burra (26%). Sipas SDSH në Shqipëri 2018, 13 për qind e femrave dhe 18 për qind e meshkujve të moshës 15-59 vjeç raportuan se përjetonin ndjesinë e depresionit në pjesën më të madhe të kohës, por vetëm 2,1 për qind e femrave dhe 4,2 për qind e meshkujve ishin diagnostikuar me depresion. Kjo përqindje mbështetet edhe nga statistikat për shkallën e vdekshmërisë nga vetëvrasja, e cila (në vitin 2018) raportohet të ishte 2.8 për 100,000 gra dhe 6.2 për 100,000 burra.⁸⁵ **Këto të dhëna**

janë shqetësuese duke marrë parasysh stigmën sociale rreth shëndetit mendor, dhe faktin që kujdesi ndaj shëndetit mendor është një nga fushat që kërkon investime të mëtejshme në sistemin shëndetësor.⁸⁶

Një e treta (34%) e grave të grupmoshës 15-49 vjeç raportuan të paktën një problem në marrjen e shërbimeve në kujdesin shëndetësor. Problemet më të zakonshme të raportuara ishin përballimi financiar i trajtimit (25%), duke vijuar me largësinë

⁸³. Përveçse kur shënohet ndryshe, vlerat e përfshira në këtë kapitull janë marrë nga SDSH 2018, puna e cituar.

⁸⁴. Shihni Eurofound, 2019. Puna e cituar, dhe vërejtur në botimin e Charities Aid Foundation *2018 World Giving Index* [Indeksi i Kontributit në Botë] CAF, i disponueshëm në https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-publications/caf_wgi2018_report_webnopw_2379a_261018.pdf

⁸⁵. Organizata Botërore e Shëndetësisë, Banka e të Dhënave të Observatorit Botëror të Shëndetësisë, i disponueshëm në <https://data.worldbank.org/indicator/SH.STA.SUIC.P5?locations=AL>

⁸⁶. MSHMS, 2021. *Raporti 4-Vjeçar i Zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020*. Puna e cituar.

nga qendra shëndetësore (14%), si dhe dëshira për të mos shkuar vetëm (13%). Pesë për qind u shprehën se problem serioz për to ishte edhe fakti që duhet të merrnin leje për të shkuar në qendrën shëndetësore. Pasuria dhe niveli arsimor i familjes përcaktojnë ekzistencën e problemeve serioze që parandalojnë marrjen e shërbimeve në kujdesin shëndetësor: 62 për qind e grave në kuintilin më të ulët të grupimit sipas statusit ekonomik përmendin të paktën një problem serioz krahasuar me vetëm 10 për qind në kuintilin më të lartë, ndërsa 66 për qind e grave me arsim fillor, 4-vjeçar, ose më pak, raportonin të paktën një problem serioz, krahasuar me 15 për qind të grave me arsim të lartë.

Anketa “Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijët në Moshë Shkollore” (SSHFMSh)⁸⁷ 2018 **evidentoi se 73 për qind e të anketuarve raportuan një gjendje shëndetësore të vetëpërceptuar “shumë të mirë”.** Në përgjithësi, prevalenca e ankesave shumë të shpeshta ishte më e lartë për tensionimin, acarimin dhe temperamentin e keq (rreth 11%), e ndjekur nga dhimbja e kokës dhe vështirësitë për të fjetur (të dyja 6.6%), ndërsa më e ulëta ishte për marramendje (3.6%) dhe dhimbje stomaku (2.3%).

Vajzat raportuan një prevalencë më të lartë të ankesave shëndetësore krahasuar me djemtë. Ndërkohë, djemtë raportuan një nivel më të lartë të ushtrimeve fizike ditore sesa vajzat (përkatësisht 29% kundrejt 20%). Prevalenca e përgjithshme e duhanpirjes te të rinjtë ishte 9.7 për qind: 13.2 për qind te djemtë dhe 6.5 për qind te vajzat. Rreth 78 për qind e fëmijëve të intervistuar nuk kishin konsumuar kurrë pije alkoolike, duke shënuar një diferencë të madhe midis djemve (73%) dhe vajzave (83%). Megjithatë, nga fëmijët 15 vjeç, 5.1 për qind raportuan se kishin konsumuar kanabis gjatë jetës së tyre dhe 2.7 për qind u shprehën se e kishin konsumuar gjatë 30 ditëve pararendëse. Djemtë (5.5%) raportuan për shpeshtësi më të lartë të konsumit të kanabisit sesa vajzat (1.1%).

Kuadri i përgjithshëm i shërbimeve shëndetësore

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është një kombinim ndërmjet atij publik dhe privat, por shteti siguron pjesën më të madhe të shërbimeve në fushën e promocionit, parandalimit, diagnostikimit dhe trajtimit. Sektori privat mbulon shërbimet farmaceutike dhe ato stomatologjike, si dhe disa shërbime diagnostikuese klinike, të përqendruara kryesisht në Tiranë. Vizioni për kujdesin shëndetësor në Shqipëri përfshin shumë aspekte të shëndetit dhe mirëqenies, duke përfshirë zbutjen e pabarazive në shëndetësi, zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, modernizimin e teknologjisë mjekësore, përmirësimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale, përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë, akses të barabartë për të gjithë, si dhe mbrojtje nga barra financiare e sëmundjeve. **Ligji shqiptar garanton akses të barabartë në kujdesin shëndetësor për çdo qytetar.** MSHMS-ja është institucioni përgjegjës për shërbimet shëndetësore. Operatori Kombëtar i Shërbimeve Shëndetësore dhe katër drejtoritë e tij rajonale janë përgjegjës për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor. Mbulimi shëndetësor në Shqipëri ofrohet përmes sistemit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, që administrohet nga një agjenci e vetme, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH). Të punësuarit dhe personat e tjerë aktivë ekonomikisht përfitojnë nga FSDKSH-ja sipas pagesave të kontributeve. Anëtarësimi në FSDKSH është i lirë për të vetëpunësuarit, bizneset e vogla familjare, dhe fermerët. Fëmijët nën moshën 18 vjeç mbulohen pa pagesë. Sipas SDSH në Shqipëri 2018, 62 për qind e grave dhe 64 për qind e burrave të grupmoshës 15 - 49 vjeç raportojnë se nuk kanë asnjë formë sigurimi. Shumica e këtyre individëve vijnë nga kuintili më i varfër.

Në vitin 2019⁸⁸ Shqipëria kontribuonte vetëm me 3.05 për qind të PBB-së për shpenzimet në shëndetësi, që tregon angazhim në ulje, dhe më pak se mesatarja e Evropës dhe Azisë Qendrore.⁸⁹ Parashikimet për vitet e ardhshme tregojnë se kjo prirje do të vazhdojë,⁹⁰ çka është shqetësuese duke marrë parasysh nevojën e vazhdueshme për të adresuar situatën e krijuar nga COVID-19. Progres Raporti 2020 vëren përcaktim të ulët dhe shpërpjesëtimor të burimeve në kujdesin shëndetësor parësor, veçanërisht për shëndetin e nënës dhe fëmijës, dhe kjo rënie e vazhdueshme e burimeve të alokuara për kujdesin

⁸⁷ Health Behaviour in School-age Children of 11, 13 and 15 years: Main Findings (2018). [Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijëve në Moshë Shkollore 11, 13, dhe 15 vjeç: Gjetjet kryesore (2018)]. Tiranë.

⁸⁸ INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri*, puna e cituar.

⁸⁹ Banka Botërore, 2019. World Development Indicators [Treguesit e Zhvillimit Botëror]. Baza e të dhënave online, e disponueshme në <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators/preview/on> accessed 14 July 2020.

⁹⁰ Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë <https://www.financa.gov.al/buxheti-ne-vite>.

shëndetësor parësor është veçanërisht shqetësuese.⁹¹ Në vitin 2018, shpenzimet e drejtpërdrejta nga xhepi (out-of-pocket) janë përlogaritur si 44.6 për qind⁹² të shpenzimeve totale për shëndetin në Shqipëri (një nga përqindjet më të larta në Evropë), duke reduktuar kështu marrjen e shërbimeve nga familjet që nuk janë në gjendje të paguajnë. Pasojat konfirmohen nga analiza e të dhënave të *Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës*, e cila tregon se nevoja e papërbushur për kujdes shëndetësor është rritur nga 19 për qind në vitin 2017 në 21.5 për qind në vitin 2018, si dhe për kujdes dentar u rrit nga 20.5 për qind në 23.6 për qind. Nevoja e papërbushur në Shqipëri është shumë më e lartë sesa mesatarja e vendeve të BE-së (3% për kujdes shëndetësor dhe 4% për kujdes dentar në vitin 2018). Raportohet se shkaku kryesor i kësaj nevoje të papërbushur për kujdes shëndetësor dhe kujdes dentar lidhet me kostot.⁹³ Krahas kësaj, 36 për qind e romëve të anketuar (>15 vjeç) raportojnë se kanë nevoja të papërbushura për kujdes shëndetësor,⁹⁴ çka ngre më shumë shqetësime në lidhje me pabarazinë në ofrimin e shërbimeve dhe kërkesën për të adresuar nevojat e grupeve më të cenueshme.

Qendrat shëndetësore kanë si qëllim ofrimin e shërbimeve për mesatarisht 8,000 dhe 20,000 banorë, 24 orë çdo ditë të javës, ndonëse jo të gjitha shërbimet ofrohen në çdo qendër. Përbërja e ekipeve të kujdesit parësor ndryshon, por çdo ekip menaxhohet nga kryemjeku/drejtuesi i qendrës. Kapacitetet e shërbimeve të ofruara nga infermierët dhe mamitë në komunitet duhet të rriten ndjeshëm, dhe mbulimi, fushëveprimi, depërtimi, dhe cilësia e shërbimeve duhet të forcohet dhe të zgjerohet. Roli, mandati dhe autoriteti i shërbimit të infermierisë në sistemin e shëndetit të nënës dhe fëmijës duhet të qartësohet, të përditësohet, të përmirësohet, dhe të zgjerohet sipas rastit. Duhet marrë masa të menjëhershme për të zhvilluar dhe për të mbajtur kuadrin e nevojshëm të ekspertizës profesionale.

Mjekët e përgjithshëm (MP) i shërbejnë popullatës së shënuar në listat e tyre, si dhe shkollave që gjenden brenda zonës së mbulimit të kujdesit parësor. Ata janë të specializuar ose për të rritur ose për fëmijë. Megjithatë, në zona të vogla rurale, mjekët e përgjithshëm u ofrojnë shërbime njerëzve të të gjitha moshave. Zakonisht, ekipet urbane kanë mjek pediatër dhe infermierë që kujdesen për fëmijët e sëmurë. Numri i pozicioneve të përcaktuara për mjekët dhe infermierët synon të garantojë se raporti mjek-pacient është 1:2500, ndërsa infermier-pacient është 1:400. Megjithatë, **sipas vlerësimit të OBSH-së⁹⁵ në vitin 2018, kishte variacion të madh në numrin e mjekëve dhe infermierëve, dhe indeksi i Mbulimit Universal Shëndetësor është vetëm 59, që është shifra më e ulët në rajon.** Një anketim⁹⁶ në vitin 2018 konstatoi se 24 për qind e mjekëve planifikonin të emigronin, dhe 54 për qind do të largoheshin po t'iu jepej mundësia, me qëllim që të gjenin mbështetje financiare dhe kushte më të mira pune jashtë vendit. Pothuajse 51 për qind e mjekëve janë të përqendruar në Tiranë⁹⁷, dhe në shumë rrethe të largëta të vendit ka mungesë të mjekëve specialistë, duke përfshirë edhe mjekët pediatër. Qeveria u është përgjigjur me një paketë veprimesh që përfshijnë: kurse trajnimi perinatale për stafin që kujdeset për nënat dhe të porsalindurit në të gjitha nivelet, edukim të vazhdueshëm profesional shëndetësor dhe akreditim, sisteme patronazhimi dhe bonusesh; kontrata detyruese me specialistë të rinj për të punuar në rrethe jashtë kryeqytetit; si dhe autorizimin e punonjësve që nuk kanë kontratë qeveritare të aplikojnë për të punuar në rrethe kundrejt pagesës bonus.

⁹¹ Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

⁹² Baza e të dhënave të Bankës Botërore, e disponueshme në <https://data.worldbank.org/indicator/SH.XPD.OOPC.CH.ZS?locations=AL>

⁹³ Tomini F, Tomini S., 2019. *Can people afford to pay for health care? New evidence on financial protection in Albania. Summary. [A munden njerëzit të përballojnë kujdesin shëndetësor? Evidenca të reja për mbrojtjen financiare në Shqipëri. Përmbledhje.]* Kopenhagë: Zyra Rajonale për Evropën e OBSH-së, e disponueshme në <https://www.euro.who.int/en/publications/abstracts/can-people-afford-to-pay-for-health-care-new-evidence-on-financial-protection-in-europe-2019>

⁹⁴ UNDP, Banka Botërore, EC., 2017. *Regional Roma Survey—Albania [Anketë Rajonale e Romëve - Shqipëri]*.

⁹⁵ OBSH, 2018. *Primary health care in Albania: rapid assessment* [Kujdesi shëndetësor parësor në Shqipëri: vlerësim i shpejtë]. Kopenhagë, i disponueshëm në https://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0011/373718/alb-phc-ra-eng.pdf?ua=1

⁹⁶ Gjypi AS., 2018. *Doctors leaving Albania* [Largimi i mjekëve nga Shqipëria]. Together for Life; Friedrich Ebert Stiftung. Tiranë, i disponueshëm në <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Doctors-leaving-Albania.pdf>

⁹⁷ Po aty.

Roli i rëndësishëm i kujdesit parësor lidhur me nevojat për përgjigje dhe rimëkëmbje ndaj situatës së krijuar nga COVID-19 duhet të rivlerësohet nëpërmjet rritjes së buxhetit dhe mekanizmave për të alokuar burime bazuar në nevoja. Procesi i alokimit të stafit dhe burimeve të kujdesit parësor dhe veçanërisht i specialistëve të kujdesit të nënës dhe fëmijës, duhet të shqyrtohet menjëherë. Kujdesi i shëndetit mendor në veçanti ka mungesa në burime dhe nuk ka ecuri të konsiderueshme,⁹⁸ çka bëhet shqetësuese në kuadër të numrit në rritje të adoleshentëve që kanë nevojë për shërbime nga viti në vit.⁹⁹

Kujdesi shëndetësor për nënat

Kujdesi para lindjes, që identifikohet si prioritet në politikat kombëtare shëndetësore, përfshin ekzaminime mjekësore periodike, teste laboratorike, depistime për infeksione seksualisht të transmetueshme (IST), dhe teste për faktorin Rezus. Kujdesi para dhe pas lindjes është integruar në paketën bazë të kujdesit parësor. Kujdesi gjatë lindjes në Shqipëri ofrohet nga spitalet publike në nivel rrethi, si dhe nga qendrat e kujdesit të specializuar shëndetësor (terciar), si 2 Spitalet Universitare Obstetrike, Gjinekologjike të Tiranës. Sipas anketës SDSH në Shqipëri 2018, thuhet se 9 nga 10 gra (88%) kishin marrë kujdes para lindjes nga një ofrues i kualifikuar gjatë shtatzënisë së tyre të fundit, një rënie kjo nga 97 për qind në vitin 2008. Pjesa më e madhe (70%) e kanë marrë këtë kujdes nga një mjek obstetër ose gjinekolog, 16 për qind nga mjeku i familjes dhe 2 për qind nga një infermiere ose mamë. Ndonëse është e lartë, përqindja e grave që kanë marrë kujdes para lindjes nga një ofrues i kualifikuar ndryshon sipas nivelit të arsimit dhe statusit ekonomik; luhet nga 76 për qind e grave me arsim fillor ose më të ulët në 92 për qind të grave me arsim të lartë, dhe nga 86 për qind të grave në kuintilin më të ulët të statusit ekonomik në 97 për qind të grave në kuintilin më të lartë.

Në Tiranë, qendrat e kujdesit parësor ofrojnë shërbime diagnostikuese nëpërmjet mjekëve specialistë. Por nga ana tjetër, qendrat e kujdesit parësor në zonat rurale kanë një mungesë të konsiderueshme të pajisjeve të diagnostikimit dhe të trajtimit, ku lista e pajisjeve nuk është e standardizuar për të gjitha qendrat. Ofruesit e shërbimeve dhe klientët raportuan pranë OBSH-së¹⁰⁰ se shërbimet e përfshira në paketë sipas udhëzimeve klinike, nuk ishin gjithmonë të mbuluara. Megjithatë, një pjesë e madhe e nënave shqiptare (78%) ndoqën rekomandimin e OBSH-së për të bërë të paktën katër vizita para lindjes dhe 82 për qind e kryen vizitën e parë gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë. Përqindja e lindjeve në struktura shëndetësore është gati 100 për qind, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave socio-ekonomike të nënës. Përqindja e lindjeve në strukturat shëndetësore private priret të rritet me nivelin arsimor të nënës dhe të ardhurat e familjes, ndërsa lindjet në shtëpi kanë rënë nga 3 për qind në periudhën 2008-2009 në 0.4 për qind në periudhën 2017-2018. Thuhet se një e treta (31%) e fëmijëve të lindur të gjallë në pesë vitet përpara anketës SDSH në Shqipëri 2018 kanë lindur me operacion cezarian, dhe përqindja më e lartë e nënave në këtë rast kishte arsim të lartë (41%) dhe ishin pjesë e kuintilit më të pasur (38%).

Lidhur me kujdesin pas lindjes, tre të katërtat e grave (76%) kishin bërë një kontroll brenda më pak se 4 orësh pas lindjes, ndërsa pjesës më të madhe (88%) u ishte bërë një kontroll brenda 2 ditëve të para pas lindjes së tyre të fundit. Vetëm 6 për qind të nënave nuk u ishte bërë asnjë lloj kontrolli pas lindjes, një rënie kjo nga 12 për qind gjatë viteve 2008-2009. Njësoj si me nënat, shumica dërrmuese e të porsalindurve në Shqipëri i nënshtruhet një kontrolli mjekësor fill pas lindjes. Rreth 86 për qind iu nënshtruan një kontrolli mjekësor brenda dy ditësh, 40 për qind brenda një ore, dhe 39 për qind brenda 1-3 orësh pas lindjes. Shumicës së të porsalindurve iu është bërë një test për vlerësimin e shëndetit të tyre gjatë dy ditëve të para pas lindjes. Vetëm 8.2 për qind e të porsalindurve nuk iu nënshtruan këtij vlerësimi.

⁹⁸. Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

⁹⁹. *National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21* Albania* [Raporti kombëtar i dorëzuar në përputhje me pikën 5 të shtojcës pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut, rezoluta 16/21* Shqipëri] Shkurt 2019, i disponueshëm në <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx>

¹⁰⁰. Zyra Rajonale për Evropën e OBSH-së, 2019 *Assessment of sexual, reproductive, maternal, newborn, child and adolescent health in the context of universal health coverage in Albania* [Vlerësimi i shëndetit seksual, riprodhues, të nënës, të të porsalindurit, të fëmijëve dhe adoleshentëve në kontekstin e mbulimit shëndetësor universal në Shqipëri]. Kopenhagë, i disponueshëm në <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/330457/9789289054706-eng.pdf>

Nuk ka buxhet specifik për kontrole të detajuara shëndetësore të të porsalindurve, apo kontrole të tjera me qëllim parandalimin apo zbulimin e hershëm të sëmundjeve, dhe ka buxhet të pamjaftueshëm për kujdesin për të porsalindurin në përgjithësi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të përqindjes në rritje të vdekshmërisë foshnjore në tri vitet e fundit.¹⁰¹

Shëndeti i fëmijës

Raportohet se shkalla e vdekshmërisë nën moshën 5-vjeçare në Shqipëri ishte 11 për 1,000 lindje në vitin 2019.¹⁰² Sipas SDSH në Shqipëri 2018, 2 për qind e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare kishin pasur simptoma të infeksioneve akute respiratore gjatë dy javëve përpara anketës, dhe 82 për qind kishin marrë këshilla apo trajtim. Protokoli për shërbimet parandaluese për shëndetin e nënës dhe fëmijës është shumë i hollësishëm për monitorimin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve, dhe dikton kontrole të shpeshta gjatë tri viteve të para. Më pas, kërkohet që të kryhen kontrole një herë në vit për periudhën midis vitit të katërt dhe të gjashtë të jetës. SDSH në Shqipëri 2018 zbuloi se vetëm 6 për qind e fëmijëve të lindur në 5 vitet para anketës peshonin më pak se 2,5 kg dhe nuk kishte asnjë lidhje të qartë të peshës së raportuar në lindje me nivelin e arsimit ose pasurisë së familjes, çka sugjeron se faktorët që e përcaktojnë atë nuk varen domosdoshmërisht nga gjendja socio-ekonomike.

Sipas SDSH në Shqipëri 2018, tre të katërtat (75%) e fëmijëve të grupmoshës 12-23 muajsh i kanë bërë të gjitha vaksinat bazë, 98 për qind ishin vaksinuar kundër difterit, pertusisit (kolla e mirë) dhe tetanozit, hepatitit B dhe *Haemophilus influenzae*, 96 për qind kundër poliomielit, dhe 79 për qind kundër fruthit. Më pak se 1 për qind e fëmijëve nuk kanë bërë asnjë vaksinë, ndonëse përqindja e fëmijëve që i bëjnë të gjitha vaksinat bazë ka rënë nga 94 për qind në vitin 2008. Ka një çekuilibër të dukshëm gjinor, pasi 82 për qind e djemve i kanë bërë të gjitha vaksinat bazë krahasuar me 67 për qind të vajzave. Gjinia duket se ndikon në mbulimin me vaksinat kundër difterit, pertusisit dhe tetanozit, si dhe kundër poliomielit, dhe mbulimi është dukshëm më i mirë në zona rurale sesa në zona urbane (përkatësisht 85% dhe 67%). Gjashtë për qind e fëmijëve nën moshën 5 vjeç kishin kaluar një episod diarrije gjatë dy javëve përpara anketës dhe 64 për qind e tyre kishin marrë trajtim. Dhjetë për qind e fëmijëve nga familje ku burimi i ujit të pijshëm nuk është përmirësuar kishin pasur diarre krahasuar me 5 për qind të fëmijëve që kishin burime të përmirësuara të ujit të pijshëm. Po ashtu, 15 për qind e fëmijëve nga familje me pajisje të papërmirësuara sanitare kishin pasur diarre krahasuar me 6 për qind të atyre nga familje me pajisje të përmirësuara. **Në përgjithësi, të dhënat aktuale diktojnë nevojën për përmirësimin e mekanizmave për monitorimin e zhvillimit të foshnjave dhe fëmijëve, duke u përqendruar në identifikimin e hershëm të dëmtimeve dhe kujdesin e përshtatshëm.**

Shëndeti i adoleshentëve

Shërbimet e shëndetit të adoleshentëve në Shqipëri janë pjesë e paketës së shërbimeve të kujdesit parësor, ndaj të gjithë mjekët e familjes ofrojnë shërbime për të rinjtë. Megjithatë, kjo është mjaft shqetësuese në zonat rurale ku stafit mjekësor mund t'i duhet të ndajë dhomat e pritjes së pacientëve dhe mundësia e tyre për të ruajtur konfidencialitetin është e kufizuar.

Ekzistojnë pak informacione rreth statusit të shëndetit mendor të popullsisë, sidomos tek adoleshentët, për shkak të botimeve të kufizuara në këtë fushë.¹⁰³ Megjithatë, rritja vjetore në 60 për qind (nga 2016–2017) e grupmoshës 0–14 vjeç, që kryen vizita të shëndetit mendor në poliklinikat e bashkive, dhe rritja në 89 për qind e vizitave spitalore për 0–24 vjeçarët,¹⁰⁴ kombinuar me një shkallë të lartë vetëvrasjeje prej 6.03 për 100,000 persona nga popullsia e grupmoshës 10–24 vjet,¹⁰⁵ duhet të shërbejë si alarm për

¹⁰¹. INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2016–2019*. Puna e cituar, f. 8.

¹⁰². Po aty.

¹⁰³. OBSH, 2017. *Mental Health Atlas Albania* [Atlasi i Shëndetit Mendor në Shqipëri]. I disponueshëm në https://www.who.int/mental_health/evidence/atlas/profiles-2017/ALB.pdf?ua=1.

¹⁰⁴. *National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21* Albania* [Raporti kombëtar i dorëzuar në përputhje me pikën 5 të shtojcës pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut, rezoluta 16/21* Shqipëri] Shkurt 2019, f. 84, i disponueshëm në <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/JPR/Pages/ALIndex.aspx>

¹⁰⁵. INSTAT, 2020. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2016–2018*. Tiranë, i disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2020/children-adolescents-and-youth-focused-wellbeing-indicators-data-from-2016-2018/>

ta adresuar situatën menjëherë. **Kjo duhet bërë jo vetëm duke përmirësuar shërbimet e kujdesit mendor, por edhe duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, duke investuar në programet e parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme, duke ngritur mekanizma të mbështetjes psikosociale dhe këshillimit, si dhe duke forcuar edukimin për shëndetin mendor në shkolla dhe universitete, për të rritur njohuritë për shëndetin, për të adresuar stigmën, dhe për të përmirësuar qëndrimet dhe sjelljen e adoleshentëve për të kërkuar ndihmë.**

Aksesi në shërbime për të rinjtë me aftësi të kufizuara është një problematikë specifike, për shkak të mungesës së aksesit fizik dhe qëndrimeve dhe praktikave të papërshtatshme të personelit shëndetësor ndaj personave me aftësi të kufizuara. **Është urgjente që MSHMS-ja të forcojë shërbimet shëndetësore për adoleshentët, duke u përqendruar në veçanti te shërbimet e shëndetit mendor dhe shëndetit seksual dhe riprodhues të adoleshentëve.** Të gjitha këto shërbime janë thelbësore jo vetëm për mbrojtjen e të drejtës individuale të fëmijëve për shërbime shëndetësore, por edhe për të nxitur mbulimin e adoleshentëve me shërbime, si dhe për të parandaluar rritjen e mundshme të shkallës së lindjes në adoleshencë, dhe rritjen e prevalencës dhe incidencës së Virusit të Pamjaftueshmërisë Imunitare Njerëzore (HIV) tek adoleshentët.

SDSH në Shqipëri 2018 raporton progres në lidhje me planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues, pasi 97 për qind e të gjitha grave dhe pothuajse 96 për qind e të gjithë burrave të grupmoshës 15-49 vjeç njihnin të paktën një metodë kontracepsioni dhe 100 për qind e burrave dhe grave të pamartuara dhe seksualisht aktive njihnin të paktën një metodë kontracepsioni. Megjithatë, adoleshentët shqiptarë kanë nevojë të paraqiten në qendra e kujdesit parësor për të marrë këshilla mbi shëndetin riprodhues, por iu kërkohet pëlqimi i prindërve për të marrë kontraktivë. Kjo është shqetësuese, duke pasur parasysh evidencat nga SSHFMSH 2018 që tregojnë për një rritje të lehtë të prevalencës së marrëdhënieve seksuale te të rinjtë e moshës 15-vjeçare që në vitin 2014 (përkatësisht 21% dhe 19%). Një pikëpamje më pozitive përfshin faktin se vetëm 26 për qind e pjesëmarrësve në anketën SSHFMSH 2018 kishin filluar marrëdhëniet seksuale në moshën 14-vjeçare krahasuar me 34 për qind në vitin 2014, por 47 për qind e të rinjve kishin filluar aktivitetin seksual në moshën 15-vjeçare krahasuar me 31.2 për qind në vitin 2014. Më shumë se dy e treta (67%) e 15-vjeçarëve (71% e djemve dhe 36% e vajzave) raportuan se kishin përdorur prezervativ gjatë marrëdhënies së fundit seksuale.

Mungesa e shërbimeve miqësore për adoleshentët në Shqipëri nënkupton që adoleshentët mund të shmangin kujdesin shëndetësor publik dhe strukturat private, duke mbetur kështu pa akses te kontraktivët ose duke u detyruar t'i blejnë nga burime të tjera. SDSH në Shqipëri 2018 raporton se vetëm 0.4 për qind e femrave të grupmoshës 15-19 vjeç përdorin metoda bashkëkohore të kontracepsionit, dhe se nevojat për kontracepsion e 27 për qind të vajzave të martuara në këtë fashë moshore ishin të papërmbyshura. Mungesa e shërbimeve shëndetësore të adoleshentëve mund të jetë një faktor për rritjen e shkallës së lindshmërisë gjatë adoleshencës në vend. Shkalla e abortimit te vajzat 15-19 vjeçare ishte 0.27 në 1,000 femra, çka përkthehet në 18.9 aborte për 1,000 fëmijë të lindur të gjallë.¹⁰⁶ Shtatzënia në adoleshencë, lindja e hershme e fëmijëve dhe mëmësia në adoleshencë mbartin pasoja negative socio-ekonomike dhe shëndetësore. Nënata adoleshente kanë më shumë gjasa të kenë komplikacione gjatë lindjeve, çka sjell sëmundshmëri dhe vdekshmëri më të lartë te vetë ato dhe fëmijët e tyre. Për më tepër, lindja e fëmijëve gjatë adoleshencës ka shpesh pasoja negative sociale, sidomos mbi arritjet arsimore të femrave, sepse femrat që bëhen nëna në vitet e adoleshencës kanë më shumë gjasa të marrin një arsim të cunguar dhe për pasojë të vënë në rrezik pikësynimet e tyre për të ardhmen. Ndonëse më pak se 4 për qind e vajzave të grupmoshës 15-19 vjeç e kishin filluar lindjen e fëmijëve në periudhën e realizimit të anketës SDSH në Shqipëri 2018, shkalla kombëtare e lindjes në adoleshencë ishte rritur në 3.5 për qind nga 2.8 për qind në vitin 2018, ndërsa 2 për qind tashmë kishin një fëmijë dhe një për qind ishin shtatzënë në atë kohë. Shifra kombëtare prej 3.5 për qind nuk është krejtësisht e saktë, sepse ndonëse shkalla e lindjes ishte vetëm 1 për qind te vajzat 15-vjeçare, te 19-vjeçarët ishte 7 për qind.

¹⁰⁶. INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2016-2019*. Puna e cituar, f. 8.

Ushqyerja

Të gjithë treguesit e kequshqyerjes kanë rënë ndërmjet viteve 2008-2009 dhe 2017-2018, ndonëse 11 për qind e fëmijëve shqiptarë të grupmoshave 6-59 muajsh janë të shkurtër për moshën e tyre (stunted), 2 për qind janë të dobët për gjatësinë e tyre (wasted), 16 për qind janë mbipeshë, dhe 2 për qind janë nën peshë. Raporti i fëmijëve tepër të dobët për gjatësinë e tyre dhe tepër të shkurtër për moshën e tyre ka rënë përkatësisht nga 6 për qind në më pak se 1 për qind, dhe nga 11 për qind në 4 për qind, përkatësisht. OBSH-ja dhe UNICEF-i rekomandojnë që foshnjat të ushqehen me gji brenda një ore pas lindjes, të ushqehen ekskluzivisht me gji gjatë 6 muajve të parë të jetës, dhe të vazhdojnë të ushqehen me gji deri në 2 vjeç e më tej. Duke nisur nga muaji i 6, ushqyerja me gji duhet të kombinohet me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta, të parrezikshme dhe të përshtatshme për moshën. Thua se të gjithë (93%) fëmijët e lindur gjatë dy viteve përpara anketës SDSH në Shqipëri 2018 ishin ushqyer me gji, por vetëm 57 për qind ishin ushqyer brenda një ore pas lindjes, ndonëse kjo shifër përfaqëson një rritje në përqindjen e fëmijëve që ushqehen me gji brenda një ore pas lindjes, nga 43 për qind në vitin 2008. Përqindja e fëmijëve të ushqyer me gji brenda orës së parë pas lindjes rritet bazuar edhe në statusin ekonomik të familjes.

37 për qind e fëmijëve nën 6 muajsh ushqehen ekskluzivisht me gji, dhe 11 për qind prej tyre ushqehen me gji dhe u jepet edhe uji si plotësues. Ushqyerja vetëm me gji bie lehtë me uljen e moshës, nga 47 për qind mes foshnjave 0-1 muajsh në 43 për qind mes atyre 4-5 muajsh. Rreth 58 për qind e fëmijëve vazhdojnë të ushqehen me gji gjatë vitit të parë, dhe më pak se gjysma (47%) e fëmijëve 0-23 muajsh ushqehen me gji në mënyrë të përshtatshme sipas moshës së tyre. Kohëzgjatja mesatare e ushqyerjes me gji gjatë 3 viteve që i paraprinin SDSH në Shqipëri 2018 ishte 16.8 muaj, dhe kohëzgjatja mesatare e ushqyerjes ekskluzivisht me gji ishte 3.4 muaj. Kohëzgjatja mesatare e ushqyerjes me gji është rritur nga 15 muaj në 16.8 muaj, dhe ushqyerja vetëm me gji u rrit nga 2 në 3.4 muaj ndërmjet viteve 2008-2018.

Nëntë në dhjetë (89%) e fëmijëve janë prezantuar me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta, ose të buta në moshën 6-8 muajshe. Këto ushqime kryesisht përfshinin drithërat, djathin, kosin, dhe produkte të tjera bulmeti. Konsumimi i ushqimeve dhe qumështit shtesë përveç qumështit të gjirit, rritet me rritjen e moshës, nga 7 për qind mes fëmijëve nën moshën 2 muajsh deri në 52 për qind mes fëmijëve të grupmoshës 18-23 muajsh. Po ashtu, konsumimi i drithërave rritet nga 4 për qind në 74 për qind. Gjithashtu edhe përdorimi i ushqimeve të pasura me proteina, si mishi, peshku, shpendët dhe vezët ka tendencë të pësojë rritje. **Rreth 29 për qind e fëmijëve të grupmoshës 6-23 muajsh, që jetojnë me nënat e tyre marrin minimumin e pranueshëm të dietës ditore** dhe më shumë se një në dy fëmijë (59%) ushqeheshin në përputhje me minimumin e shumëllojshmërisë ushqimore, pra, ushqeheshin me të paktën katër grupe ushqimore. Një në dy fëmijë (51%) ishin ushqyer sipas një frekuence minimale vaktesh, pra, ushqeheshin 2 - 4 herë në ditë në varësi të moshës dhe statusit të ushqyerjes me gji.

Hekuri është një komponent kyç i hemoglobinës, dhe mungesa e tij vlerësohet si përgjegjëse për gjysmën e anemisë në nivel global. Anemia pengon zhvillimin njohës, mund të vonojë rritjen dhe të rrisë mundësinë e prekjes nga sëmundjet infektive. Një në katër (25%) fëmijë shqiptarë të grupmoshës 6-49 muaj kanë anemi, 17 për qind kanë anemi të lehtë, 7 për qind kanë anemi mesatare, dhe më pak se 1 për qind kanë anemi të rëndë. Prevalenca e anemisë te fëmijët 6-59 muajsh është rritur nga 17 për qind gjatë periudhës 2008-2009 në 25 për qind gjatë periudhës 2017-2018, kryesisht për shkak të rritjes së prevalencës së anemisë së lehtë nga 11 për qind.

SSHFMSH 2018¹⁰⁷ doli në përfundimin që thua se çereku (23%) i 11–15-vjeçarëve nuk hanë kurrë mëngjes gjatë ditëve të javës dhe 9 për qind nuk hanë mëngjes në fundjavë. Më pak se gjysma (47%) kishin ngrënë fruta më shumë se një herë në ditë, por vetëm 1.2 për qind raportuan se nuk kishin konsumuar fare fruta. Vajzat (52%) raportonin konsum më të shpeshtë të frutave (më shumë se njëherë në ditë) sesa djemtë (42%). Më pak se një e treta (rreth 31%) e të rinjve të anketuar konsumonin perime më shumë se njëherë në ditë, ndërsa pak më shumë se 3 për qind nuk konsumonin perime. Vajzat (34%)

¹⁰⁷ Health Behaviour in School-age Children of 11, 13 and 15 years: Main findings (2018) [Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijëve në Moshë Shkollore 11, 13, dhe 15 vjeç: Gjetjet kryesore (2018)]. Puna e cituar.

raportonin konsum më të shpeshtë të perimeve (më shumë se njëherë në ditë) sesa djemtë (29%). Në vitin 2018, prevalenca e nënpeshës te fëmijët në moshë shkollore (klasa 1, 4, dhe 8) ishte 3.2 për qind, ndërsa prevalenca e mbipeshës dhe obezitetit ishte rreth 17 për qind dhe 11 për qind, përkatësisht. Prevalenca e obezitetit ishte shumë më e lartë te djemtë dhe ata që jetonin në zona urbane.¹⁰⁸

Përmirësimi i sjelljeve të adoleshentëve në lidhje me ushqyerjen dhe i gjendjes së tyre shëndetësore mbeten tejet të rëndësishme. Vetëm masat e koordinuara midis institucioneve përkatëse mund të sjellin rezultate. Përpjekjet për të zbatuar legjislacionin ekzistues dhe për të monitoruar masat e ndërmarra duhet të forcohen.¹⁰⁹

Infeksione Seksualisht të Transmetueshme

Rezultatet e SDSH në Shqipëri 2018 tregojnë se **shumë pak shqiptarë të rritur kanë njohuri të sakta rreth mënyrave përmes të cilave mund të transmetohet ose jo virusi HIV.** Vetëm dy të tretat e grave (66%) dhe gjysma (48%) e burrave e dinë se një person në dukje i shëndetshëm mund të jetë i infektuar me virusin HIV. Po ashtu, më pak se gjysma e të anketuarve (46% e grave dhe 42% e burrave) besojnë se nuk infektohen nëse ndajnë ushqimin me një person që vuan nga HIV-i. Kjo tregon se përqindja e burrave dhe grave me njohuri të gjithanshme rreth HIV/SIDA mbetet veçanërisht e pandryshuar nga viti 2008 deri në vitin 2018. Fatmirësisht, thuajse tre të katërtat (74%) e grave të grupmoshës 15-49 vjeç e dinë se HIV-i mund të transmetohet gjatë shtatzënisë, 70 për qind e dinë se mund të transmetohet gjatë lindjes, dhe 69 për qind e dinë se mund të transmetohet gjatë ushqyerjes me gji, 63 për qind e grave i njohin të tri mënyrat e transmetimit. Një e treta e grave (29%) dhe 22 për qind e burrave e dinë se rreziku i transmetimit nga nëna tek fëmija mund të ulet nëse nëna merr ilaçe të posaçme. **Megjithëse raportimet për HIV janë shumë të ulëta në Shqipëri, transmetimi nga nëna te fëmija është shqetësim në rritje dhe përbën 3,5 për qind të rasteve të raportuara në vitin 2018.**¹¹⁰

Shumica e infektiveve me HIV në Shqipëri janë rezultat i kontakteve heteroseksuale. Shumica e grave janë infektuar nga bashkëshortët (veçanërisht ata bashkëshortë që kanë migruar dhe banuar jashtë shtetit). SDSH në Shqipëri 2018 tregon gjithashtu se shpesh bashkëshortët/partnerët meshkuj e refuzojnë kërkesën e partnereve për të përdorur prezervativë ose metoda të tjera kontracepsioni. Ndaj, kufizimi i numrit të partnerëve seksual dhe marrëdhëniet seksuale me masa mbrojtëse janë faktorë kyç. Megjithëse më pak se 1 për qind e grave të grupmoshës 15-49 vjeç raportuan të kishin pasur më shumë se një partner seksual gjatë 12 muajve të fundit, 7 për qind kishin kryer marrëdhënie seksuale me një person që nuk ishte as bashkëshorti dhe as partneri i tyre, dhe vetëm 18 për qind raportuan se kishin përdorur prezervativ gjatë raportit të fundit seksual me një person të atillë. Vetëm 3 për qind e meshkujve të grupmoshës 15-49 vjeç raportuan se kishin pasur më shumë se një partner/e seksual/e gjatë 12 muajve pararendës, por vetëm 59 për qind e tyre raportuan se kishin përdorur prezervativ. 26 për qind e burrave raportuan të kishin kryer marrëdhënie seksuale me një person që as nuk ishte gruaja e tyre dhe as nuk jetonte me ta, dhe 43 për qind e tyre nuk kishin përdorur një prezervativ gjatë raportit të fundit seksual me atë person. Interesant është fakti se burrat e grupmoshës 15-19 vjeç kanë më shumë gjasa (76%) që të kenë përdorur një prezervativ gjatë marrëdhënies së tyre më të fundit seksuale se sa burrat më të mëdhenj në moshë. Gjithashtu, përqindja e grave që kanë pasur marrëdhënie seksuale me një partner që as nuk ishte bashkëshorti i tyre dhe as nuk kishte jetuar me to gjatë 12 muajve të fundit rritet me rritjen e nivelit arsimor, nga 1 për qind mes grave të paarsimuara në 12 për qind mes atyre me nivel arsimor më të lartë se arsimi i mesëm.

Një nga katër femra dhe meshkuj të grupmoshës 15-49 vjeç e dinë se ku mund të testohen për HIV, por gratë kanë dy herë më shumë gjasa (4%) sesa burrat (2%) të jenë testuar për HIV, dhe gjatë dekadës së fundit testimi për HIV është rritur vetëm nga 2 për qind në 4 për qind. Është shqetësues fakti se gratë në zonat rurale kanë tri herë më pak gjasa që të testohen gjatë kujdesit prenatal (4%, 12% në

¹⁰⁸. Hyska J., Burazeri G., Menza V., 2018. *Assessment of nutritional status and nutrition-related knowledge, attitudes and practices among school-aged children in Albania 2017–2018* [Vlerësim i statusit të ushqyerjes dhe njohurive, qëndrimeve dhe praktikave në lidhje me ushqyerjen të fëmijëve në moshë shkollore në Shqipëri 2017 - 2018]. FAO. Tiranë.

¹⁰⁹. MHSP, 2021. *Raporti 4-Vjeçar i Zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 - 2020*. Prill 2021 Tiranë.

¹¹⁰. INSTAT, 2020. *Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2020*. Puna e cituar, f. 138, dhe SDSH, 2018, puna e cituar, f. 93.

zonat urbane), dhe asnjë grua me arsim fillor apo më pak nuk është testuar, si dhe vetëm 2 për qind e atyre në kuintilin më të varfër. **Është pikërisht grupi i femrave më pak të testuara: grupmosha 15-19 vjeç (16%), në zona rurale (14%), pa arsim ose me arsim fillor (14%), dhe në kuintilin më të varfër (16%), që ka më gjasa të raportojë se vuan nga një Infeksion Seksualisht i Transmetueshëm (IST) ose ka simptoma të një IST-je.** Megjithëse vetëm 10 për qind e femrave dhe 2 për qind e meshkujve të grupmoshës 15-49 vjeç kanë raportuar shfaqjen e një simptome të lidhur me një IST, më pak se gjysma e tyre (44% gratë, 28% burrat) kanë kërkuar këshillim ose trajtim nga një klinikë, spital, mjek ose profesionist tjetër i shëndetësisë. Kjo nënkupton se mund të ketë një numër më të madh vajzash dhe grash asimptomatike me status HIV pozitiv ose që nuk kanë gjasa të kërkojnë testime, këshillim apo trajtim.

Në Shqipëri, vetëm 35 për qind e femrave dhe 45 për qind e meshkujve të grupmoshës 15-24 vjeç kanë njohuri të gjithanshme rreth HIV-it, duke përfshirë njohuritë që prezervativët duhet të përdoren vazhdimisht gjatë marrëdhënieve seksuale dhe që rreziku i infektimit me HIV mund të reduktohet nëse kanë vetëm një partner/e të pafektuar besnik/e. Njohuritë rreth rrezikut të HIV-it dhe mënyrës së uljes së tij janë shumë të rëndësishme. Megjithatë negociimi i aktivitetit seksual është faktori kryesor që përcakton përhapjen e HIV-it në Shqipëri, veçanërisht mes të rinjve. Të rinjtë që e nisin aktivitetin seksual në moshë të hershme janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të marrjes së IST-ve, ose të një shtatzënie. **1 për qind e femrave dhe 3 për qind e meshkujve të grupmoshës 15-24 vjeç raportuan se kanë pasur marrëdhënien e tyre të parë seksuale përpara moshës 14 vjeç, dhe 14 për qind e femrave dhe 23 për qind e meshkujve nga kjo grupmoshë u shprehën se kanë kryer marrëdhënie seksuale përpara moshës 18 vjeç.** Ndonëse djemtë e grupmoshës 15-19 vjeç kanë më gjasa të përdorin prezervativ sesa meshkujt në moshë më të madhe, është e qartë se vajzat e grupmoshës 15-19 vjeç, grupi i femrave më pak të testuara, janë në rrezik më të lartë të seksit pa mbrojtje: SDSH në Shqipëri 2018 vëren se 16 për qind e personave të testuar për IST në këtë grupmoshë përbënin grupin ku shkalla e abortit ishte më e larta. **Duke pasur parasysh këto shifra, mungesa e një shërbimi shëndetësor diskret për shëndetin seksual dhe riprodhues të të rinjve duket si një rrezik i panevojshëm.**

3.2 E DREJTA PËR MIRËQENIE

Konteksti i përgjithshëm

Sistemi shqiptar i mirëqenies përbëhet nga disa shtylla, që mund të arrihen përmes programeve të mbrojtjes sociale, si: skemat e pensionit, programet e nxitjes së punësimit dhe NE. **Asistenca sociale për familjet përmban kryesisht asistencë në të holla, me investime minimale në mbështetjen sociale dhe shërbimet e kujdesit social. Skema kryesore e asistencës në të holla synon reduktimin e varfërisë, por, për fat të keq, ka treguar se ka ndikim të kufizuar dhe nuk i shënjestron mjaftueshëm familjet në nevojë.**¹¹¹

Si pasojë e mbulimit të kufizuar të familjeve me fëmijë, shënjestrimin joefikas dhe vlerës së ulët monetare të transfertave në të holla për familje, skema kombëtare e NE-së ka hasur sfida për t'i mbrojtur siç duhet fëmijët nga varfëria dhe privimi. Transfertat e tjera që iu janë ofruar familjeve shqiptare, ndonëse jo rregullisht dhe jo si pjesë e buxhetit për mbrojtjen sociale, përfshijnë subvencionet për faturat e energjisë elektrike, konsumin e ujit, vaktet falas në shkollë dhe tekstet shkollore falas për fëmijët e familjeve të varfra ose të cenueshme, si dhe transportin publik falas për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Megjithatë, ka pak informacion mbi mbulimin e tyre, efikasitetin ose ndikimin që ato kanë në arritjen e barazisë. **Struktura dhe mekanizmat institucionale të mbrojtjes sociale kërkojnë një qasje më sistemike për t'iu përgjigjur natyrës shumëdimensionale të varfërisë, privimit dhe të cenueshmërisë që përjetojnë fëmijët dhe familjet.**

Kuadri i mbrojtjes sociale

MSHMS-ja është institucioni qeveritar përgjegjës për mbrojtjen sociale, për hartimin dhe zhvillimin e politikave, dhe për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të politikave kombëtare për mbrojtjen sociale, kujdesin dhe integrimin e individëve dhe grupeve në nevojë. Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është institucion në varësi të MSHMS-së, përgjegjës për zbatimin e politikave të veçanta lidhur me NE-në, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e kujdesit social. Përpara vitit 2016, mbrojtja sociale në Shqipëri ishte e orientuar drejt skemave të transfertave në të holla, por legjislacioni i ri¹¹² ka mundësuar deinstitutionalizimin, delegimin e përgjegjësisë pranë NJQV-ve, ka parashikuar një portofol bazë për shërbimet e detyrueshme të përkujdesit shoqëror në nivelin vendor, ka ngritur struktura monitorimi dhe kontrolli, si dhe ka vendosur kritere licensimi dhe akreditimi për ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Në përgjithësi, shumica e investimeve në mbrojtjen sociale në Shqipëri ishte 9,47 për qind e PBB-së në vitin 2019¹¹³, duke përfshirë pensionet e të moshuarve, asistencën sociale, programet e tregut të punës, shërbimet e kujdesit social, dhe komponentë të tjerë. Shifra

¹¹¹ Komisioni Evropian, 2019. *Staff Working Document: Economic Reform Programme of Albania 2019–2021*. [Dokument Pune për Stafin: Programi i Reformës Ekonomike në Shqipëri 2019 - 2021]. Raport DPS; 166; 2019. Bruksel.

¹¹² Ligji dhe aktet nënligjore: Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".

¹¹³ *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2016–2019*. Puna e cituar.



@UNICE Albania 2016 Pirozzi

përfaqëson **thujtë gjysmën e mesatares së BE-së¹¹⁴ dhe më pak se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, përveç Maqedonisë së Veriut.**¹¹⁵ Duke marrë parasysh prirjet demografike të vendit, është e kuptueshme që pensionet zënë rreth 70 për qind të shpenzimeve totale për mbrojtjen sociale në vend.¹¹⁶

Në vitin 2016, me mbështetjen e BB-së, qeveria e Shqipërisë filloi reformën në programin e asistencës sociale, me qëllim forcimin e konceptimit, administrimit dhe qeverisjes së transfertave në të holla. Sipas një studimi të mbështetur nga UNICEF-i, familjet e radhitura në 20 për qind dhe 40 për qind e fundit tanimë kanë 2.7 herë dhe 2.8 herë më shumë gjasa që të përfitojnë NE, krahasuar me familjet e tjera. Krahas kësaj, studimi tregoi që gjatë periudhës 2017 - 2018, përqindja e familjeve me një ose dy pjesëtarë që përfitonin NE ra me më shumë se 50 për qind, ndërsa përqindja e familjeve me katër ose pesë pjesëtarë që përfitojnë NE u rrit.¹¹⁷ Megjithatë, numri i përgjithshëm i familjeve që përfitojnë NE ra nga 80,057 në vitin 2015 në 60,496 në vitin 2019. **Shuma mesatare e NE-së është jashtëzakonisht e vogël¹¹⁸, ndaj nuk mund t'i nxjerrë familjet nga cikli i varfërisë.** Vlera maksimale e NE-së është rreth vetëm 25 për qind e shpenzimeve mujore mesatare të familjeve në 20 për qindëshin e fundit.¹¹⁹

Në vitin 2018, u krijua Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Social,¹²⁰ që përmban një bazë të dhënash elektronike për përfituesit, ofruesit, institucionet përgjegjëse, si dhe llojin dhe kohëzgjatjen e shërbimeve të kujdesit social. Regjistri ka integruar NE-në dhe ka mundësuar menaxhimin më të mirë të fondeve, por nuk funksionon ende në çdo bashki. Krahas kësaj, MSHMS-ja ka mbështetur edhe përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimit. Ligji parashikon një procedurë ankese me tri faza,¹²¹ ku iu jep aplikantëve të drejtën për të paraqitur një ankesë në bashki, prefekturë dhe gjykatë administrative në lidhje me refuzimin e një aplikimi.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS) është shtyrë deri në vitin 2023. Strategjia konsolidon monitorimin dhe kontrollin e sistemit të përfitimeve dhe lehtëson proceset e aplikimit dhe vendimmarrjes. Megjithatë, nuk ka përpunuar dhe nuk ka rregulluar sistemin aktual të mbrojtjes sociale, që vazhdon të përfshijë tri fusha prioritare: zbutja e varfërisë, përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, dhe zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror. SKMS-ja nënvijëzon masat për reforma vertikale në këto fusha prioritare, por mungojnë instrumentet, standardet dhe masat për të ofruar mbrojtje sociale të integruar.

Megjithëse rezultuan të suksesshme në mbajtjen e parametrave të pandemisë në nivele relativisht të ulëta, masat parandaluese të prezantuara nga qeveria si përgjigje ndaj COVID-19 sollën në mënyrë të pashmangshme një faturë të rëndë për popullsinë, veçanërisht për familjet më të cenueshme¹²². Izolimi shkaktoi rritjen e papunësisë dhe varfërisë së personave që punojnë në sektorin joformal, të personave që varen nga pagesa e përditshme, dhe të të vetëpunësuarve. Mbyllja e shërbimeve publike goditi edhe më rëndë personat, të cilët faktikisht kishin vështirësi për t'i aksesuar këto shërbime dhe kishin pak akses në kanalet e komunikimit. Familjeve iu desh të përshtateshin me përgjegjësitë e reja të kujdesit

¹¹⁴ Nikoloski Z. 2019. *Mapping Social Protection Transfers to Poor Households in Albania* [Hartëzimi i Transfertave të Mbrojtjes Sociale të Familjet e Varfra në Shqipëri]. UNICEF në Shqipëri, maj 2019. Tiranë.

¹¹⁵ Banka Botërore, 2020. *Raporti Ekonomik Periodik për Ballkanin Perëndimor Nr. 15 [Western Balkans Regular Economic Report 15.]* [Raporti Ekonomik Periodik për Ballkanin Perëndimor Nr. 15. Kërkohet Momentum me Reformën]. Spring 2019.

¹¹⁶ Nikoloski Z., 2019. *Mapping Social Protection Transfers to Poor Households in Albania* [Hartëzimi i Transfertave të Mbrojtjes Sociale të Familjes e Varfra në Shqipëri]. UNICEF në Shqipëri, Tiranë, puna e cituar.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ Po aty.

¹²⁰ Vendimi Nr. 136, datë 07.03.2018 "Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror".

¹²¹ Neni 41/1, Ligji Nr. 44/2016.

¹²² [Metanji B., Elezaj D., Peci Dh., 2021. Knowledge, attitude and practices with regard to Covid-19 among the general population in Albania: Findings on national survey of second wave. \[Njohuri, qëndrime dhe praktika në lidhje me COVID-19 te popullsia e gjërë në Shqipëri: Gjetje të anketës kombëtare të valës së dytë\]. USAID, UNICEF në Shqipëri, IDRA.](#)

për fëmijët, ku grave iu binte një barrë e shtuar¹²³. Distancimi social dhe izolimi i detyruar mund të kenë reduktuar edhe aksesin në mbështetjen komunitare informale, si dhe në mekanizmat e kufizuar të mbështetjes formale të disponueshme në nivel vendor.

Gjatë përgatitjes së një përgjigjeje të re të mbrojtjes sociale ndaj situatës së krijuar nga COVID-19 duhet marrë parasysh nevoja e qartë për një mekanizëm, që garanton lidhjen e efektshme midis mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijës, dhe sektorëve të tjerë socialë. Alokimi i burimeve për mbrojtjen sociale është rritur ndjeshëm, dhe shpërndarja e burimeve duhet të shqyrtohet me ngushtëri, me qëllim mbështetjen e familjeve me fëmijë, veçanërisht ato më të cenueshmet. Elementi më i rëndësishëm është që sistemi i mbrojtjes sociale të informohet nga rrezikshmëria dhe të mundësojë përgjigjen ndaj dëmeve të mundshme të fatkeqësive apo situatave emergjente, me qëllim që të përballojë me efektshmëri çdo situatë, si tërmeti i nëntorit 2019 dhe COVID-19.

Lehtësimi dhe zbutja e varfërisë

Skema e rishikuar e NE-së filloi në janar 2018. Falë heqjes së disa kritereve përjashtuese, 18,730 familje të reja aplikuan për ndihmë; në të njëjtën kohë, rreth 20,000 aplikantë u përjashtuan/refuzuan për shkak të abuzimeve ose deklaratave të rreme.¹²⁴ **Familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet e cenueshme janë kryesisht përfituesit e reformave, dhe mesa duket kriteret e reja të përzgjedhjes shënjestrojnë përgjithësisht familjet më të varfra.** Në përgjithësi, familjet përfituese janë ato më të mëdhatë, me shumë fëmijë, me kushte të vështira banimi dhe me shpenzime më të ulëta për familje sesa ato të përjashtuara nga skema e re. Që prej janarit 2019, qeveria prezantoi një skemë të re që ofron një bonus të njëhershëm për çdo të porsalindur, pavarësisht të ardhurave të prindërve.

Ministria iu mundësoi Këshillave Bashkiakë të japin NE për ato familje në nevojë, të cilat sipas skemës së pikëzimit nuk janë konsideruar të pranueshme për NE-në, duke i lejuar qeverisjes vendore të ndihmojë familjet që konsiderohen të varfra sipas kritereve të veta. Kjo duhet paguar duke dhënë një fond shtesë në nivelin e 6 për qind ¹²⁵ mbi NE për bashkinë përkatëse. Do të jetë e rëndësishme që të qartësohen kriteret e pranueshmërisë në këtë skemë dhe zbatimi i njëtrajtshëm i tyre në të gjitha bashkitë. Po kështu, të sigurohet që ka mjaftueshëm fonde të vendosura në dispozicion, në mënyrë që asistencë e NJQV-së të mos konsiderohet si një përfitim i shkallës së ulët për ata që nuk konsiderohen të pranueshëm për NE-në, veçanërisht nëse kriteret e pranueshmërisë lidhen me mundësitë për punësim.

Është e rëndësishme të vërehet se SKMS-ja as nuk orientohet nga matjet kombëtare periodike të varfërisë, dhe as nuk përfshin një objektiv për të reduktuar varfërinë në përputhje me OZHQ-të.

SKMS-ja synon integrimin e familjeve në skemën e NE-së në jetën sociale të komunitetit, përmes programeve të promovimit në punë dhe formimit profesional, që lehtësojnë futjen e personave aktivë në moshë pune në tregun e punës. Gjatë periudhës 2018 - 2019, 5,697 persona kanë filluar punë dhe 846 të tjerë janë regjistruar në programe¹²⁶ të arsimit profesional. Të gjithë aplikantët për NE duhet të regjistrohen çdo muaj si punëkërkuar të papunë. Kjo praktikë mendohet se ka pasur rezultate pozitive në punësimin e personave në moshë pune, të cilët vijnë nga familje të varfra. **Ndonëse ofrimi i mundësive për trajnim dhe sistemim në punë të përfituesve të NE-së është padyshim diçka pozitive, vendosja e shenjës së barazimit ndërmjet punësimit dhe eliminimit të varfërisë në familje mund të mbartë rreziqe. Duket qartas se është një faktor kyç në nxitjen e kohezionit social dhe të përfshirjes sociale, por theksi i tepërt te punësimi për zgjidhjen e varfërisë së familjes mund të shpërfillë tiparin dallues të aftësive të pamjaftueshme dhe pagave të ulëta në tregun shqiptar të punësimit, dhe përjashtimin e shumë grave veçanërisht nga tregu formal i punës. Kjo politikë duhet të lidhet**

¹²³. Shihni Plaku A., 2020. *The Impact of Covid-19 on Women's and Men's Lives and Livelihoods in Albania: Results of a Rapid Gender Assessment*. [Ndikimi i COVID-19 mbi jetën dhe kushtet e jetesës së burrave dhe grave në Shqipëri: Rezultate të një vlerësimi të shpejtë gjinor]. UN Women, i disponueshëm në <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/the-impact-of-covid-19#view>

¹²⁴. MSHMS, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023.

¹²⁵. Udhëzimi Nr. 5, datë 17.02.2017, "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%".

¹²⁶. MHSP, 2021. *Raporti 4-Vjeçar i Zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020*. Puna e cituar.

me përmirësimet në modelet e punësimit dhe nivelet e pagave, nëse synon që të ketë sukses në reduktimin e ndjeshëm të përqindjes së varfërisë së familjeve. Krahas kësaj, duhen kryer investime në shërbimet për futjen në punë, të cilat janë të kufizuara në Shqipëri.

MSHMS-ja po harton një “strategji daljeje”, që synon të kufizojë qëndrimin në skemë të familjeve deri në pesë vjet. Kjo strategji daljeje mbështetet në supozimin se familjet mund të integrohen plotësisht në tregun e punës brenda pesë vjetësh, duke i lidhur programet e mbrojtjes sociale me skema të tjera incentivash. Ndonëse fokusi kryesor është ofrimi i një pakete të posaçme shërbimesh për përfituesit e NE-së, që bazohet në një sërë ndërmarrjesh sociale, lë hapur edhe mundësinë e tërheqjes së paketave të NE-së mbështetur në pjesëmarrjen në nismat e “zhvillimit territorial”, si zhvillimi rural dhe zhvillimi i infrastrukturës. Këto nisma mund të jenë gurë themeli për punësim të mëtejshëm, por **duke marrë parasysh tregun e punës dhe prirjet e punësimit në Shqipëri, ekziston rreziku që do të shndërrohen në modelin e punimeve publike, që i mbajnë të rinjtë e papunësuar në punë me paga të ulëta.**¹²⁷ Pa angazhimin e agjencive publike të punësimit për të trajtuar diskriminimin e punonjësve, ekziston rreziku që komuniteti rom dhe grupe të tjera të cenueshme të popullsisë të vijojnë të mos punësohen rregullisht, dhe të përfundojnë në një sërë skemash të punëve publike.

Pavarësisht reformave të fundit, ende nuk është e mundur që të vlerësohet kapaciteti i sistemit ekzistues për të përballuar nivelet e rritura të varfërisë së familjeve që kanë gjasa të pasojnë pandeminë. Si përgjigje ndaj krizës së krijuar nga COVID-19, qeveria e dyfishoi shumën e asistencës në të holla për përfitues, dhe zgjeroi grupin e personave përfitues. Qeveria ofroi kompensim financiar për të vetëpunësuarit, dhe subvencione për bizneset e vogla, në mënyrë që të paguanin punonjësit e tyre. Skema e re e transfertave të pakushtëzuara në të holla të njëhershme, që u pilotua si pjesë e përgjigjes ndaj situatës së krijuar nga COVID-19, iu solli përfitime 2,800 fëmijëve në 1,699 familje.¹²⁸ **Por, ekziston nevoja e qartë për të pasur njohuri të thelluara për varfërinë e fëmijëve, me qëllim që politikëbërësit të kuptojnë natyrën shumëdimensionale të varfërisë së fëmijëve dhe sfidat me të cilat përballen familjet e varfra.**

Si pjesë e planifikimit të saj afatgjatë, qeveria duhet të vazhdojë me përpjekjet për të reduktuar varfërinë dhe pabarazinë përmes një sistemi rikuperues të mbrojtjes sociale dhe pro-të varfërve, që mbron jetën dhe kushtet e jetesës së njerëzve. Ky sistem duhet të zbusë pasojat ekonomike negative gjatë krizave dhe periudhës së rimëkëmbjes ndaj tyre, si dhe duhet të mbështetë familjet e cenueshme, që rrezikojnë të mbeten pas, në marrjen e shërbimeve të mbështetjes sociale (duke përfshirë arsimin, kujdesin social, parandalimin e dhunës, dhe mbrojtjen e fëmijës), edhe në rrethanat e reja të krijuara nga COVID-19. Krahas kësaj, duhet të zgjerohet dhe të ndryshojë sistemin ekzistues të NE-së për ta shndërruar atë në një sistem mbështetës të mirëqenies, miqësor me fëmijën dhe të përqendruar te familja, i cili ka fleksibilitet dhe lehtëson ofrimin e një shërbimi të përshtatur për familjet e varfra, që iu mundëson atyre të përmbushin nevojat bazë dhe të ngutshme duke punuar drejt një rrugë realiste dhe të qëndrueshme për të dalë nga varfëria, pavarësisht sa kohë mund të duhet për këtë.

¹²⁷ Për të gjetur shembuj të praktikave të mira dhe të këqija në këtë fushë, shihni “Employment” [Punësimi] nga Agata Scharle in Hojsik M., Fremlova L., (eds), 2020. *A synthesis of civil society’s reports on the implementation of national Roma integration strategies in the European Union Assessing the progress in four key policy areas* [Një sintezë e raporteve të shoqërisë civile për zbatimin e strategjive kombëtare për integrimin e romës në Bashkimin Evropian Vlerësimi i ecurisë në katër fushat kryesore të politikave]. Qendra për Studime Politikash e Universitetit të Evropës Qendrore. Bruksel, i disponueshëm në <https://cps.ceu.edu/sites/cps.ceu.edu/files/attachment/basicpage/3172/rcm-civil-society-monitoring-report-synthesis27-2019-eprint-fin.pdf> dhe Pecak M., Szira J., në diskutimin ‘Arsimi’, në të njëjtin vëllim, adreson disa nga pasojat e të qenit një rom i paarsimuar, i papunësuar dhe i paformuar (PPP), si dhe pasojat e sistemit të gjerë të arsimit.

¹²⁸ MSHMS, 2021. *Raporti 4-Vjeçar i Zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020*. Puna e cituar.

Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Sipas SHSSH, numri i personave që njihen zyrtarisht si persona me aftësi të kufizuara në Shqipëri u rrit me 19 për qind nga 2018 në 2020. Sistemi i ri tani mbështet 168,243 individë¹²⁹ (5.9% e popullsisë së vendit). Numri¹³⁰ i fëmijëve që përfitojnë nga skema e aftësisë së kufizuar në vitin 2019 ishte 15,321, 46 për qind prej të cilëve ishin vajza. Ligji i vitit 2014 për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara parashikon në nenin 10 krijimin e një komisioni shumëdisiplinor për të vlerësuar aftësinë e kufizuar bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF).¹³¹ Megjithatë, vlerësimi mjekësor për aftësinë e kufizuar ende mbizotëron, dhe përmes tij, fëmijët me aftësitë të kufizuara të lehta ose mesatare nuk përcaktohen si persona me aftësi të kufizuara. Kjo ndikon në përcaktimin e normës së prevalencës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe aftësisë së familjeve të tyre për të marrë mbështetjen dhe shërbimet për fëmijën me aftësi të kufizuara të lehtë ose mesatare.¹³²

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara¹³³ në vitin 2019 shprehu shqetësime mbi përpjekjet e pamjaftueshme të bëra për rishikimin e legjislacionit ekzistues në Shqipëri dhe për interpretimin e modelit bio-psiko-social në reformimin e sistemeve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Angazhimi i qeverisë për miratimin e KNF-së nuk është i qartë në SKMS.



@UNICEF Albania Benzenberg 2018

Që prej vitit 2018, janë bërë përmirësime në drejtim të dokumentacionit të integruar dhe reduktimit të burokracisë, duke shkurtuar vonesat në vendimmarrje. Institucionet publike tanimë kryejnë procesin e diagnostikimit dhe referimin e rasteve për vlerësim, dhe janë përgjegjëse për qarkullimin e dokumentacionit nga një institucion te tjetri, çka më parë realizohej nga vetë aplikanti. Tashmë, individët me aftësi të kufizuara paraqiten për diagnostikim dhe ekzaminim vetëm pranë strukturave shëndetësore, dhe vlerësimi kryhet në bazë të dokumentacionit mjekësor, duke shmangur në këtë mënyrë paraqitjen e tyre fizike. Me kalimin e viteve është rritur përqindja e përfitimeve me rreth 2-4 për qind çdo vit.¹³⁴ Vlerësimi i aftësive për të kryer detyrat bazë të jetës në përputhje me moshën tregon qartas praninë dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, pavarësisht vlerësimeve të fryra, subjektive dhe abuzive të disa mjekëve. **Qëllimi i reformës së sistemit të vlerësimit të**

¹²⁹ MSHMS, 2020. Raporti i programit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale.

¹³⁰ Shihni panelin e ASHMDF-së me statistika <http://statistikafemijet.gov.al/index.php?searching=true#treguesit>

¹³¹ Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, i njohur zakonisht si KNF, është një klasifikim i shëndetit dhe i fushave lidhur me shëndetin. Duke qenë se funksionimi dhe aftësia e kufizuar e një individi ndodh në një kontekst të caktuar, KNF-ja përfshin edhe një listë të faktorëve mjedisorë. KNF-ja është kuadri i OBSH-së për vlerësimin e shëndetit dhe aftësisë së kufizuar, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel popullatë. KNF-ja u miratua zyrtarisht nga të 191 vendet anëtare të OBSH-së në Asambleshën e 54-t Botërore të Shëndetësisë, më 22 maj 2001 (rezoluta [ABSH 54.21](#)), si standardi ndërkombëtar për të përshkruar dhe për të vlerësuar shëndetin dhe aftësinë e kufizuar. KNF-ja funksionon nëpërmjet Programit të OBSH-së për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar (WHODAS 2.0). WHODAS 2.0 u zhvillua përmes një qasjeje bashkëpunuese ndërkombëtare, me synim zhvillimin e një instrumenti të vetëm të përgjithshëm për vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar ndërmjet kulturave dhe mjedisve të ndryshme. Për më shumë informacion, shihni <https://www.who.int/classifications/icf/en/>

¹³² Shihni Rogers J. Sammon E. 2018. *We All Matter* [Të gjithë jemi të rëndësishëm]. UNICEF Tiranë, i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/reports/we-all-matter>

¹³³ Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2019. *Concluding observations on the initial report of Albania CRPD/C/ALB/CO/1* UNHCHR [Vëzhgime Përfundimtare rreth Raportit Fillestar të Shqipërisë CRPD/C/ALB/CO/1 UNHCHR Gjenvë, i disponueshëm në https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/ALB/CO/1&Lang=En

¹³⁴ MSHMS Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020–2023.

aftësisë së kufizuar lidhet më shumë me përmirësimin e efikasitetit të procesit të vlerësimit, duke ofruar mekanizma administrativë që reduktojnë ndjeshëm përqindjen e abuzimit dhe koston e vlerësimit, dhe jo mjaftueshëm për të përmirësuar shërbimet në vend që të nxisin përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuar.¹³⁵ Reforma për sistemin e mbrojtjes sociale duhet të garantojë planifikimin e duhur të transfertave në të holla për fëmijët me aftësi të kufizuara, që mbulojnë jo vetëm pagesat në të holla për fëmijën dhe familjen e vet, por edhe shumat e nevojshme për shërbimet në komunitet, të cilat janë kyç për të mbështetur riintegrimin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Shërbimet e Kujdesit Shoqëror

Prioriteti i tretë kryesor i SKMS-së është zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, pasi ato ndikojnë në përfshirjen sociale, aksesin e lehtësuar në shërbime, dhe përmirësimin e jetesës dhe mirëqenies së fëmijëve, individëve dhe familjeve. Ky është një element veçanërisht jetik i Strategjisë, pasi suksesi i dy elementeve të tjera varet gjerësisht po nga ky element, i cili vepron edhe si një rrjetë sigurie për to. Megjithatë, aktualisht shërbimet e kujdesit shoqëror që financohen nga fondet publike janë shumë të kufizuara.

Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror¹³⁶ parashikon për herë të parë listën e shërbimeve, rregullat për sigurimin dhe ofrimin e kujdesit shoqëror, të cilat ndikojnë në standardet e jetesës së individëve dhe familjeve në nevojë. Përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve kyç iu është deleguar NJQV-ve. Për këtë kërkohen mekanizma të reja të financimit dhe menaxhimit të efektshëm për ofrimin e shërbimeve të koordinuara ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes, por këto detaje ende nuk janë përcaktuar tërësisht. Që nga viti 2005, qeveritë e njëpasnjëshme kanë hyrë në një proces të gjerë reformash të shërbimeve të kujdesit shoqëror, por procesi ka qenë i paqëndrueshëm, pasi nuk është gjetur dhe nuk është zbatuar një formulë e besueshme për financimin e shërbimeve të kujdesit social. Në vitin 2018, Shqipëria miratoi vendimin për “Funksionimin e Fondit Social”, i cili mundëson që bashkitë të krijojnë shërbime të kujdesit shoqëror për grupet e cënueshme, duke garantuar shërbime minimale, dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale që specifikohen në planin social të bashkisë. Ky mekanizëm po ngrihet, por jo të gjitha NJQV-të e kanë aksesuar atë. Si rrjedhojë, pavarësisht pilotimit të një sërë nismash të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin vendor në vitin 2019, shërbimet për fëmijët arrijnë vetëm 27 për qind të shërbimeve publike të ofruara, ndërsa rreth 69 qendra sociale ofrojnë shërbime për fëmijët. Ndonëse 50 bashki tanimë kanë miratuar planet vendore të kujdesit social, 37 bashki (61%) nuk ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara.¹³⁷ Shërbimet e kujdesit shoqëror të ofruara përmes sektorit jopublik arrijnë deri në 46 për qind të të gjitha shërbimeve të ofruara¹³⁸ dhe kryesisht financohen nga partnerët ndërkombëtarë. Kjo varësi ndaj fondeve të donatorëve mund të shkaktojë hendeqe të mëdha në mbulimin dhe cilësinë e shërbimeve.

Duke qenë se Fondi Social është mekanizmi nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për NJQV-të, me qëllim përmirësimin e disponueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, është thelbësore që mekanizma të drejta, të paanshme dhe të qëndrueshme të zhvillohen sa më shpejt dhe të zbatohen njësoj në të gjitha NJQV-të. Kapacitetet e NJQV-ve duhet të forcohen në dizenjimin, kostimin, zbatimin, dhe monitorimin e shërbimeve (të reja) me në qendër fëmijët, duke përfshirë edhe kontraktimin e ofruesve privatë dhe OJF-ve.

Ndër sfida të tjera është zhvillimi i shërbimeve të kujdesit alternativ të bazuar në komunitet për fëmijët, shërbimeve të asistencës në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara, si dhe shërbimeve për familjen dhe prindërimin; transformimi i institucioneve rezidenciale në qendra shume disiplinore dhe shume funksionale; si dhe ofrimi i shërbimeve sociale të integruara nga profesionistë të kujdesit shoqëror. Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Deinstitutionalizimin 2020–2022 dhe ndërmarrja e një sërë veprimesh për parandalimin e vendosjes së fëmijëve të moshës 0-18 vjeç në institucionet rezidenciale

¹³⁵ Progres Raporti, 2019. Puna e cituar.

¹³⁶ Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

¹³⁷ Shifrat nga Raporti 4-Vjeçar i Zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020. Puna e cituar.

¹³⁸ MSHMS, 2020. Raporti i programit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale.

të kujdesit shoqëror, veçanërisht fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke promovuar mbështetjen e tyre në familjet biologjike, janë hapa madhore drejt deinstitutionalizimit dhe transformimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Megjithatë, kjo do të kërkojë mbështetje financiare të mëtejshme dhe shpërndarjen e përshtatshme të burimeve njerëzore nga ana e qeverisë.¹³⁹

Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror parashikon se çdo bashki duhet të ngrëjë njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit, dhe të caktojë një punonjës social për çdo 6,000 –10,000 banorë, duke vënë në dukje qëllimin e legjisllacionit për të ofruar një gamë shërbimesh të kujdesit shoqëror, të mbështetjes familjare dhe të ndihmës ekonomike, përmes punonjësve social të përgatitur profesionalisht. Roli dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave janë të përcaktuara, por burimet e disponueshme janë të papërshtatshme për t'i përmbushur këto përgjegjësi. Përcaktimi i standardeve të ofrimit të shërbimeve synon garantimin e shërbimeve cilësore, pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë, nevojave të veçanta, besimit fetare, identiteti gjinor apo orientimit seksual të individëve në nevojë. MSHMS-ja ka hartuar dhe ka miratuar standarde për katër shërbime të reja: asistencë në shtëpi për të moshuarit, asistencë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara, shërbime të emergjencës për viktimat e dhunës seksuale dhe shërbimi shumëdisiplinor komunitar.

Ligji parashikon certifikimin dhe akreditimin e edukimit të vazhdueshëm për personat e punësuar në institucionet publike dhe jopublike të kujdesit shoqëror, si dhe i detyron këto institucione të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre, cilësia e të cilëve do të garantohet përmes akreditimit. Të gjitha subjektet që synojnë të ofrojnë edukim, trajnim ose kualifikime në fushën e shërbimeve të kujdesit social duhet të akreditohen periodikisht nga ministria përgjegjëse.

Zbatimi i këtyre masave është shumë i ngutshëm, duke përfshirë edhe miratimin e procedurave të regjistrimit për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimit të kujdesit shoqëror, dhe të paketës së detyrueshme të trajnimit.

Krahas këtyre, koordinimi i konsoliduar horizontal dhe vertikal ndërmjet MSHMS-së dhe ministrive të tjera të linjës, dhe institucioneve në nivel vendor është i domosdoshëm për zbatimin e suksesshëm të reformës në shërbimet e kujdesit shoqëror. Shoqëria civile, OJF-të dhe sektori privat duhet të përfshihen si partnerë me të drejta të plota në çdo fazë, nga planifikimi deri te zbatimi dhe monitorimi.

¹³⁹. Progres Raporti, 2019. puna e cituar

3.3 E DREJTA PËR ARSIMIM, ARGËTIM DHE AKTIVITETE KULTURORE



©UNICE Albania 2016 Pirozzi

Konteksti i përgjithshëm¹⁴⁰

Shqipëria ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në arsim, të cilat kanë përmirësuar aksesin në arsim dhe rritjen e rezultateve të të nxënësve, duke përfshirë decentralizimin e qeverisjes së shkollës dhe prezantimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Këto kanë kontribuar në përmirësimin e treguesve kyç të arsimit. Është shtuar aksesin në arsimin e detyruar, dhe është përmirësuar performanca e nxënësve në anketimet ndërkombëtare, megjithatë nivelet vijojnë të jenë ndër më të ulëtat në Evropë. Një numër i madh i nxënësve shqiptarë përfundojnë shkollën pa përvetësuar kompetencat bazë.¹⁴¹

Kjo gjë i kufizon mundësitë e shumë individëve për punësim dhe jetesë, si dhe mund të pengojë zhvillimin e vendit. Kapërcimi i hendeqeve të përvetëmit të aftësive përmes fuqizimit të sistemit arsimor konsiderohet veçanërisht e rëndësishme për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, teksa Shqipëria synon aderimin në BE.¹⁴²

Barazia vijon të përbëjë shqetësim, pasi ende ekzistojnë pabarazi në mundësitë dhe rezultatet arsimore për sa i përket gjinisë, etnisë dhe vendndodhjes gjeografike. Ndërsa niveli i regjistrimit të djemve dhe vajzave është thuhet i njëjtë me 28 vendet e BE-së, hendeuku gjinor në Shqipëri favorizon djemtë në arsimin e ulët, por kjo ndryshon në arsimin e lartë, ku numri i vajzave të diplomuara është më i lartë se i djemve të diplomuar. **Akresi në arsim dhe në rezultatet arsimore kanë tendencë të jenë më të ulëta te pakicat etnike krahasuar me shumicën e popullsisë shqiptare.**¹⁴³ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020¹⁴⁴ dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025¹⁴⁵ synojnë të heqin barrierat në arsimin e përgjithshëm dhe të promovojnë integrimin e grupeve të marginalizuara në shoqërinë e gjerë shqiptare.

Ndryshimet demografike dhe migracioni janë faktorë që nxisin shpërndarjen gjeografike të nxënësve në vend dhe përbëjnë një dilemë në lidhje me planifikimin e arsimit, veçanërisht për shpërndarjen

¹⁴⁰ Për një vlerësim më të plotë të arsimit në Shqipëri, shihni Maghnouj S. Fordham E. et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania* [Analiza për Vlerësimin në Arsim: Shqipëri] Paris, i disponueshëm në <https://doi.org/10.1787/d267dc93-en>

¹⁴¹ OECD, 2019. *PISA 2018 Results (Volume I): What Students Know and Can Do. [Rezultatet PISA 2018 (Vëllimi I): Çfarë dinë dhe arrijnë të bëjnë nxënësit?]* Paris, i disponueshëm në <https://doi.org/10.1787/5f07c754-en>

¹⁴² Banka Botërore, 2019. *Europe and Central Asia Macro Poverty Outlook: Country-by-country Analysis and Projections for the Developing World. [Banka Botërore, Pikëpamje makro mbi varfërinë në Evropë dhe Azinë Qendrore: Analizë nga vendi në vend dhe plane për botën në zhvillim]* Uashington, <http://pubdocs.worldbank.org/en/107191492012467509/mpo-eca.pdf>

¹⁴³ Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania* [Analiza për Vlerësimin në Arsim: Shqipëri] OECD, puna e cituar

¹⁴⁴ Qeveria e Shqipërisë, 2015. *National Action Plan for Integration of Roma and Egyptians in the Republic of Albania* [Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë] 2015–2020. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2016) Tiranë, e disponueshme në https://www.rcc.int/romaintegration2020/download/docs/2015%20Action_Plan_Albania%202015%20

¹⁴⁵ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/12/276/0426afc6-f905-4823-b2dd-1947a8f-ab811>

e burimeve, pasi në disa bashki, disa shkolla mbeten pa nxënës, ndërsa disa të tjera tejmbushen. Infrastruktura e dobët e rrugëve dhe transportit sjellin kufizime të mëtejshme në aksesin e nxënësve në shkollë, duke reduktuar kapacitetin e NJQV-ve për të konsoliduar shkollat në zona të thella.¹⁴⁶ Synimi për arsimin cilësor përbën një faktor kyç që nxit emigrimin e shqiptarëve.¹⁴⁷

Korniza kombëtare e arsimit¹⁴⁸

Në Shqipëri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) është përgjegjëse për arsimin në tërësi, ndërsa Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE) është e ngarkuar me arsimin profesional. Vizioni kombëtar për arsimin do të parashtrohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026.¹⁴⁹ Synimi i përgjithshëm i qeverisë vijon të jetë sigurimi i arsimit për të gjithë, duke përfshirë drejtësinë, barazinë dhe aksesin mosdiskriminues për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që u përkasin pakicave kombëtare.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (pranë MASR) e sapokrijuar dhe struktura përkatëse në varësi, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, mbikëqyrin punën e katër drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), ndërsa 61 zyrtat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) kanë për detyrë menaxhimin e ofrimit të edukimit përmes shkollave. Qeveria ua ka caktuar përgjegjësinë NJQV-ve lidhur me infrastrukturën shkollore (ndërtimi, infrastruktura, mirëmbajtja dhe shërbimet).

Sistemi arsimor parauniversitar në Shqipëri përfshin arsimin parashkollor, **arsimin bazë** (fillor dhe i mesëm i ulët) dhe **arsimin e mesëm të lartë** (të cilit shpesh i referohemi si arsim i mesëm). Arsimi bazë përfshin nëntë vite shkollim të detyruar pa pagesë. Koha minimale e mësimdhënies në arsimin e detyruar në Shqipëri (6,025 orë) është më e shkurtër se në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, por më e gjatë se në Kroaci, Mal të Zi dhe Serbi.¹⁵⁰

Korniza aktuale kurrikulare e Shqipërisë parashikon një qasje bashkërenduese ndaj mësimdhënies dhe të nxënësve në qendër nxënësive. Ajo thekson kompetencat kyçe për të nxënësve gjatë gjithë jetës, që të gjithë nxënësit priten të përvetësojnë deri në fund të arsimit të mesëm të lartë, sikundër parashikohet edhe në Rekomandimin e BE-së në vitin 2006 për Kompetencat Kyçe për të Nxënësit Gjatë Gjithë Jetës. Krahasuar me shkollat në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, shkollat në Shqipëri gëzojnë më shumë fleksibilitet me përzgjedhjen e teksteve mësimore. Me miratim nga institucionet arsimore vendore, shkollat mund të përzgjedhin një sërë tekstesh mësimore të disponueshme, për sa kohë që zgjedhja përputhet me standardet e miratuara nga MASR. Sipas të dhënave nga Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) 2015 i OECD-së, **rreth 79 për qind e përgjegjësisë për zbatimin e kurrikulës i përket shkollës, një për qindje e ngjashme me mesataren e OECD-së (73%) dhe shumë më e lartë se sa ajo e Malit të Zi (34%), Maqedonisë së Veriut (41%), ose Kroacisë (44%).**¹⁵¹

Korniza rregullatore e vlerësimit në Shqipëri parashikon politikat dhe praktikën, si: vlerësimi i portofolit, vlerësimi formues dhe vlerësimi i vazhdueshëm, **ndonëse ndonjëherë ato nuk janë të qarta apo konkrete.** Korniza gjithashtu përshkruan rolin e mësuesve, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e palëve të tjera të interesit, si: administratori i shkollës. Megjithatë, shumë procese dhe aktivitete të përvijuara në kornizë duhen zbatuar nga shkollat, drejtoritë rajonale dhe zyrtat vendore të arsimit parauniversitar, pa përfituar mbështetje ose udhëzime të mëtejshme nga niveli kombëtar.

¹⁴⁶ CIA, *Libër me fakte botërore: Shqipëria* [The World Factbook: Albania (2019)], i disponueshëm në <https://www.cia.gov/library/publications/the-worldfactbook/geos/al.html>

¹⁴⁷ Barjaba K., Barjaba J. 2015. *Embracing Emigration: The Migration-Development Nexus in Albania* [Pranimi i Emigracionit: Lidhja midis Migracionit dhe Zhvillimit në Shqipëri], Instituti i Politikave të Migracionit. E disponueshëm në <https://www.migrationpolicy.org/article/embracing-emigration-migration-development-nexus-albania>

¹⁴⁸ Ky seksion mbështetet ndjeshëm në Wort S., et al., 2019. *Appraisal of the current Strategy of Pre-University Education 2014–2020* [Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020]. UNICEF Tiranë.

¹⁴⁹ Që prej muajit korrik 2021, dokumenti është hartuar dhe është i disponueshëm online për konsultim publik.

¹⁵⁰ Komisioni Evropian, EACEA, Eurydice, 2019. *Recommended Annual Instruction Time in Full-time Education* [Koha e rekomanduar vjetore e mësimdhënies në arsimin me kohë të plotë] Bashkimi Evropian. Luksemburg, i disponueshëm në <http://dx.doi.org/10.2797/714725>.

¹⁵¹ OECD, 2016. *PISA 2015 Results (Volume II): Policies and Practices for Successful Schools* [Rezultatet PISA 2015 (Vëllimi II): Politikat dhe Praktikën për Shkollat e Suksesshme] Paris, e disponueshëm në <https://dx.doi.org/10.1787/9789264267510-en>.

Ndonëse është rritur autonomia e shkollës, planifikimi aftamesëm dhe vlerësimi i mbrendshëm i shkollës mbeten në nivele të ulëta.

Në Shqipëri, qeverisja në nivel shkolle realizohet nga drejtori, zëvendësdrejtori dhe bordi i shkollës. Sipas legjislacionit shqiptar, çdo shkollë duhet të ketë këshillat e mësuesve, prindërve dhe nxënësve, që ndihmojnë në formësimin e politikave në nivel shkolle. Këshillat e shkollës tashme luajnë një rol të rëndësishëm në punësimin dhe largimin nga puna të mësuesve, si dhe në përzgjedhjen e librave shkollore. Megjithatë, ministria, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar vazhdojnë të marrin vendime në lidhje me burimet financiare, por shkollat nuk përfitojnë ende fonde për shpenzimin e të cilave të vendosin vet, gjë që e zvogëlon autonominë e tyre. Pavarësisht kufizimit buxhetor, kapaciteti i shkollave për të reflektuar mbi politikat dhe praktikat e tyre është kyç për t'i përdorur me efektshmëri burimet shkollore, megjithatë, kapaciteti i planifikimit dhe vetëvlerësimit mbetet i pakët.¹⁵²



@UNICE Albania 2016 Pirozzi

Shpenzimet kombëtare për arsimin në vitin 2019 përbëjnë vetëm 3,3 për qind të PBB-së në Shqipëri¹⁵³, më pak se në vendet fqinje¹⁵⁴ dhe me pak se sa mesatarja e BE-së (4.6%) për vitin 2018.¹⁵⁵

Shpenzimet në arsimin fillor ranë me gjashtë pikë përqindjeje gjatë periudhës 2015 - 2019, ndërsa shpenzimet në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë u rritën paksa¹⁵⁶, por shpenzimet e përgjithshme në arsimin parauniversitar ranë si në shifra absolute, po ashtu dhe relative.

Kuadri i buxhetimit afatmesëm për periudhën 2021–2023 nuk parashikon rritje të ndjeshme të buxhetit për arsimin parauniversitar, me përjashtim të arsimit të lartë, për të cilin është parashikuar një rritje prej 21,9 për qind krahasuar me vitin 2020. **Vlerat e arsimit bazë në promovimin e barazisë, prosperitetit, mirëqenies dhe zhvillimit social duhet të njihen konkretisht, duke rritur ndjeshëm përqindjen e buxhetit kombëtar që shkon për arsimin, për ta çuar atë të paktën në nivelin mesatar të BE-së.** Nevojitet një shqyrtim i pavarur i pabarazive në shërbimet në arsim ndërmjet bashkive, që mund të orientojë rishikimin e formulave ekzistuese dhe proceseve për dhënie të granteve, për të garantuar një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për çdo fëmijë, nëpërmjet shpërndarjes optimale të burimeve. **Do të jetë e vështirë për Shqipërinë që të arrijë rezultate të konsiderueshme të të nxënësve pa rritur investimet në arsim.**

Financimi për shkollat përcaktohet në nivelin qendror dhe menaxhohet në nivelin rajonal dhe vendor. Fondet vijnë nga buxheti qendror pranë DRAP-eve, dhe ZVAP-ve, por fondet e tjera qendrore administrohen nga NJQV-të. Buxhetet e DRAP-eve dhe ZVAP-ve mbulojnë kostot e shumicës së shërbimeve në arsim (p.sh., pagat e mësuesve) dhe janë përgjegjëse për ndërtimin, infrastrukturën, mirëmbajtjen dhe shërbimet. **Sfidat në lidhje me përcaktimin dhe dhënie të fondeve në nivel rajonal dhe vendor përfshijnë paqartësinë e roleve, përgjegjësi, autoriteteve dhe kompetencave të**

¹⁵² Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri]* OECD, puna e cituar

¹⁵³ INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016–2019*. puna e cituar

¹⁵⁴ UNESCO, *Welcome to UIS [Mirë se vini në UIS]. statistika*, <http://data.uis.unesco.org/>, aksesuar për herë të fundit më 29 korrik 2020.

¹⁵⁵ Eurostat. *Total general government expenditure on education, 2018, % of GDP* [Shpenzimet totale të qeverisë për arsimin në vitin 2018, % e PBB-së]. E disponueshme në https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=File:Total_general_government_expenditure_on_education_2018_%25_of_GDP.png

¹⁵⁶ MFE, Buxheti Vjetor 2015-2019.

nivelit të qeverisë qendrore dhe vendore; fondet e pamjaftueshme për t'iu mundësuar organeve vendore përmbushjen e funksioneve të tyre; si dhe mungesën e kapaciteteve të shëndosha të menaxhimit financiar dhe numrin e ulët të stafit për të menaxhuar fondet dhe për të ofruar shërbime cilësore.¹⁵⁷

Në disa vende, zbatohen formula që mundësojnë fonde diferenciale bazuar te nevojat, dhe ndihmojnë për trajtimin e pabarazive në arsim¹⁵⁸, por në Shqipëri nuk ekziston ende një formulë për përcaktimin e këtyre fondeve pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar. Aktualisht këto struktura duhet të zgjedhin si t'i shpërndajë (alokojnë) fondet te shkollat që menaxhojnë, pa pasur udhëzime ose orientime të qarta.¹⁵⁹ Nuk ekziston një proces i qartë për përcaktimet (shpërndarjen) e fondeve mbështetur në pabarazinë ndërmjet shkollave ose nxënësve, dhe shkollat nuk e kanë autonominë e duhur që iu nevojitet për të shpenzuar fondet e tyre sipas nevojave që kanë. Një pjesë e fondeve qendrore, që njihen si transferta të pakushtëzuara, përlllogariten bazuar në formulën 'për nxënës' të krijuar në vitin 2002, por këto nuk ofrojnë fonde diferenciale bazuar në nevojat e nxënësve. Në fakt, iu përgjigjen nevojave të popullsisë, bazuar në të dhëna, si numri i nxënësve ose të ardhurat mesatare të NJQV-ve. **Krahas kësaj, nevojiten edhe investime kapitale të mëtejshme për t'u siguruar se mjediset dhe infrastruktura e shkollës plotësojnë standardet bashkëkohore¹⁶⁰.** Shumë shkolla, veçanërisht ato në zona rurale, hasin vështirësi për plotësimin e nevojave bazë infrastrukturore dhe operacionale, si për shembull, ngrohja.¹⁶¹ Disa prej tyre janë të mbipopulluara dhe kanë mungesë të pajisjeve laboratorike, mobilie dhe mjediseve, duke përfshirë infrastrukturën e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), për mbështetjen e të nxënësve me cilësi të lartë.¹⁶² Vetëm 47 për qind e kompjuterave në shkollat rurale lidhen me internetin, krahasuar me 70 për qind në Maqedoninë e Veriut dhe 94 për qind në vendet e OECD-së.¹⁶³

Përqindja e nxënësve në shkolla private është rritur nga katër për qind në periudhën 2006-2007 në shtatë për qind në periudhën 2016-2017, dhe rreth nëntë për qind e shkollave të arsimit bazë në Shqipëri janë private. Regjistrimi në shkollat private në arsimin e mesëm të lartë është rritur, kurse regjistrimi në shkollat publike në po të njëjtin nivel ka pësuar rënie.¹⁶⁴ Legjislacioni shqiptar mundëson mbështetje financiare për institucionet arsimore parauniversitare, private, jofitimprurëse, që kanë qenë aktive për të paktën pesë vjet. Megjithatë, kjo mbështetje nuk është ofruar ende për shkak të kufizimeve në buxhet. Sidoqoftë, **shpenzimet private për arsimim nga individët dhe familjet u rritën nga 0,8 për qind e PBB-së në vitin 2009 në 0,9 për qind e PBB-së në vitin 2017.**¹⁶⁵ Një fushë që vlen për t'u përmendur për sa u përket shpenzimeve private është tarifa shkollore, që mund të variojë ndërmjet 50-300 euro në muaj,¹⁶⁶ pa përfshirë materialet mësimore dhe librat shkollorë. Kodi i Etikës për Mësuesit Shqiptarë ndalon praktikën e mësuesve për tu dhënë mësim private nxënësve të tyre, duke e konsideruar ligjërisht praktikë të gabuar. Ndërkohë, pak vëmendje u kushtohet efekteve që shkakton mësimi privat te barazia arsimore.

¹⁵⁷ Shihni Haxhimali A., 2019. *Local Government in Albania: Status Report* [Qeverisja Vendore në Shqipëri: Raport Statusi], Shoqata e Bashkive të Shqipërisë. Tiranë, e disponueshme në <https://www.alda-europe.eu/public/doc/LocalGovernmentinAlbania.pdf>

¹⁵⁸ Shihni OECD, 2017. *The Funding of School Education: Connecting Resources and Learning, OECD Reviews of School Resources* [Lidhja e Burimeve dhe të Nxënësve, Rishikimet e OECD-së mbi Burimet Shkollore]. Paris, i disponueshëm në <https://doi.org/10.1787/5f07c754-en>

¹⁵⁹ Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania* [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri] OECD, puna e cituar.

¹⁶⁰ Psacharopoulos, G. 2017. *Albania The Cost of Underinvestment in Education: And Ways to Reduce It* [Shqipëri Kostoja e Investimeve të Ulëta në Arsim dhe Mënyrat për ta Reduktuar] UNICEF. Tiranë, e disponueshme në <https://www.unicef.org/albania/reports/cost-under-investment-education-and-ways-reduce-it>

¹⁶¹ Gjokutaj M., 2013. *Albania: the situation of pre-university education* [Shqipëria: Situata e Arsimit Parauniversitar], Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri (2013), cituar në Maghnouj S., Fordham E., et al, po aty.

¹⁶² Shihni Psacharopoulos, G, (2017, . po aty.

¹⁶³ OECD, 2016. *PISA 2015 Results (Volume II): Policies and Practices for Successful Schools* [Rezultatet PISA 2015 (Vëllimi II): Politikat dhe Praktikët për Shkollat e Suksesshme] puna e cituar.

¹⁶⁴ MASR, OECD, 2018. *Review of Evaluation and Assessment: Country Background Report for Albania* [Analize e Vlerësimit dhe Vlerësimit*: Raporti për Shqipërinë]. Tiranë, cituar në Maghnouj S., Fordham E., et al. puna e cituar.

¹⁶⁵ Po aty

¹⁶⁶ Bazuar në kursin e këmbimit të muajit qershor 2021, vlera varion nga 6,140 lekë në 36,840 lekë.

Zhvillimi, kujdesi dhe arsimimi në fëmijërinë e hershme

Të gjithë fëmijët në moshë të vogël, veçanërisht ata më të cenueshëm, që nga ngjizja deri në moshën shkollore, duhet të arrijnë potencialin e tyre zhvillimor dhe të kenë akses të barabartë në të gjitha shërbimet e nevojshme. Në Shqipëri ekzistojnë një sërë ligjesh të ndryshme që kanë të bëjnë me shëndetin, arsimin, ushqyerjen dhe mbrojtjen sociale të fëmijëve, **por mungon një politikë gjithëpërfshirëse kombëtare që adreson zhvillimin, kujdesin dhe arsimin në fëmijërinë e hershme**.¹⁶⁷ Ekzistojnë mekanizma të kufizuara për bashkërendimin dhe zbatimin e politikëbërjes ndërsektoriale për promovimin e zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve më të vegjël se gjashtë vjeç. Shumica e masave sipas AKDF-së, që synojnë fëmijët nën moshën tre vjeç, kanë mbetur të pazbatuara.¹⁶⁸ Programet që synojnë angazhimin e prindërve dhe kujdestarëve janë sporadike dhe kryesisht zhvillohen nga OJF-të.

Arsimi në fëmijërinë e hershme (arsimi parashkollor) në Shqipëri është me zgjedhje dhe ofrohet nga kopshti dhe klasat përgatitore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Kopshtet ndiqen nga grupmoshat 3-4 vjeç, 4-5 vjeç, dhe 5-6 vjeç, ndërsa klasat përgatitore zhvillohen në shkollat filllore dhe synojnë fëmijët pesëvjeçarë, që mund ose mund të mos e kenë ndjekur arsimin parashkollor. Universalizimi i klasave parashkollore është diskutuar për një kohë të gjatë, por ende nuk është institucionalizuar.

Shumica e fëmijëve shqiptarë e ndjekin arsimin parashkollor (përqindja neto e regjistrimit arriti 75,9 për qind në vitin 2019),¹⁶⁹ ndërsa përqindja e regjistrimit për fëmijët romë në Shqipëri raportohet të jetë 33 për qind.¹⁷⁰ Këto shifra janë shumë më të ulëta se sa niveli mesatar prej 95 për qind i fëmijëve nga mosha katërvjeçare deri në moshën e ndjekjes së arsimit fillor të detyruar që marrin pjesë në arsimin në fëmijërinë e hershme në 28 vendet e BE-së.¹⁷¹

Mosha është një nga faktorët: SDSH në Shqipëri 2018¹⁷² konstatoi se 65 për qind e fëmijëve trevjeçarë ndiqnin programet e arsimimit në fëmijërinë e hershme, krahasuar me 80 për qind të fëmijëve të moshës katërvjeçare. Shumica e fëmijëve (73%) nga familje me kryefamiljarë burra ndiqnin arsimin në fëmijërinë e hershme, krahasuar me 66 për qind të fëmijëve nga familje me kryefamiljare gra, gjë që tregon rëndësinë e mirëqenies ekonomike të familjeve për sa u përket mundësive për kujdes të hershëm për fëmijët. SDSH në Shqipëri 2018 konstatoi edhe se fëmijët në zona urbane kishin më shumë gjasë të ishin ekspozuar ndaj aktiviteteve stimuluese në tri ditët përpara studimit, 96 për qind e tyre me nënat, 62 për qind me baballarët, dhe 61 për qind me një person tjetër, krahasuar me 87 për qind, 52 për qind dhe 52 për qind përkatësisht në zonat rurale. Gjithashtu, fëmijët në kuintilin më të lartë të statusit ekonomik kanë më shumë gjasë të ekspozohen ndaj aktiviteteve stimuluese, 96 për qind me nënat dhe 74 për qind me baballarët e tyre, krahasuar me 85 për qind dhe 45 për qind, përkatësisht, në kuintilin më të ulët të statusit ekonomik.

Në vitin 2016, MASR-ja miratoi një Kornizë të re Kurrikulare për Parashkollorin bazuar në kompetenca, në përputhje me teoritë dhe praktikat bashkëkohore të zhvillimit të fëmijës¹⁷³, si dhe kreu në vitin 2018 ndryshimet ligjore që parashikuan standardet e reja minimale dhe procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve të parashkollorit.¹⁷⁴ Megjithatë, cilësia e stafit të mësimdhënies dhe kushtet fizike të parashkollorit mbeten sfida kyç.¹⁷⁵ Përgjegjësia për rekrutimin e punonjësve në arsimin parashkollor u

¹⁶⁷ Komisioni Evropian, 2019 *Staff Working Document: Economic Reform Programme of Albania 2019–2021* [Dokument Pune i Stafit të Komisionit: Programi i Reformës Ekonomike 2019-2021]. Raport SWD; 166; 2019. Bruksel.

¹⁶⁸ MSHMS, 2021. *Four-Year Implementation Report on the National Agenda for Children's Rights 2017–2020*. [Raport Zbatimi Katërvjeçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020] puna e cituar

¹⁶⁹ INSTAT, 2021. Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016–2019, puna e cituar.

¹⁷⁰ UNDP-Banka Botërore-KE (2017) *Regional Roma Survey - Albania* [Anketim Rajonal për Romët - Shqipëri]

¹⁷¹ Eurostat, 2020. *Eurostat regional yearbook 2020 edition* [Vjetari rajonal i Eurostat-it, botimi i vitit 2020] Belgjikë, i disponueshëm në [f1ac43ea-cb38-3ffb-ce1f-f0255876b670 \(europa.eu\)](https://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&code=sdg_4_3_01_01)

¹⁷² ADHS, 2018, puna e cituar

¹⁷³ ASCAP, 2016. *Pre-school Curriculum Framework* [Korniza Kurrikulare Parashkollore] Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Tiranë, e disponueshme në <https://ascap.edu.al/wpcontent/uploads/2018/03/Korniza-Kurrikulare-e-arsimit-parashkollorit-I-ZHA-Dh-jetor-2016.pdf>

¹⁷⁴ MASR, 2018. Për Disa Shtesa dhe Ndryshme në Ligjin Nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Tiranë, cituar në Maghnouj S. , Fordham E. et al, puna e cituar.

¹⁷⁵ Psacharopoulos G, 2017, puna e cituar

përket NJQV-ve, por shumë prej tyre nuk kanë fonde të mjaftueshme dhe emigracioni e vështirëson gjetjen e mësuesve të kualifikuar për parashkollor.

Duke qenë se zhvillimi i aftësive në fëmijërinë e hershme përftohen përmes ndërveprimit me mjedisin që i rrethon, prindërit dhe kujdestarët kanë rol kryesor pasi janë ata që ndërtojnë këtë mjedis. Për këtë arsye, **programet që synojnë zhvillimin, kujdesin dhe arsimimin e fëmijëve nën moshën gjashtë vjeç duhet të trajtojnë si përfitues të drejtpërdrejtë fëmijët bashkërisht me prindërit dhe kujdestarët. Ata duhet të përfitojnë nga ndërhyrje të mirëkoordinuara shumësektoriale që përfshijnë elementet thelbësore të stimulimit, arsimimit, shëndetit, ushqyerjes dhe mbrojtjes. Para së gjithash, këto ndërhyrje duhet të përmbushin nevojat e të gjithë fëmijëve, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që u përkasin pakicave kombëtare.**

Arsimi bazë

Përqindja neto e regjistrimeve në arsimin bazë në Shqipëri në vitin 2018-2019 ishte rreth 96 për qind¹⁷⁶ dhe të dhënat nga SSHFMSH 2018 tregojnë se më shumë se gjysma e të intervistuarve (53%) në arsimin bazë e pëlqenin shkollën, ku vajzat kishin përqindje më të lartë se sa djemtë (57% dhe 49% përkatësisht). Megjithatë, ekzistonte një dallim i madh që lidhet me moshën, pasi nxënësit më të mëdhenj në moshë ndanin pikëpamje më negative sesa nxënësit më të rinj.

Për shkak të problemeve me funksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit të informacionit në arsim, përqindjet e braktisjes së shkollës nuk maten dhe as raportohen rregullisht. Përqindja kumulative e braktisjes së shkollës në arsimin fillor në Shqipëri ishte 6,8 për qind në vitin 2016 (viti më i fundit për të cilin ekzistojnë të dhëna ndërkombëtare)¹⁷⁷, më shumë se dyfishi i përqindjes në BE (2,5%).¹⁷⁸

Një raport i vitit 2017¹⁷⁹ theksoi disa arsye për braktisjen e shkollës në Shqipëri ku përfshihej distanca ndërmjet shkollës dhe shtëpisë, trysnia për të kontribuar në të ardhurat e familjes, detyrimet familjare (kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit), trysnia shoqërore nga nxënësit e tjerë që e kanë lënë shkollën, si dhe faktorë rreziku, si aftësia e kufizuar, etnia, migracioni dhe varfëria në Shqipëri. Shqipëria ka zbatuar një sërë nismash për t'u siguruar nxënësve mundësi shtesë për të përfunduar shkollën. Vendi ka ofruar tekste mësimore pa pagesë dhe mundësi arsimimi në shtëpi, ka krijuar një njësi psiko-sociale për të ndjekur nxënësit që kanë braktisur sistemin, ka miratuar kritere për mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara,¹⁸⁰ dhe ka pilotuar një sistem paralajmërimi të hershëm në 20 shkolla dhe katër bashki. Ky sistem duhet të fuqizohet dhe të zgjerohet, si dhe **mund të ofrohen stimuj buxhetorë ndaj shkollave në mënyrë që të rriten normat e përfundimit të shkollës për fëmijët nga komunitetet e marginalizuara. Përfaqësuesit e fëmijëve dhe stafi mësimor duhet të trajnohen dhe të mbështeten për të zhvilluar mekanizma për mundësimin e pjesëmarrjes dhe dialogut me fëmijët.**

Megjithatë, cilësia dhe aksesit mbeten problematike dhe, ndonëse vitet e fundit rezultatet e të nxënësve janë përmirësuar, numri i nxënësve që përvetësojnë kompetencat bazë mbetet i ulët, dhe pak nxënës i zhvillojnë aftësitë e nivelit të lartë deri në moshën 15-vjeçare. Barazia e aksesit dhe rezultatet vijojnë të jenë të vështira, veçanërisht për sa i përket gjinisë, etnisë dhe shpërndarjes gjeografike.

Ka probleme të rëndësishme në lidhje me efikasitetin e sistemit, duke marrë parasysh faktin se më shumë se 50 për qind e shkollave funksionojnë me më pak se 50 nxënës¹⁸¹. Mosshpërndarja e burimeve me kosto efektive ndikon negativisht cilësinë e mësimdhënies përgjatë ndarjes rurale-urbane. Numri i mësuesve nuk ka ndryshuar që prej vitit 2013, prandaj, raporti nxënës: mësues po zvogëlohet,

¹⁷⁶. INSTAT, 2019. Shqipëria në shifra 2019. I disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/media/7176/albania-in-figures.pdf>

¹⁷⁷. Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri]* OECD, puna e cituar

¹⁷⁸. Po aty

¹⁷⁹. MASR, 2017. *Educational Policies for Dropout Reduction. [Politikat arsimore për reduktimin e braktisjes së shkollës]* Tiranë, cituar në Maghnouj S., Fordham E., et al. puna e cituar.

¹⁸⁰. UNESCO, 2017, puna e cituar.

¹⁸¹. Wort M., Pupovci D., Ikononi, E. 2019. *The Mid-term Appraisal of the Pre-University Education Strategy 2014–2020* [Vlerësimi Afatmesëm i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020]. Tiranë.

veçanërisht në zonat rurale.¹⁸² Ndërkohë që raporti mesatar në arsimin parauniversitar në vendet e OECD-së ishte 15, për vitin akademik 2018–2019 ky raport ishte 13,3 në Shqipëri.

Përpjekjet e vendit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies përfshijnë rritjen e kritereve për punësim dhe standardizimin e përmbajtjes së kurrikulës së programeve të trajnimit të mësuesve, përditësimin e standardeve të mësimdhënies, kryerjen e një provimi shtetëror për mësuesit e rinj, si dhe fuqizimin e mëtejshëm të rrjeteve profesionale të të nxënësve. Përqindja e mësuesve me nivel arsimi të lartë është rritur, nga dy të tretat në vitet 2006–2007 në 91 për qind në vitet 2016–2017,¹⁸³ megjithëse niveli vijon të jetë nën nivelin mesatar të vendeve të OECD-së (98%) dhe BE-së (98%).¹⁸⁴ Drejtorët e përfshirë në anketimin PISA 2015 raportuan se hendeuku ndërmjet shkollave rurale dhe urbane lidhur me cilësinë dhe sasinë e stafit mësimdhënës në Shqipëri është veçanërisht i madh.

Një tjetër veçori e sistemit arsimor bazë në Shqipëri është numri relativisht i madh i nxënësve të regjistruar në klasa kolektive (9,1%), gjë që çon në arritjen e niveleve më të ulëta të aftësive në shkrim dhe lexim.¹⁸⁵

Covid-19 ka sjellë nevojën për të zhvilluar më tej mënyrën e të nxënësve të përzier të mësimdhënies dhe të nxënësve. Kjo kërkon burime shtesë në infrastrukturë, kurrikula të përmirësuara dhe edukim të vazhdueshëm profesional të mësuesve në TIK.

Arsimi i mesëm i lartë

Regjistrimi në arsimin e mesëm të lartë thuhet se nuk ka ndryshuar gjatë katër viteve të fundit, por niveli neto i regjistrimeve në Shqipëri prej 76,2 për qind¹⁸⁶ vijon të mbetet ndjeshëm nën mesataren e vendeve të OECD-së (84%).¹⁸⁷ Në vitin 2017, përqindja e kalimit të provimeve përfundimtare për të përfunduar arsimin bazë ishte 99,2 për qind, shifër që tregon se Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë përbëjnë një pengesë të papërfillshme për të kaluar në arsimin e mesëm të lartë.¹⁸⁸

Pavarësisht përmirësimit të përgjithshëm gjatë viteve, sipas rezultateve të PISA 2018, një përqindje e lartë fëmijësh që hyjnë në arsimin e mesëm të lartë kanë mungesa në kompetencat bazë. Thuhet se gjysma (52,2%) e 15-vjeçarëve në Shqipëri nuk kanë aftësitë bazë në lexim, krahasuar me mesataren e OECD-së (22,6%). Në matematikë, 42,4 për qind prej tyre iu mungojnë aftësitë bazë, krahasuar me 24 për qind në vendet e OECD-së. Gjithashtu, Shqipëria ka një përqindje të lartë (29,7%) të nxënësve që nuk kanë përvetësuar në nivel bazë të tri fushat themelore të PISA-s: lexim, matematikë dhe shkencë. Nga ana tjetër, hendeuku i arritjeve ndërmjet nxënësve me rezultate më të larta dhe atyre me rezultate më të ulëta po ngushtohet në çdo lëndë.¹⁸⁹ Gjithashtu, përqindja e diplomimit është përmirësuar disi gjatë viteve të fundit,¹⁹⁰ nga 80,1 për qind në vitin 2016 në 84,6 për qind në vitin 2018. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit mund të zgjedhin të hyjnë në programet e përgjithshme, me orientim, ose të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Vendet në programet e orientuara janë të kufizuara dhe pranimi bazohet mbi meritë, dhe vetëm tre për qind e nxënësve u regjistruan në një program të orientuar në vitin 2019.¹⁹¹ Përqindja e të regjistruarve në programet e AFP-së është e ulët,

¹⁸² OECD, 2020. *Education at a glance*, [Vështrim mbi arsimin] f. 159, i disponueshëm në https://www.oecd-ilibrary.org/education/education-at-a-glance_19991487

¹⁸³ MASR (2018), puna e cituar.

¹⁸⁴ Shihni OECD, 2019. *TALIS 2018 Results (Volume I): Teachers and School Leaders as Lifelong Learners [Rezultatet e TALIS 2018 (Vëllimi I): Mësuesit dhe Drejtuesit e Shkollave si Nxënës Gjatë Gjithë Jetës]*. Paris, i disponueshëm në <https://dx.doi.org/10.1787/1d0bc92a-en>

¹⁸⁵ UNESCO, 2017, puna e cituar.

¹⁸⁶ INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016–2019*. puna e cituar

¹⁸⁷ OECD, 2020. *Education in a glance*, [Vështrim mbi arsimin] f. 159

¹⁸⁸ MASR, 2017. *National basic education exams public report about student achievements*. [Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë - Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve] puna e cituar.

¹⁸⁹ OECD, 2019. *PISA 2018 Results (Volume I): What Students Know and Can Do [Rezultatet PISA 2018 (Vëllimi I): Çfarë dinë dhe arrijnë të bëjnë nxënësit?]* Paris, i disponueshëm në <https://doi.org/10.1787/5f07c754-en>

¹⁹⁰ INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016–2019*. puna e cituar

¹⁹¹ Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analizë e Vlerësimit dhe Vlerësimit* në Arsim: Shqipëri]* OECD, puna e cituar.

pasi vetëm 17 për qind u regjistruan në studime profesionale në vitin 2017¹⁹² krahasuar me 37 për qind në vendet e OECD-së¹⁹³ dhe 48 për qind në 28 vendet e BE-së.¹⁹⁴ Nxënësit e programeve profesionale arrijnë të hyjnë në arsimin e lartë pasi të kenë përfunduar katër vjet (ose tri nivele) të arsimit profesional. Megjithatë, nxënësit në programe të përgjithshme mund të hyjnë në universitet vetëm pas tre vjetësh, gjë që shkurajon regjistrimin në arsimin profesional për nxënësit që janë të interesuar në këto programe, por që janë gjithashtu të interesuar të ndjekin një universitet.

Në arsimin e mesëm të lartë, rreth 23 për qind e shkollave janë private dhe përqindja e regjistrimit në këtë sektor është rritur nga rreth tetë për qind gjatë periudhës 2006-2007 në njëmbëdhjetë për qind gjatë periudhës 2016-2017.¹⁹⁵ Kjo rritje e regjistrimeve në shkollat private lidhet me faktorë, si: klasat me më pak nxënës, infrastruktura më e mirë, kurrikula në gjuhë të huaj, dhe njohja e studimeve në shkollat shqiptare private nga disa vende të BE-së. Rezultatet e Provimeve të Maturës Shtetërore tregojnë arritje më të larta të nxënësve në shkolla private se ata në shkolla publike,¹⁹⁶ por statistikat nuk marrin parasysh karakteristika të nxënësve, si disavantazhi socio-ekonomik apo vetëpërzgjedhja pozitive në shkollat private. Të dhënat e PISA 2018 tregojnë se, mesatarisht, shkollat private kanë rezultate më të larta në aftësinë e leximit se shkollat publike, edhe pasi merret parasysh indeksi i PISA-s për statusin ekonomik, social dhe kulturor.

Shqipëria renditet e para ndër vendet e PISA-s për sa i përket përqindjes së nxënësve që raportojnë se mësuesit e tyre i mbështesin. **Bazuar te raportet e nxënësve, Shqipëria ka një ndër klimat disiplinore më pozitive ndër vendet që morën pjesë në PISA 2018.** Krahas kësaj, UNESCO-ja konstatoi se nxënësit kanë kulturën e mbështetjes së ndërsjellë, mësuesit tregojnë frymë bashkëpunimi dhe se nxënësit ndihen të kënaqur me ndërveprimin me mësuesit e tyre, ndonëse mësuesit hasin vështirësi me diferencimin e mësimdhënies sipas nivelit të aftësisë së nxënësve të ndryshëm¹⁹⁷.

Fëmijët në Shqipëri pritet që deri në moshën 18-vjeçare, të kenë përfunduar 13 vjet të arsimit parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Megjithatë, kur vitet e shkollimit rishikohen përkundrejt nivelit të cilësisë së të nxënësve, kjo është e barasvlershme me 8,9 vjet, gjë që nënkupton se 4,1 vite shkollimi nuk rezultojnë në të nxënësve.¹⁹⁸ Koha e mësimdhënies në Shqipëri është e kufizuar dhe e përcaktuar sipas udhëzimeve, por shkollat gëzojnë fleksibilitet në mënyrën e organizimit të ditës shkollore. Një reformë e vitit 2018, me titull "*Tri lëndë në gjashtë orë*", iu dha shkollave më shumë fleksibilitet në mënyrën se si zgjedhin të organizojnë ditën mësimore. **Raportohet se mësuesit e konsiderojnë kurrikulën e re të vështirë për t'u zbatuar në orë mësimore 45-minutëshe, pjesërisht për shkak të kohës më të gjatë që nevojitet për të zhvilluar mësimin duke i përfshirë nxënësit në aktivitete.**¹⁹⁹ **Me reformën e re, mësuesit i shohin nxënësit e tyre më pak ditë në javë, gjë që ndikon në aftësinë për të kryer një vlerësim të përshtatshëm të tyre.**

Arsimi i lartë

Kalimi nga arsimi i mesëm në atë të lartë karakterizohet nga një rënie në përqindjen e regjistrimit. Përqindja e nxënësve që u diplomuan në arsimin e lartë në vitin 2019 ishte 1,6 për qind më e lartë se në vitin 2018. Ndër të diplomuarit nga të gjitha programet e atij viti, vajzat ose gratë përbënin 66,4 për qind, ku të diplomuarit në programet "Bachelor" përbënin 53,6 për qind të totalit.²⁰⁰ Pjesëmarrja në shkollë (nga arsimi fillor deri në arsimin e lartë) është rritur nga **10,6 vjet në vitin 2000 në 14,8 vjet në**

¹⁹² MASR, 2017 *Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë - Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve*. Tiranë, i disponueshëm në http://qsha.gov.al/infos/publikime_raporte/raporti_pkab_2017.pdf

¹⁹³ OECD, 2020. *Education in a glance [Vështrim mbi arsimin]* f. 160, puna e cituar

¹⁹⁴ DEPP, 2020. *Education in Europe: key figures [Arsimi në Evropë: Shifrat kyçe]*. Paris.

¹⁹⁵ Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri]* OECD, puna e cituar

¹⁹⁶ MASR. *Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë - Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve 2017*, puna e cituar.

¹⁹⁷ UNESCO, 2017, puna e cituar.

¹⁹⁸ Banka Botërore, 2018. *Indeksi i Kapitalit Njerëzor*.

¹⁹⁹ Gonzalez T., 2018. *Report on the Implementation of the New Competency Based Curriculum: Building on Strengths [Raport për Zbatimin e Kurrikulës së Re Bazuar në Kompetenca: Mbështetja në Pikat e Forta]* UNICEF. Tiranë.

²⁰⁰ INSTAT, *Shqipëria në Shifra 2019*, puna e cituar.

vitin 2017, e ngjashme me atë të vendeve fqinje, ndonëse më e ulët se mesatarja në BE (17,1 vjet). Përqindja e regjistrimit bruto në arsimin e lartë ra nga 66 për qind në vitin 2014 në 55 për qind në vitin 2018,²⁰¹ pjesërisht për shkak të mbylljes së universiteteve private që jepnin diploma të cilësisë së ulët, dhe pjesërisht për shkak të emigrimit në kërkim të mundësive për arsimim dhe karrierë jashtë vendit. Cilësia e universiteteve shqiptare, pjesërisht për shkak të zgjerimit të tyre të shpejtë, është relativisht e ulët²⁰² dhe, sipas Renditjes Botërore të Universiteteve Webometrics,²⁰³ ato renditen ndër më të dobëtat në rajon.²⁰⁴ Caktimi i pakët i buxhetit për arsimin është një ndër faktorët që ndikojnë cilësinë e arsimit universitar, por edhe emigrimi ndikon: rreth 40 për qind e stafit akademik të universiteteve, kryesisht ata që janë specializuar jashtë vendit, emigruan gjatë viteve 1990 dhe 2008.²⁰⁵

Papunësia e të rinjve në Shqipëri është e lartë (27,2%) dhe përqindja e të rinjve që nuk janë në marrëdhënie pune, duke u arsimuar apo në trajnime arriti në 25,5 për qind në vitin 2019.²⁰⁶

Ndonëse konkurrueshmëria e Shqipërisë në nivelin botëror është pak më e lartë se ajo e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, shumë të rinj shqiptarë janë të punësuar në pozicione që nuk kërkojnë shumë aftësi, dhe paguajnë pak, veçanërisht në sektorin e bujqësisë. Për t'u siguruar se shqiptarët i kanë aftësitë e nevojshme për t'u punësuar, Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për Punësimin dhe Aftësitë bën thirrje për investime në AFP dhe zhvillimin e gjerë të kapitalit njerëzor.²⁰⁷ Draft Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 parashikon përmirësimin e cilësisë së arsimit universitar nëpërmjet riorganizimit dhe zgjerimit të programeve të studimit duke i përshtatur ato me kërkesat e tregut, modernizimin e infrastrukturës, prezantimin e skemave financiare për promovimin e regjistrimit në arsim dhe fuqizimin e qeverisjes së institucioneve arsimore.

Barazia

Kushtet socio-ekonomike kanë një ndikim të madh mbi aksesin në arsim dhe rezultatet e të nxënësve, dhe nxënësit që vijnë nga grupe të pafavorizuara kanë performancë më të ulët se nxënësit nga grupe të favorizuara.²⁰⁸ Sipas të dhënave nga PISA 2018, nxënësit nga 25 përqindëshi i fundit i renditjes në statusin ekonomik, social dhe kulturor në Shqipëri morën 61 pikë më pak në lexim krahasuar me nxënësit nga 25 përqindëshi i sipërm, të barasvlershme me dy vite shkollimi. **Kjo gjetje tregon mungesë mundësisht në familjet me më pak të ardhura, dhe në komunitetet më pak të zhvilluara ose të thella, ku aksesin në arsim është shumë më i ulët si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Pavarësisht këtij hendeku, në Shqipëri, nxënësit më të pafavorizuar kanë aftësi ripërtëritëse akademike dhe arrijnë nivele mesatarisht më të larta performance (12,3%), krahasuar me vendet e OECD-së (11,3%).**

Krahas kësaj, femrat në Shqipëri kanë më shumë gjasa të diplomohen në nivele të ndryshme arsimore dhe të përfundojnë arsimin, krahasuar me meshkujt, dhe kanë rezultate më të larta se ta në nivel vendi për sa u përket një sërë matësve të rezultateve: p.sh., të dhënat nga PISA 2018 tregojnë për performancë më të lartë të vajzave se djemve në fushat e leximit dhe shkencës. Ndryshimi ndërmjet vajzave dhe djemve në matematikë nuk është i konsiderueshëm. Krahasuar me meshkujt, më pak femrave iu mungojnë aftësitë bazë në shkencë dhe lexim, dhe hendeku me pikë përqindjeje në favor të femrave në Shqipëri (10,7 në shkencë/ 20,1 në lexim) është më i lartë se në vendet e OECD-së (përkatesisht 2,4 dhe 10,2).

²⁰¹ Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri]* OECD, puna e cituar

²⁰² QS World University Ranking [Renditja Botërore e Universiteteve QS], i disponueshëm në <https://www.topuniversities.com/qs-world-university-rankings>

²⁰³ Webometrics Ranking of World Universities [Renditja Botërore e Universiteteve Webometrics], i disponueshëm në <http://www.webometrics.info/en>

²⁰⁴ <http://www.webometrics.info/en/Europe/Albania>

²⁰⁵ Gëdeshi I., King R., 2018. *Research Study on Brain Gain: Reversing Brain Drain with Albanian Scientific Diaspora* [Studim Kërkimor në Fitimin e Trurit: Kthimi i Largimit të Trurit me Diasporën Shkencore Shqiptare]. UNDP.Tiranë; Banka Botërore, 2010. *Albania, the New Growth Agenda: A Country Economic Memorandum* [Shqipëria: Agjenda e re e rritjes: Memorandumi Ekonomik i një Vendi]. Uashington DC: Raport i Bankës Botërore Nr. 53599-AL.

²⁰⁶ INSTAT, 2021. *Children, Adolescents and Youth-Focused Well-being Indicators [Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adolehentëve dhe të Rinjve në Shqipëri] 2016–2019*. puna e cituar

²⁰⁷ Shihni Maghnouj S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri]* OECD. Paris, i disponueshëm në <https://doi.org/10.1787/d267dc93-en>

²⁰⁸ Po aty

Mesatarisht, **fëmijët në zonat urbane të Shqipërisë kanë arritur dy vjet më shumë shkollim se në zonat rurale (10,5 kundrejt 8,6)**²⁰⁹. **Të dhënat nga PISA 2018 tregojnë se, në të tri fushat, nxënësit e shkollave në zonat rurale të Shqipërisë arrijnë rezultate mesatare më të ulëta sesa nxënësit e shkollave në zonat urbane.** Zonat e largëta rurale nuk mund të ofrojnë të njëjtën gamë mundësish të të nxënësve sikurse zonat urbane. Krahas kësaj, migracioni i brendshëm ka kontribuar në mbipopullimin e klasave në disa zona urbane dhe në vështirësitë e rekrutimit të mësuesve cilësorë në zonat rurale. Përpjekjet për të ofruar mundësi më të mira të të nxënësve nëpërmjet racionalizimit të shkollave, kufizohen nga infrastruktura e dobët e transportit.

Ndonëse aksesimi i romëve në arsim u rrit nga 44 për qind në vitin 2011 në 66 për qind në vitin 2017²¹⁰, **rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve të Ballkanit mbeten ndër më të ulëtat në Shqipëri. Vetëm një për qind e romëve dhe pesë për qind e egjiptianëve të Ballkanit të moshës 7-20 vjeç kanë përfunduar arsimin e mesëm.**²¹¹ **Konkretisht, ndër fëmijët romë, përqindja e braktisjes së shkollës është rreth 50 për qind**²¹² **dhe, sipas disa përlogaritjeve,**²¹³ **më shumë se sa gjysma e fëmijëve romë të moshës 6-16 vjeç nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë.** Përgjigjet e politikave të ndërmarra përfshijnë rimbursimin e kostove të teksteve mësimore dhe përpjekje për të promovuar arsimimin e romëve dhe egjiptianëve. Megjithatë niveli i financimit në këtë sektor është i pamjaftueshëm për të siguruar akses, për të promovuar përfshirjen dhe për të përmirësuar rezultatet për këtë pakicë kombëtare. Gjithashtu, duhet t'i jepet përparësi zbatimit të rekomandimit²¹⁴ të Komisionit të Ministrave të Shteteve Anëtare për përfshirjen e historisë së Romëve dhe popujve Shtegtarë në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore.

Fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht vajzat, përballen me vështirësi në ndjekjen e shkollës. Sipas MASR-së, përqindja e fëmijëve që ndiqnin shkollën u rrit nga 75 për qind në vitin 2014, në 85 për qind në vitin 2018, ndonëse këto shifra u referohen 57,6 për qind të fëmijëve të moshës 6-17 vjeç që marrin pagesë për aftësinë e kufizuar.²¹⁵ **Pavarësisht shifrave të vërteta, fëmijët me aftësi të kufizuara janë dukshëm të nën-përfaqësuar në shkollat e zakonshme, dhe sfida e parë për t'i mbështetur është identifikimi i tyre.** Gonzales²¹⁶ parashtron se prindërit dhe fëmijët mund të mos pranojnë t'i identifikojnë fëmijët me aftësi të kufizuara, sepse i frikësohen stigmatizimit dhe bullizmit, gjë që iu ndalon përfitimin e mbështetjes shtesë. Sipas shifrave të INSTAT-it, gjatë vitit akademik 2018-2019, përqindja e vajzave ndër nxënësit me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë është më e ulët sesa e djemve (33,2% kundrejt 39,2%), ndërsa përqindja në arsimin e lartë arrin 58,4 për qind.²¹⁷

Shkollat kanë përfituar shërbime shtesë për të mbështetur gjithëpërfshirjen dhe po zbatojnë parimet e arsimit gjithëpërfshirës. Raportohet²¹⁸ se mësuesit kanë pikëpamje pozitive për qasjen e arsimit gjithëpërfshirës, por pavarësisht përpjekjeve, Progres Raporti 2019 tregon se cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara ende përbën shqetësim. Ende ekzistojnë vështirësi për organizimin e transportit shkollor për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe **mësuesve ndihmës u nevojitet trajnim i posaçëm i mëtejshëm.**²¹⁹ **Ndërkohë, vlerësimi i aftësive të kufizuara vijon të mbështetet në një model të vjetruar,** dhe monitorimi i zbatimit të masave që lidhen me aftësinë e kufizuar pengohet nga mungesa e të dhënave. Duke marrë në konsideratë angazhimet kombëtare për regjistrimin e të gjithë fëmijëve

²⁰⁹ Psacharopoulos, 2017, puna e cituar

²¹⁰ UNDP-Banka Botërore-KE (2017) *Regional Roma Survey - Albania* [Anketim Rajonal për Romët - Shqipëri]

²¹¹ UNESCO, 2017, puna e cituar.

²¹² Psacharopoulos, 2017, puna e cituar

²¹³ UNESCO, 2017, puna e cituar.

²¹⁴ Shihni *Recommendation CM/Rec(2020)2 of the Committee of Ministers to member States on the inclusion of the history of Roma and/or Travellers in school curricula and teaching materials* [Rekomandimi i KM/Rec (2020)2 të Komisionit të Ministrave për Shtetet Anëtare për përfshirjen e historisë së Romëve dhe/ose Udhëtuesve në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore], miratuar nga Komisioni i Ministrave më 1 korrik 2020, në mbledhjen e 1380-të të Zëdhënësve të Ministrave, i disponueshëm në https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016809ee48c

²¹⁵ Shihni Rogers J., Sammon E., 2018, puna e cituar.

²¹⁶ Gonzalez T., 2018, puna e cituar.

²¹⁷ INSTAT, 2020. INSTAT *Burrat dhe Gratë në Shqipëri*, puna e cituar

²¹⁸ Rogers J., Sammon E., 2018, puna e cituar.

²¹⁹ Progres Raporti, 2019, puna e cituar.

me aftësi të kufizuara në shkolla të zakonshme dhe mundësimin e arsimimit për fëmijët migrantë, trajnimi i mësuesve duhet t'i japë prioritet ndjeshmërisë kulturore dhe mësimdhënies ndërkulturore dhe mënyrave të luftimit të paragjykimin dhe stereotipave në klasë. Trajnimi rreth nevojave të veçanta të fëmijëve duhet të përbëjë një element të detyrueshëm të edukimit universitar për mësuesi, trajnimit në punë dhe sistemeve të mbështetjes profesionale.

E drejta për aktivitete kulturore dhe argëtim

Neni 2.1 i Konventës parashikon se qeveria duhet *“t'i garantojë të drejtat e parashikuara në këtë Konventë çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e saj, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.”* Kjo nënkupton se të drejtat e fëmijës duhet të realizohen në kontekstin e familjes dhe komunitetit të fëmijës, duke përfshirë respektin për gjuhën, kulturën dhe fenë e fëmijës, si dhe njohjen e dallimeve të moshës dhe gjinore. Neni 30 parashikon se *“Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një pakice nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, për të ushtruar dhe për të praktikuar fenë e vet, ose për të përdorur gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.”* Në Shqipëri, sikurse në shumicën e shteteve evropiane, fëmijëve romë vijon t'u mungojë në praktikë zbatimi i të drejtës së njohjes dhe vlerësimit të gjuhës, kulturës dhe traditës së vet, si dhe qetësia, siguria dhe stabiliteti që vjen nga pranimi i gjerë shoqëror. Kjo bëhet më e dukshme në shkollat, ku zakonisht fëmijët romë ndihen të huaj, pasi kultura, gjuha ose traditat e tyre nuk pranohen, vlerësohen apo njihen pozitivisht. Ka pak ose asnjë kurrikul për historinë, kulturën ose komunitetin rom në Evropë dhe **në vende si Shqipëria, legjislacioni i së cilës e lejon mësimdhënien e kulturës dhe gjuhës rome, kjo zgjedhje nuk është e disponueshme në praktikë, pasi mungojnë mësuesit romë të kualifikuar. Megjithatë, ekzistojnë mundësi për ta korrigjuar këtë situatë nëpërmjet masave që po merr Shqipëria për arsimin gjithëpërfshirës, dhe për zbatimin e rekomandimit²²⁰ të Komisionit të Ministrave të Shteteve Anëtare për përfshirjen e historisë së romëve në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore, që është miratuar së fundmi nga Komisioni i Ministrave.**

Në Nenin 31.1 të Konventës parashikohet *“e drejta e fëmijës të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike”*.²²¹ Neni 31.2 ia ngarkon përgjegjësinë shtetit që të *“respektojë dhe nxisë të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.”*²²² Rëndësia e lojës për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës njihet në nivel ndërkombëtar, bashkërisht me nevojën për të mundësuar mjedise të sigurta, të siguruara dhe miqësore për fëmijët. Analiza e të dhënave të mbledhura²²³ në katër qytete shqiptare në vitin 2015 tregon se kërkohet ende punë për të arritur objektivat e nismës së Qyteteve Miqësore me Fëmijët në Shqipëri. Përgjithësisht, më pak se 30 për qind e prindërve dhe fëmijëve mendonin se qyteti ishte i sigurt për fëmijët. **Pyetësi²²⁴ mbi lojërat i cilësoi të katër qytetet nën nivelin e kënaqshëm sipas disa treguesve. Vetëm 20 për qind e pjesëmarrësve në studim mendonin se fëmijët kishin hapësira të mjaftueshme për të luajtur dhe për të kryer veprimtari sportive, ose mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë ose për të ndjekur festivale dhe aktivitete kulturore. Krahas kësaj, rezultatet tregojnë se më pak se 50 për qind e fëmijëve dhe prindërve në katër qytetet kishin dijeni për hapësira ku fëmijët mund të luanin në natyrë.**

²²⁰ Shihni *Recommendation CM/Rec(2020)2 of the Committee of Ministers to member States on the inclusion of the history of Roma and/or Travellers in school curricula and teaching materials* [Rekomandimi i KM/Rec (2020)2 të Komisionit të Ministrave për Shtetet Anëtare për përfshirjen e historisë së Romëve dhe/ose Udhëtuesve në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore], miratuar nga Komisioni i Ministrave më 1 korrik 2020, në mbledhjen e 1380-të të Zëdhënësve të Ministrave, i disponueshëm në https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016809ee48c

²²¹ Shihni Hodgkin R., Newell P., 2002. *Implementation Handbook for the Convention on the Rights of the Child [Manual zbatimi për Konventën për të Drejtat e Fëmijës]* UNICEF. Nju Jork.

²²² Po aty

²²³ UNICEF, 2015. *Albania. Child Friendly Cities [Shqipëri. Qytete miqësore me fëmijët]* Tiranë.

²²⁴ Po aty

3.4 E DREJTA PËR MBROJTJE, MJEDIS FAMILJAR DHE KUJDES ALTERNATIV



@UNICE Albania 2016 Pirozzi

Konteksti i përgjithshëm

Në Shqipëri nuk ka studime të mjaftueshme për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, dhe nevojitet të kryhen studime të veçanta lidhur me dhunën ndaj fëmijëve në shtëpi, në shkollë dhe në institucione të tjera. Nuk ka informacion të mjaftueshëm rreth shkallës ose prevalencës së abuzimit seksual të fëmijëve, punës së fëmijëve dhe shfrytëzimit të tyre. Të dhënat mbi dhunën te grupe të fëmijëve, të konsideruar si më të cenueshëm, janë të pamjaftueshme. Nevojitet një përpjekje shumë më e madhe për të pasur një panoramë të përgjithshme rreth fëmijëve romë, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të dënuar, adoleshentëve nga komuniteti lezbik, gej, biseksual, transgjinnor dhe interseks (LGBTI) dhe fëmijëve në migracion.

Pavarësisht se vendi ka të ardhura mesatare, është e qartë se fëmijët në Shqipëri hasin një sërë rreziqesh që lidhen me varfërinë dhe privimin. Studimi i Mirëqenies së Fëmijëve²²⁵ në vitin 2016 konstatoi se 46,5 për qind e fëmijëve në moshë shkollore kanë status ekonomik të ulët, ku një përqindje e lartë e femrave (48,9%) raportuan status ekonomik më të ulët se meshkujt (44%). Gjithashtu, rolet gjinore vijojnë të stereotipizohen dhe ka një nivel të papranueshëm të lartë tolerance të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, gjë që i vendos ata në rrezik më të lartë. Sipas SSHFMSH 2018,²²⁶ 26 për qind e adoleshentëve të moshës 11, 13 dhe 15-vjeçare raportuan se kishin rënë pre e abuzimit fizik një ose dy herë gjatë jetës së tyre, ndërsa gjashtë për qind e tyre ishin abuzuar fizikisht disa herë. Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (DHNGV) e vitit 2019²²⁷ konstatoi se rreth një e treta (31%) e grave kishin përjetuar dhunë në familje, dhe 23,1 për qind të tyre u ishte dashur të kalonin netë në spital si pasojë e saj. Megjithatë, vetëm 16,9 për qind e grave i kishin treguar dikujt dhe 8,4 për qind kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje, shumica tek familjarët (98,9%) dhe njohjet në komunitet në vend të institucioneve zyrtare, si policia (4,4%), avokatët (3,4%), apo mjekët dhe punonjësit e tjerë shëndetësorë (3,1%). **Shumica e grave të dhunuara në Shqipëri vijon të vuajë në heshtje pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të ndërgjegjësuar publikun rreth dhunës në familje, legjislacionit të ri për dhunën në familje dhe shërbimeve të mbështetjes së viktimave.**²²⁸

Sipas një raporti të vitit 2015,²²⁹ dhuna që përjetojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara raportohet rrallë. Ato përjetojnë lloje të ndryshme dhune që lidhen me stereotipat, traditën, kulturën dhe

²²⁵ Bradshaw J. et al., 2016. *Child Well-Being in Albania [Mirëqenia e Fëmijëve në Shqipëri]* UNICEF Tiranë (CWB 2016), i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org/albania/files/2019-01/Child%20Well-Being%20in%20Albania.pdf>

²²⁶ Health Behaviour in School-age Children of 11, 13 and 15 years: Main findings [Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijëve të Moshës Shkollore 11, 13 dhe 15-vjeçarë: Gjetjet kryesore] 2018 Tiranë.

²²⁷ DHNGV, 2019, puna e cituar.

²²⁸ Po aty

²²⁹ Çani B., et al., 2015. *Invisible Violence—An overview of the on violence against women and girls with disabilities in Albania* [Dhunë e padukshme - Një vështrim mbi fenomenin edhunës ndaj grave e vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri]. I disponueshëm në <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/invisible-violence-an-overview-on-the-phenomenon-of-violence-a/>

gjendjen shëndetësore, sociale ose ekonomike. Ato nuk janë të informuara si duhet rreth mekanizmave të raportimit dhe varen ndjeshëm nga autorët, kanë mungesë të plotë të shërbimeve të mbështetjes dhe nuk kanë besim tek institucionet.

Në vitin 2019, 583 fëmijë qëndronin në institucionet publike dhe jopublike të kujdesit rezidencial.²³⁰ Qeveria ka synim strategjik të riorganizojë sistemin e kujdesit ndaj fëmijëve, duke pranuar se ofrimi i kujdesit institucional rezidencial nuk u siguron fëmijëve mundësitë më të mira për t'u rritur dhe zhvilluar. Ekziston një kuadër i rinovuar politikash, ligjor dhe institucional për shërbimin social dhe sistemin për mbrojtjen e fëmijëve, që synon realizimin gradual dhe të plotë të deinstitutionalizimit të fëmijëve nga të gjitha subjektet e kujdesit rezidencial nëpërmjet zbatimit të mbështetjes në familje dhe mundësive të kujdesit alternativ.

Kuadri për mbrojtjen e fëmijës

MSHMS-ja është organi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. KKDMF-ja vepron si organ këshillues, detyra kryesore e të cilit është të koordinojë politikën qeveritare për të siguruar të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht në drejtësi, shërbim social, arsim, shëndetësi dhe kulturë. **Është thelbësore që të sigurohet ngritja e një komiteti këshillues të përhershëm të posaçëm për mbrojtjen e fëmijës, sikurse parashikohet në kuadrin ligjor.**

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve (ASHMDF) ka përgjegjësinë për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve dhe për zbatimin e politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. Në këtë mënyrë, Agjencia caktohet si organi *de facto* përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri, që i nënshtrohet autoritetit dhe miratimit nga Ministria, **megjithëse nuk ka funksion apo rol administratori për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes në terren. Detyrat e ASHMDF-së lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor përfshijnë kontrollin e cilësisë, mbledhjen e të dhënave, këshillimin teknik, trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve, si dhe mbikëqyrjen dhe mbështetjen e përgjithshme. Për të realizuar me efikasitet këto funksione, kapacitetet dhe burimet e ASHMDF-së duhet të fuqizohen më tej.**

Neni 46 i Ligjit 18/2017 përcakton Bashkitë si përgjegjëse në nivel vendor dhe përcakton përgjegjësinë e tyre themelore në zbatimin e politikave dhe masave kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve, dhe ngritjen e strukturave efikase për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë dhe përcaktimin e fondeve. Burimi i këtyre fondeve nuk përcaktohet qartë, sikurse nuk përcaktohet as ekuilibri ndërmjet përgjegjësisë së qeverisë qendrore dhe bashkisë lidhur me financimin dhe ofrimin e burimeve të mjaftueshme për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve. **Megjithatë, përgjegjësia e parë e posaçme që u është caktuar bashkive sipas Nenit 46 a) është pasqyrimi dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve në planet, programet dhe projektet vendore të zhvillimit në përputhje me politikat kombëtare, duke caktuar detyrimin ligjor për të ndjekur një qasje për planifikimin me në qendër të drejtat e fëmijëve.**

Nenet 46-52 përcaktojnë kuadrin për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe strukturat e personelin e nevojshëm në nivel bashkiak për të mbështetur dhe mbrojtur individët e cenusur, familjet dhe komunitetet e tyre, si dhe për të mbrojtur fëmijët shqiptarë nga abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe dhuna nëpërmjet ofrimit të shërbimeve komunitare cilësore me në qendër fëmijët. Megjithatë, **situata e financimit nuk ka ndryshuar dhe mungesa e burimeve vijon të pengojë zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe cilësor të mbrojtjes së fëmijëve.**

Progres Raporti 2019 përcakton²³¹ se burimet financiare dhe njerëzore që u caktohen institucioneve të mbrojtjes së fëmijëve nuk përkojnë me përgjegjësitë e tyre të shtuara sipas rishikimeve ligjore. Në vitin 2019 ishin gjithsej vetëm 236 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve (52% e numrit të nevojshëm), nga të cilët vetëm 45 (19%) punonin me kohë të plotë në këtë funksion. Ligji i ri parashikon se të gjithë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës duhet të kenë përvojë në punë sociale, por vetëm 78 nga 236 (33%) kanë

²³⁰. INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016–2019*. puna e cituar

²³¹. Shihni Progres Raporti 2019, f. 29, dhe Raportin Shtetëror për KKBDf-në, 2019, pika. 27.

përvojë të tillë.²³² Struktura e mbrojtjes së fëmijës vijon të vuajë nga mungesa e investimit të qëndrueshëm në kapacitete, ku përfshihen edhe sektorët shoqëruues të arsimit dhe shëndetësisë. Parimi i një qasjeje shumë disiplinore është përcaktuar qartë në kuadrin normativ dhe është një parim i njohur gjerësisht për sa i përket rëndësisë së tij, por koordinimi mbetet përsëri një nga ato fusha që nuk funksionon²³³ plotësisht në Shqipëri. Në të shumtën e rasteve koordinimi zhvillohet në formën e shkëmbimit të informacionit, dhe jo në ndarjen e punës dhe vendimmarrje efektive e kolektive. Ndërkohë, menaxhimi i rasteve pengohet nga mungesa e shërbimeve të kujdesit shoqëror në trajtimin e nevojave të fëmijës dhe familjes.²³⁴ **Të gjitha çështjet e mësipërme sfidojnë seriozisht disponueshmërinë, aksesueshmërinë, mbulimin dhe efektivitetin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri .**

Dhuna

SDSH në Shqipëri 2018²³⁵ nxori në pah se 37 për qind e fëmijëve ishin disiplinuar vetëm nëpërmjet mënyrave jo të dhunshme, duke përfshirë heqjen e privilegjeve ose duke i dhënë fëmijës diçka tjetër për të bërë, pa përdorur dhunë verbale ose fizike. Rreth 42 për qind kishin përjetuar agresion psikologjik (p.sh. bërtitje), dhe 32 për qind kishin përjetuar një formë të agresionit fizik. Anketa e DHNGV-së konstatoi se 47,7 për qind e grave, që kishin përjetuar dhunë në familje, kishin fëmijë të moshës 0 -17 vjeç që jetonin në shtëpi bashkë me to dhe **bazuar në kampionin e përfshirë në anketë, u vlerësua se 286,498 fëmijë të kësaj moshe ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë jetës së tyre (të paktën një herë), dhe se 246,707 ishin të ekspozuar aktualisht ndaj dhunës në familje.** Fëmijët e moshës 5 -17 vjeç të ekspozuar ndaj dhunës në familje në dymbëdhjetë muajt e kaluar kishin dy herë më shumë gjasa të kishin makthe të shpeshta (25,3%) sesa fëmijët e tjerë (9,5%), tre herë më shumë gjasa të lagnin shpesh shtratin (20,4%), të ishin të ndrojtur ose të tërhequr (21,5%), dhe të sillleshin në mënyrë agresive me nënën e tyre ose fëmijët e tjerë, ose të dyja së bashku (6,9%).

Të dhënat administrative të policisë të vitit 2017 tregojnë se 61 për qind (70 fëmijë) e të gjitha rasteve të abuzimit seksual në Shqipëri janë kryer ndaj fëmijëve.²³⁶ Dhuna seksuale është një shqetësim i veçantë për vajzat dhe gratë, si dhe fëmijët pa kujdes prindëror, ku 3,1 për qind e grave të moshës 18 - 74 vjeç²³⁷ raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë.²³⁸ Disa raste të fëmijëve të abuzuar seksualisht në mënyrë sistematike në komunitetin e tyre dhe në qendrat rezidenciale të kujdesit u bënë të njohura për publikun në vitin 2020 dhe 2021. Trajtimi i rasteve nxori në pah mungesën e profesionistëve të specializuar dhe shërbimeve të integruara që mund të ishin në shërbim të interesit më të mirë të fëmijëve. Aktualisht, qeveria ka krijuar një grup pune *ad hoc* të nivelit të lartë të drejtuar nga kryeministri për të trajtuar dhe parandaluar dhunën ndaj fëmijëve, me fokus të veçantë në dhunën seksuale.

Shkolla është një element tepër i rëndësishëm i mjedisit mbrojtës për fëmijët dhe në sondazhin e SSHFMSH -së të vitit 2018, rreth 22 për qind e fëmijëve raportuan se kishin përjetuar të paktën një rast bullizimi në shkollë, ku mbizotëronin më shumë djemtë sesa vajzat (përkatësisht 24% dhe 20%). **Këto nuk janë shifra të papërfillshme dhe tregojnë se kërkohet të njihet më mirë fenomeni i dhunës në shkolla. Mbi të gjitha nevojitet një politikë e dedikuar dhe e qartë për të identifikuar dhe trajtuar rastet e dhunës në mjediset shkollore.**

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve duhet të përmirësohet akoma më shumë, të zgjerohet dhe të përshtatet urgjentisht për të siguruar përgjigje të përshtatshme ndaj formave të ndryshme të dhunës kundër fëmijëve shqiptarë. Nevojiten burime të tjera për të fuqizuar më së miri njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, ndërsa llogaridhënia, monitorimi dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë duhet të forcohen. Profesionistët e vijës së parë (përfshirë personelin shëndetësor, policinë, mësuesit dhe punonjësit e tjerë) duhet të

²³² MSHMS, 2020. *Raport Monitorimi katërvjeçar për Planin Kombëtar të Veprimit për Fëmijët 2017-2020*, puna e cituar.

²³³ Progres Raporti, 2019, puna e cituar.

²³⁴ Terre des homes, 2020. *Report on the implementation of the Law no. 18/2017*. [Raport për zbatimin e Ligjit Nr. 18/2017.] BE, ANNTARC.

²³⁵ ADHS, 2018, puna e cituar. f. 137.

²³⁶ INSTAT, 2018. *Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale 2016–2017*. I disponueshëm në: <http://www.instat.gov.al/media/4824/crime-and-criminal-justice-statistics.pdf>

²³⁷ DHNGV, 2019, puna e cituar.

²³⁸ 'ishin prekur seksualisht pa dëshirën e tyre ose ishin detyruar të kryenin një akt seksual pa dëshirën e tyre'.

identifikojnë në mënyrë aktive individët e rrezikuar ndaj dhunës, të referojnë rastet dhe t'i trajtojnë ato kur ndodhin. Disponueshmëria e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe marrja e tyre nga fëmijët duhet të përmirësohet, duke përfshirë shërbimet e specializuara të integruara për fëmijët të mbijetuar nga format e rënda të dhunës dhe abuzimit. Programet e mbështetjes së prindërve për familjet dhe kujdestarët, si dhe mekanizmat e referimit për fëmijët (në shtëpi dhe në mjediset institucionale) duhet të mbështeten, për të transformuar kulturën e tolerancës ndaj dhunës, stigmatizimin e viktimave dhe diskriminimin ndaj të mbijetuarve, si për vajzat ashtu edhe për djemtë në të njëjtën mënyrë.

Puna e detyruar dhe trafikimi i fëmijëve

Në Raportimin Periodik Universal²³⁹ u raportuan raste të fëmijëve që lypnin në rrugët e Tiranës dhe u evidentua se fëmijët përdorshin për të lypur edhe në vendet fqinje²⁴⁰. Shumica e këtyre fëmijëve vinin nga familje të varfra dhe të marginalizuara nga shoqëria, një pjesë e madhe nga komunitetet romë. Raportimi Periodik theksoi se **masat e marra për të ndihmuar dhe për të mbrojtur fëmijët e rrugës në Shqipëri ishin të pamjaftueshme, pavarësisht përpjekjeve për të harmonizuar legjislacionin me traktatet ndërkombëtare, ndërkohë që fëmijët vijnë të jenë viktimat të prostitucionit, pornografisë dhe shfrytëzimit seksual**. Aty konstatohet se prostitucioni me fëmijë, pornografia me fëmijë dhe turizmi seksual me fëmijët nuk janë trajtuar mjaftueshëm në dokumentet e politikave dhe se nuk ekzistojnë shërbime apo institucione të posaçme për akomodimin, kujdesin, mbrojtjen dhe ndihmesën për fëmijët viktimat të prostitucionit, pornografisë ose shfrytëzimit seksual në internet. **Fëmijët e përfshirë në prostitucion nuk përjashtohen nga përgjegjësia penale ndaj, në parim, ata mund të ndiqen penalisht**.

Të dhënat dhe informacioni për prevalencën e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në udhëtime dhe turizëm janë të pakta, pavarësisht rëndësisë së industrisë së turizmit në Shqipëri. Fëmijët nga mbarë vendi kontaktohen dhe rekrutohen online nga rrjetet kriminale dhe më pas dërgohen në qytete turistike, si Vlora, Durrësi dhe Saranda, ose në qytete të tjera të mëdha, si Tirana, Shkodra dhe Elbasani për shfrytëzim seksual në hotele dhe motele. Në këto aktivitete raportohet se janë të përfshira rrjete të organizuara dhe shpesh i joshin fëmijët me imazhe të hoteleve dhe jetës së luksit, si dhe iu premtojnë pasurim të shpejtë. Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në udhëtime dhe turizëm duket se lidhet me modelet e trafikimit të brendshëm të fëmijëve, si një formë e trafikimit të fëmijëve për shfrytëzim seksual.²⁴¹

Në dokumentin e dorëzuar në Raportin Periodik 2019, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës²⁴² ngriti shqetësimin për fenomenin e trafikimit të fëmijëve, ku një numër shpërpjesëtimor i viktimave ishin fëmijë nga komuniteti rom dhe egjiptian. Një shqyrtim i kryer nga OSBE-ja²⁴³ për viktimat e mundshme të trafikimit të fëmijëve në vitin 2020, konstatoi se lokalet e natës përbënin rrezik trafikimi për vajzat, dhe për djemtë lypja e detyruar dhe kryerja e veprave penale. Shumica e rasteve të raportuara nuk kishin aspekt ndërkombëtar, megjithatë, ato tregonin **nevojën që reforma ligjore në Shqipëri të njohë trafikimin si një fenomen kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të ofrojë**

²³⁹. Mbledhur në *Përmbledhjen e përgatitur nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në përputhje me pikën 15 (b) të aneksit të Rezolutës së Këshillit për të Drejtat e Njeriut 5/1 dhe pikën 5 të aneksit të Rezolutës së Këshillit 16/21, Shqipëri E disponueshme në <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx> (RPU 2019)*

²⁴⁰. Shihni Vathi Z., 2014. *Children and Adolescents on the Move Involved in Street Work in Albania and Kosovo: Transnational and Internal Patterns*. [Fëmijët dhe Adolehentët në Lëvizje të Përfshirë në Punën e Rrugës në Shqipëri dhe Kosovë: Modelet transnacionale dhe të brendshme] Projekti Mario. I disponueshëm në http://tdh-europe.org/upload/document/7231/Mario_Albania_Kosovo_Web.pdf.

Healy C., Rogoz M., et al., 2012. *Report for the Study on Typology and Policy Responses to Child Begging in the EU*. [Raport për Studimin mbi Tipologjinë dhe Përgjigjet e Politikave për Lypjen e Fëmijëve në BE]. ICMPD. I disponueshëm në https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/report_for_the_study_on_typology_and_policy_responses_to_child

Save the Children, 2012. *Regional Report on Child Begging: Prevalence, Prevention and Suppression of Child Begging* [Raport Rajonal për Lypjen nga Fëmijët: Prevalenca, Parandalimi dhe Reduktimi i Lypjes nga Fëmijët]. (2012) Sarajevë, i disponueshëm në <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/regional-report-child-begging> Ky raport përfshinte Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Qipron, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Rumaninë, Slloveninë dhe Serbinë.

²⁴¹. Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore i Nismës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Maj 2021). *Exploited in plain sight - An assessment of commercial sexual exploitation of children and child protection responses in the Western Balkans* [Shfrytëzimi i dukshëm - Vlerësim i shfrytëzimit seksual ekonomik të fëmijëve dhe reagimet për mbrojtjen e fëmijëve në Ballkanin Perëndimor].

²⁴². RPU 2019, vepra e cituar.

²⁴³. McQuade A., Rexha J., Trimi A., 2020. *A typology of child trafficking in Albania* [Tipologji e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri] OSBE

mbështetje të plotë për viktimat. Shqyrtimi vlerësoi koordinimin e Shteteve anëtare në përgjigjen fillestare ndaj rasteve të identifikuar, por evidentoi probleme madhore në lidhje me menaxhimin e rastit, ku përfshihej mungesa e vendimmarrjes së posaçme lidhur me identifikimin e trafikimit, mungesa e ndjekjes së hetimeve penale, si dhe mangësia shqetësuese në sigurimin e masave të mjaftueshme të mbrojtjes së fëmijëve. Në të u evidentua dhe se **ekziston një nevojë e konsiderueshme për të fuqizuar sistemet për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri për sa i përket trafikimit të fëmijëve, nëpërmjet rritjes së trajnimit të palëve kryesore të interesit, duke përfshirë oficerët e policisë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe profesionistët në shkolla. Gjithashtu, ekziston nevoja për përmirësim të mbledhjes së të dhënave dhe bashkërendimit më efikas të aktorëve të mbrojtjes së fëmijës, si dhe për përmirësim të ofrimit të kujdesit të specializuar për fëmijët që janë traumatizuar si pasojë e trafikimit, duke përfshirë dhe shërbimet e specializuara për varësinë nga droga të fëmijët. Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), në dokumentin e dorëzuar në Raportin Periodik vuri në dukje se një prej sfidave kryesore për parandalimin e trafikimit të fëmijëve ishte shkalla e lartë e braktisjes së shkollës, veçanërisht nga fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane.**

Raporti i Trafikimit në Persona i vitit 2021 për Shqipërinë i dha prioritet sundimit të ligjit si rekomandim parësor: *“hetimi, ndjekja dhe dënimi i rreptë i trafikantëve, duke përfshirë zyrtarët bashkëfajtorë.”* GRETA dhe vëzhguesit raportuan se autoritetet ngatërronin elementet e mbivendosur të shfrytëzimit për prostitucion dhe trafikimit dhe se, në disa raste, zbatonin një ndëshkim më të ulët, pasi kërkonte më pak specializim dhe kohë, ose kishin besimin e rremë se krimet e trafikimit kërkonin një element ndërkombëtar për t’u quajtur të tillë.²⁴⁴ E njëjta pritshmëri raportohet dhe nga të rinjtë shqiptarë të pyetur si pjesë e një studimi të drejtuar nga UNICEF-i, të cilët binin dakord se masat ligjzbatuese janë mënyra më efikase për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.²⁴⁵ Megjithatë, po këta të rinj, raportuan se varfëria është faktori kryesor që çon drejt trafikimit në njerëz.

Aksesi në drejtësi

Edhe pse Shqipëria miratoi Kodin e Drejtësisë Penale për Fëmijët në vitin 2017, duke integruar të gjitha parimet dhe standardet ndërkombëtare për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve në legjislacionin kombëtar, si dhe Strategjinë Kombëtare të Drejtësisë për Fëmijët (2018–2021), zbatimi i plotë i tyre është i vonuar. Ligjet, politikat dhe praktikat akoma nuk janë harmonizuar dhe përshtatur me përvojat e fëmijëve dhe mund të çojnë në rezultate të padrejta, të pabarabarta dhe të papërshtatshme. **Sistemi i drejtësisë nuk është ende miqësor dhe i arritshëm nga të gjithë fëmijët.**

Progresi Raporti 2019 vëren se ka ende mangësi strukturore në drejtësinë për të miturit në Shqipëri dhe përmbyshja e kuadrit rregullator do të kërkonte një ndryshim në kulturën administrative, ngritjen e konsiderueshme të kapaciteteve, infrastrukturë specifike të përshtatur, krijimin e shërbimeve komunitare dhe koordinim ndër-disiplinor dhe ndër-institucional në nivel qendror dhe lokal.

Normat shoqërore duhet të jenë të favorshme që fëmijët të kenë akses të barabartë në drejtësi, por mungesa e përgjithshme e besimit ndaj institucioneve dhe besimet shoqërore të rrënjësura thellë, që e bëjnë të papranueshme që fëmijët t’i besojnë një të rrituri jashtë shtëpisë për problemet që ndodhin brenda shtëpisë, i pengojnë fëmijët të kenë akses në sistemin e drejtësisë. Fëmijët e varfër kanë më pak gjasa t’i drejtohen sistemit të drejtësisë për të kërkuar të drejtat e tyre dhe kjo shpesh mbivendoset me faktorë të tjerë, të tillë si: aftësia e kufizuar, gjinia dhe origjina etnike. Tarifat gjyqësore, kostot e përfaqësimit ligjor, distanca me institucionet e drejtësisë, njohuritë e kufizuara për të drejtat e fëmijëve dhe kërkimin e dëmshpërblimit, si dhe mungesa e procedurave me në qendër fëmijët i pengojnë akoma më shumë ata dhe familjet të kenë akses në zgjidhjet juridike.²⁴⁶

²⁴⁴. Departamenti i Shtetit i SHBA-së, 2021. *Trafficking in Persons Report: Albania* [Trafikimit në Persona: Shqipëri]. I disponueshëm në <https://www.state.gov/reports/2021-trafficking-in-persons-report/albania/>

²⁴⁵. Davy, D., dhe Metanji, B. (2020) *First Wave Survey Study on Youth Knowledge, Attitudes and Practices with Regard to Human Trafficking, in Four Regions in Albania* [Anketë e valës së parë - Njohuritë, Qëndrimet dhe Praktikrat e të Rinjve lidhur me Trafikimin e Qenieve Njerëzore, në Katër Rajone në Shqipëri] Raport mbi gjetjet. Qeveria e MB-së / IDRA / UNICEF Shqipëri e disponueshme në <https://www.unicef.org/albania/documents/first-wave-survey-study-youth-knowledge-attitudes-and-practices-regard-human-trafficking>

²⁴⁶. UNICEF, Zyra Rajonale për CEE/CIS, 2015. *Children's Equitable Access to Justice, Central and Eastern Europe and Central Asia* [Aksesi i barabartë i fëmijëve në drejtësi, Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Azia Qendrore] Gjenevë.

Një raport²⁴⁷ i vitit 2016 konfirmon se ndërmjet ligjit dhe praktikës vijon të ekzistojë një hendek i konsiderueshëm. Në të theksohet se shoqërimi nga policia, arrestimi dhe paraburgimi, në shumë raste përbëjnë një formë burgosjeje, duke mos marrë parasysh kontekstin, moshën apo interesat më të larta të fëmijës, dhe kryhen në mungesë të vlerësimit profesional të gjendjes psikologjike dhe zhvillimore të fëmijës. Në Raportin e vitit 2019,²⁴⁸ Ministria e Drejtësisë pranoi se nuk kishte arritur të realizonte sigurimin e ndihmës ligjore pa pagesë ndaj fëmijëve.

Seksionet e të miturve duhet të krijohen në të gjitha gjykatat dhe ka mospërputhje të konsiderueshme të të kuptuarit të drejtësisë për fëmijët nga të gjithë profesionistët ligjorë. Të dhënat evidentojnë²⁴⁹ një numër të lartë të të miturve djem të ndaluar, shoqëruar apo arrestuar. Palët e interesit duhet të zhvillojnë një kuadër të fortë e të pavarur monitorimi për fëmijët në paraburgim, në institucione, në qendrat e pritjes dhe në ambientet e tjera ku mbahen, dhe të këmbëngulin që çdo ambient ku fëmijët mbahen nën kujdesin shtetëror të ketë një mekanizëm të pavarur ankesash që të mund të përdoret lirisht nga fëmijët.

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur vepron në kontekstin e pabarazisë sociale dhe mungesës së vlerësimit të faktorëve dhe rrethanave sociale. Shërbimi i Provës nuk duhet ta kufizojë rolin e tij vetëm në fazën e ekzekutimit të dënimit, por duhet të përfshihet nga gjyqësori dhe prokuroria në fazat e hershme të procesit të drejtësisë penale për të mitur. **Autoritetet publike duhet t'i shohin në mënyrë kritike të gjitha shërbimet për fëmijët të lidhura në një mënyrë ose një tjetër me sistemin e drejtësisë dhe, jo vetëm policinë apo gjykatën, por edhe mësuesit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës, punonjësit socialë, psikologët dhe palët e tjera të interesit në komunitet që ndërveprojnë me fëmijët në përballjen e tyre me drejtësinë.** Përfshirja e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe garantimi i efektshëm i këtyre shërbimeve për fëmijët, sidomos për fëmijët në konflikt me ligjin në prag lirim apo riintegrimi, është vendimtare për parandalimin e diskriminimit dhe trajtimit të diferencuar.

Institucionet e pavarura kombëtare të të drejtave të njeriut kanë rol të rëndësishëm monitorues për zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare për drejtësinë për fëmijë. Këto organe mund të ofrojnë masa të drejtpërdrejta kundër shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, dhe mund të advokojnë dhe këshillojnë Kuvendin dhe Qeverinë për ato pjesë të legjislacionit përkatës që ndikojnë në përdorimin e barabartë të sistemit të drejtësisë nga fëmijët.

Martesa e hershme

Ndonëse moshë minimale e martesës sipas Kodit të Familjes (2003) është 18 vjeç, njëmbëdhjetë për qind e grave të grupmoshës 20-49 vjeç dhe dy për qind e burrave ishin martuar para moshës 18-vjeçare²⁵⁰, ndërsa për qindja e grave të grupmoshës 15-19 vjeç me fëmijë, u rrit në 3,5 për qind midis periudhës 2017-2018, nga 2,8 për qind gjatë viteve 2008-2009.²⁵¹ Të dhënat nga INSTAT-i dhe SDSH-ja në Shqipëri 2018, si dhe nga një numër i kufizuar studimesh cilësore rreth tematikës, kanë treguar se martesa e hershme, ndonëse nuk është raportuar në nivelin e duhur, vazhdon të jetë ende një çështje me rëndësi madhore, kryesisht për shkak të pabarazisë gjinore, varfërisë dhe përjashtimit social. Ligjet për mbrojtjen e adoleshentëve nga martesa e hershme nuk zbatohen me efikasitet apo në mënyrë të qëndrueshme dhe, deri më sot, nuk ka asnjë dokument shtetëror politikash që trajton këtë fenomen.

Martesat përpara arritjes së moshës ligjore minimale mund të lejohen nga gjykatat sipas rasteve. Sipas studimeve²⁵² të fundit, gjykatat kanë lejuar martesën për vajzat nën 18 vjeç për shkak të shtatzënisë,

²⁴⁷ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi / Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës, 2016. *Children, access to justice and discrimination An overview of judicial decisions in relation to children from the point of view of discrimination and equality*. Tiranë, e disponueshme në https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org/albania/files/2018-12/2016-Access_to_Justice.pdf

²⁴⁸ Ministria e Drejtësisë, 2019. Raport Monitorimi për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për Fëmijë.

²⁴⁹ INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoloshentëve dhe të Rinjve*, puna e cituar

²⁵⁰ SDSH në Shqipëri, 2018, puna e cituar

²⁵¹ Po aty

²⁵² Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, 2018a. *Marriage in court? Children's rights, underage marriage and the role of the court* [Martesa në gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesa në moshë të vogël dhe roli gjykatës], i disponueshëm në: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/07/Report2-Legal-social-analyze-underage-marriage_June2018.pdf

lindjes së fëmijës dhe bashkëjetesës, por shpeshherë këto vendime nuk merren në interesin më të mirë të fëmijëve në fjalë. Studimi i vitit 2018²⁵³ tregoi se pavarësisht nivelit të lartë të njohurisë mbi legjislacionin e martesave të hershme dhe pasojave negative të praktikës, martesat e hershme ishin të pranishme në të gjitha grupet e popullsisë. Ekziston një perceptim i përgjithshëm se martesat e hershme është më e përhapur në komunitetet romë, por nuk ka ende të dhëna përfundimtare për këtë fenomen nga SDSH në Shqipëri 2018 ose INSTAT-i. Anëtarët e komunitetit rom të anketuar në studim duket se ishin të vetëdijshëm për pritshmëritë shoqërore që nxisin vajzat e reja drejt martesës së hershme, por ishin po aq përkrahës të argumenteve kundër këtij fenomeni. Megjithatë, vajzat e komunitetit rom dhe egjiptian priren të jenë më të cenueshme ndaj trysnive së varfërisë, arsimit jocalësor dhe kushteve të jetesës në hapësira të mbipopulluara, të cilat i shtojnë drejt martesës së hershme.

Kjo shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijëve mund të trajtohet vetëm nëpërmjet masave të fuqishme dhe të posaçme ligjore dhe politike, që sigurojnë respektimin e plotë dhe zbatimin e legjislacionit ekzistues, si dhe sensibilizimin dhe edukimin e zyrtarëve të policisë dhe gjyqësorit për të treguar kujdesin e duhur dhe zbatuar parimin e interesit më të lartë të fëmijëve. Ekziston gjithashtu nevoja për të krijuar alternativa për fëmijët (veçanërisht vajzat) veç martesës, dhe edukimin e publikut për të adresuar normat shoqërore që favorizojnë dhe bëjnë të mundur martesën e fëmijëve.

Siguria e fëmijëve në internet

TIK-u është një instrument i rëndësishëm në jetën e fëmijëve, në mënyrë që të mësojnë, të socializohen, të shprehin dhe të ushtrojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore. Interneti ofron mundësi për rritjen, zhvillimin dhe arsimimin e fëmijëve, por në të njëjtën kohë përmban edhe rreziqe. Një shembull është lehtësira që krijon ndaj abuzimit dhe shfrytëzimi seksual të fëmijëve në internet, duke u dhënë abuzuesve akses te një numër të madh fëmijësh. Sipas një anketimi të viteve të fundit²⁵⁴, thuhet se tetë në dhjetë fëmijë kanë akses në internet kur dëshirojnë ose kanë nevojë. Fëmijët fillojnë ta përdorin internetin mesatarisht rreth moshës 9,3 vjeç. Rreth 95 për qind e fëmijëve e përdorin internetin në shtëpi të paktën njëherë në javë. Asyeja kryesore e mospërdorimit është për shkak të kufizimit prindëror. Ndërkaq, 30 për qind e prindërve të pyetur nuk e përdorin internetin, gjë që shpjegon se si një qëndrim kufizues kushtëzon më tej mbikëqyrjen pozitive prindërore.

Fëmijët më të vegjël në moshë ndihen më pak të sigurt se ata më të mëdhenj për sa u përket sjelljeve sociale në internet, por gjatë rritjes, ata përfshihen në një gamë më të gjerë aktiviteteve dhe fitojnë vetëbesim. Rreth 14 për qind e fëmijëve të intervistuar kishin kaluar përvoja të pakëndshme në internet.

Rreziku më i zakonshëm është ekspozimi ndaj dhunës në internet, që prek më shumë se tre në dhjetë fëmijë shqiptarë. Një në katër fëmijë raportoi se ka pasur të paktën një herë kontakt online me dikë që nuk e ka takuar kurrë ballë për ballë dhe thuhet se 20 për qind e fëmijëve raportuan se kanë takuar personalisht dikë me të cilin kanë pasur kontakt vetëm në internet.

Një në dhjetë fëmijë raportoi se ka pasur të paktën një përvojë seksuale të padëshiruar nëpërmjet internetit, të cilat shpesh nxiteshin nga persona që tashmë njiheshin nga fëmijët. Ekspozimi ndaj të gjitha formave të rreziqeve online rritet me moshën, dhe djemtë kanë më shumë gjasa të ekspozohen ndaj këtyre rreziqeve, ndonëse vajzat janë ato që shqetësohen më shumë nga këto përvoja. **Prindërit e raportojnë ekspozimin e fëmijëve të tyre ndaj rreziqeve online shumë më pak sesa vetë fëmijët, gjë që tregon një mungesë të mundshme komunikimi midis tyre.** Fëmijët e anketuar raportojnë se shumica e prindërve nuk përdorin një qasje aktive ndaj përdorimit të internetit. **Programet edukuese për fëmijët, familjet dhe komunitetet rreth rreziqeve dhe strategjive për të qenë të sigurt në internet duhet të përmirësohen duke përdorur qasje inovatore dhe efektive.**

²⁵³ Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, 2018b. *Child Marriage Knowledge, Attitudes and Perception among Affected Communities*. [Njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet për martesat e fëmijëve në komunitetet e prekura] Tiranë, e disponueshme në <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Child-marriage-Report-Final-vesion.pdf>

²⁵⁴ Dunja A., Gjergji O., Gvineria D., Hallkaj E., dhe Verzivollli I., 2019. *One Click Away: Children's Experience of Internet Use in Albania [Një klikim larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri.]* UNICEF në Shqipëri; IPSOS Strategic Marketing. Tiranë, e disponueshme në https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2020-01/report_oneclickaway.pdf

Një studim tjetër²⁵⁵ konstatoi se, megjithëse rreth 5,000 deri në 15,000 raste të mundshme të imazheve të papërshtatshme të fëmijëve (pornografike) referoheshin çdo vit nga organet ligjzbatuese ndërkombëtare, Policia e Shtetit shqiptar arriti të niste hetimet vetëm për tre ose katër raste në vit dhe arriti të zbulonte vetëm një. Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar referoi 6,300 raste të imazheve të papërshtatshme të fëmijëve gjatë periudhës janar-tetor 2019, ku mesatarisht 200 përdorues në Shqipëri kishin akses dhe ndanin materialin abuziv. **Duhet të forcohen urgjentisht kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet.**²⁵⁶

Strategjia e miratuar Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planin e Veprimit në Shqipëri 2020-2025 përfshin një kapitull të posaçëm për mbrojtjen e fëmijëve në internet, duke e ngritur problematikën në nivel më të lartë prioriteti për vendin. Pesë shtyllat kryesore të kapitullit me në qendër fëmijët trajtojnë fusha specifike të mbrojtjes së tyre në internet, ku përfshihen kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen e krimeve ndaj fëmijëve të kryera përmes internetit, që vijojnë të jenë një problematikë madhore. Buxhetimi dhe zbatimi i këtij kapitulli duhet të monitorohen me kujdes.

Realiteti aktual i fenomenit të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve bën thirrje që sistemi i mbrojtjes së fëmijëve të jetë i përgatitur mjaftueshëm për trajtimin e të gjitha formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve në vend, përfshirë atë përmes internetit, duke bërë të mundur vijimësinë e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, nga identifikimi i hershëm deri në rehabilitimin e viktimave të dhunës dhe abuzimit, veçanërisht viktimave të prekura nga format më të rënda.

Regjistrimi i lindjeve dhe pashtetësia

Sipas raportit të UNHCR-së në vitin 2018,²⁵⁷ në Shqipëri 1,031 persona ishin në rrezik pashtetësie, por shifrat aktuale mund të jetë më të larta, kjo pasi shpeshherë personat pa shtetësi lihen në harresë.²⁵⁸ Studimi zbuloi se pjesa më e madhe e personave në rrezik të të qenit pa shtetësi në Shqipëri e kanë të drejtën e shtetësisë sipas ligjit për shtetësinë, por vështirësia qëndron në konfirmimin e saj në praktikë. Pengesa kryesore është aksesimi në regjistrimin e lindjeve, gjë që konsiston në procedura të kushtueshme dhe të gjata administrative dhe gjyqësore. Në vitin 2018, 97 për qind e atyre që rrezikoheshin nga pashtetësia ishin fëmijë dhe më pak se 50 për qind ishin nën moshën pesë vjeç. Në total, 84 për qind e tyre që ishin në rrezik për mos marrjen e shtetësisë kishin hasur pengesa në lidhje me procedurat e regjistrimit të lindjeve, nga të cilët, pesëdhjetë e tre për qind kishin lindur jashtë Shqipërisë, dymbëdhjetë për qind kishin lindur nga prindër të pamartuar, dhjetë për qind kishin lindur në shtëpi dhe nëntë për qind kishin lindur në spitale, ku informacionet personale të nënës ishin të pasakta. Me ndryshimet e fundit, ligji tashmë ka siguruar që fëmijët e lindur pa shtetësi në territorin shqiptar, fëmijët e braktisur, fëmijët e birësuar dhe shumica e fëmijëve të lindur nga shtetas jashtë vendit të fitojnë kombësinë. Fëmijët përballen ende me vështirësi nëse prindërit kanë dokumentacion të parregullt dhe si rrjedhim komunitetet romë dhe egjiptiane ndikohen në mënyrë të pabarabartë, ndërsa fëmijët e lindur jashtë vendit nga prindërit romë, veçanërisht në Greqi²⁵⁹, përballen me vështirësi të veçanta. Edhe fëmijët e riatdhësuar nga zonat e prekura nga konflikti përballen me pengesa për zgjidhjen e statusit të tyre ligjor dhe marrjen e shtetësisë.

Shqipëria ka nënshkruar konventat mbi Statusin e Personave pa Shtetësi (1954) dhe Reduktimin e Pashtetësisë (1961). Rishikimi i fundit (2021) i Ligjit për të Huajt përcakton që personave pa shtetësi t'u jepet një leje e përkohshme (deri në 1 vit) për të qëndruar në Shqipëri. Statusi pa shtetësi duhet të vërtetohet paraprakisht nga autoritetet përgjegjëse. Leja e përkohshme u lejon atyre të përfitojnë kujdes shëndetësor, ndihmë ekonomike, ndihmë juridike falas, shërbime përkthimi dhe mbështetje psikologjike. Zbatimi i këtij legjislacioni duhet të monitorohet nga afër.

²⁵⁵ Ali S., Ballo M., Gvineria D., Verzivollu I., 2020. *Çështje të humbura Gjetje dhe rekomandime nga një vlerësim i thelluar i mangësive në hetimin e abuzimit seksual të fëmijëve online në Shqipëri* UNICEF në Shqipëri. Tiranë, i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/media/3361/file/The%20lost%20Cases.pdf>

²⁵⁶ Progres Raporti, 2019, puna e cituar.

²⁵⁷ UNHCR, TLAS, 2018. *Mapping of the population at risk of statelessness in Albania*. [Hartëzimi i popullatës në rrezik pashtetësie në Shqipëri] Tiranë.

²⁵⁸ Shihni Indeksën e Pashtetësisë për Shqipërinë në <https://index.statelessness.eu/country/albania> për detaje të mëtejshme.

²⁵⁹ Hojsik M., Fremlova L., (eds), 2019. *A synthesis of civil society's reports on the implementation of national Roma integration strategies in the European Union*. [Një sintezë e raporteve të shoqërisë civile mbi zbatimin e strategjive kombëtare të integritimit të romëve në Bashkimin Evropian] Qendra për Studime Politikash, CEU. Budapest, e disponueshme në <https://cps.ceu.edu/sites/cps.ceu.edu/files/attachment/basicpage/3172/rcm-civil-society-monitoring-report-synthesis27-2019-eprint.pdf>

Çdo strategji për të parandaluar pashtetësinë duhet të përfshijë një partneritet midis shtetit, organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve. Procesi kombëtar i regjistrimit civil dhe regjistrimit të lindjeve në Shqipëri duhet të thjeshtohet dhe i gjithë stafi të trajnohet për ta kryer këtë procedurë në mënyrë efikase dhe pa diskriminim. Kërkesat lidhur me dokumentacionin duhet të thjeshtohen dhe të reduktohen kostot.

Fëmijët jashtë kujdesit familjar

Neni 18 i KKBD-së përforcon rëndësinë e familjes në jetën e fëmijës dhe specifikon se *“shtetet palë duhet t’u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.”*²⁶⁰. Gjithashtu, Neni 20 vendos shtetet palë përpara përgjegjësisë që të sigurojnë kujdes alternativ të përshtatshme për fëmijët e privuar nga mbështetja familjare. Përparësitë e mjedisit familjar kundrejt modeleve të tjera të kujdesit janë vërtetuar gjerësisht gjatë disa dekadave.²⁶¹ Asnjë NJQV nuk ka mundur të hartojë dhe miratojë një listë gjithëpërfshirëse të familjeve kujdestare dhe mungesa e shërbimeve të kujdesit të bazuar në komunitet në shumicën prej tyre kufizon disponueshmërinë e mundësive që janë vërtet miqësore me fëmijët për fëmijët në nevojë për kujdes alternativ. Vendosja nën kujdestari me lidhje gjaku vijon të mbizotërojë. Mekanizimi i financimit bazohet në konceptin se kujdestaria është bamirësi dhe jo punë. Si rrjedhojë, shpërndarjet buxhetore kryhen vetëm për fëmijët nën kujdes, por jo për shpërbimin, trajnimin dhe mbikëqyrjen e familjeve kujdestare dhe personelin përkatës për të mbështetur familjet kujdestare. Ekziston mendimi se familja kujdestare është e huaj për kulturën dhe traditat shqiptare, apo se kujdestaria praktikohet kryesisht nga të huajt në vend dhe se pak njerëz janë të gatshëm të kujdesen për fëmijët e të tjerëve, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në vitin 2019, 218 fëmijë qëndronin në nëntë institucionet publike të kujdesit,²⁶² tre prej të cilave funksionojnë nën Shërbimin Social Shtetëror dhe gjashtë menaxhohen bashkërisht nga MSHMS-ja dhe NJQV-të. **Mesa duket, modeli i ‘pronësisë’ së dyfishtë krijon disa vështirësi në aspektin e menaxhimit ditor, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen dhe emërimin e personelit, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e performancës/cilësisë së shërbimit.** Gjithashtu, 69 fëmijë me aftësi të kufizuara qëndrojnë në pesë qendrat publike të zhvillimit,²⁶³ dy prej të cilave i përgjigjen drejtpërdrejt Shërbimit Social Shtetëror dhe të tjerat menaxhohen në bashkëpunim. Një vlerësim i nevojave²⁶⁴ i vitit 2019 konstatoi se mbi 90 për qind e fëmijëve në institucionet publike rezidenciale të shërbimit vinin nga familje të varfra ose ekonomikisht të pafavorizuara, me prindër të papunë, ose prindër me probleme të shëndetit mendor dhe që u mungonte aksesit në shërbimet bazë të kujdesit. Pavarësisht detyrimeve ligjore të NJQV-ve për të ofruar një paketë standarde shërbimesh të kujdesit shoqëror, ende nuk ka një sistem plotësisht funksional në nivel vendor që mund të ofrojë programe për prindërim pozitiv, apo të menaxhimit të varësive ndaj substancave abuzive të prindërve, trajtim të sjelljeve agresive të rriturit/prindërit. Më shumë se 30 për qind e fëmijëve që jetojnë në shtëpitë e kujdesit rezidencial janë viktime të neglizhencës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Vlerësimi i nevojave vuri në dukje se **institucionet nuk ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin psikologjik dhe emocional të fëmijëve dhe se rreth 70 për qind e fëmijëve në këto institucione shfaqin vonesa në zhvillim, të shkaktuara nga faktorët e mjedisit.** Institucionet e kujdesit rezidencial fokusohen kryesisht në kujdesin fizik dhe jo në zhvillimin individual. Për më tepër, shërbimet janë kryesisht të organizuara për t’u shërbyer fëmijëve jetimë, më shumë se të mbijetuarve nga abuzimi apo neglizhenca. **Fëmijët zakonisht qëndrojnë për një kohë të gjatë në këto institucione për shkak të paqartësive ligjore dhe procedurave të gjata që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve.** Ndërkohë, këtyre institucioneve u mungojnë shërbimet e specializuara, si psiko-terapistët

²⁶⁰. Shihni Preambulën për Konventën për të Drejtat e Fëmijës në Newell P., Hodgkins R., 2012. *Udhëzues zbatimi për të Drejtat e Fëmijës*. UNICEF, Nju Jork, puna e cituar, f. 660.

²⁶¹. Për shembull, shihni Save the Children, 2009. *Keeping Children Out of Harmful Institutions: Why we should be investing in family-based care*. [Mbajtja e fëmijëve jashtë institucioneve të dëmshme: Përse duhet të investojmë në kujdesin e bazuar në familje] E disponueshme në <http://www.savethechildren.org/se/3067>; dhe Williamson J., Greenburg A., 2010. *Families not Orphanages*. [Familje, jo jetimore] Better Care Network, UNICEF, Gjenevë, e disponueshme në <http://www.crin.org/docs/FamiliesNotOrphanages.pdf>

²⁶². INSTAT, 2021. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2017-2019*, puna e cituar

²⁶³. Po aty

²⁶⁴. MSHMS, UNICEF, 2020. *Cituar në Planin Kombëtar për Deinstitutionalizim 2020-2022*. Prill 2020. Tiranë.

dhe terapistët e të folurit, disa prej tyre nuk kanë psikologë dhe punonjës socialë të kualifikuar, si dhe mungon mbikëqyrja profesionale e personelit dhe shërbimit në përgjithësi që ofrohet në këto qendra. Akoma nuk është realizuar vlerësimi gjithëpërfshirës i fëmijëve në qendrat rezidenciale jo publike dhe atyre me aftësi të kufizuara në qendrat e zhvillimit. Kërkohet gjithashtu identifikimi i ndërhyrjeve të menjëhershme dhe afatgjata për të gjithë fëmijët nën kujdesin rezidencial.²⁶⁵

Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Deinstitutionalizimin e fëmijëve në shtator të vitit 2020 ofron një mundësi për të nxitur bashkëpunimin aktiv midis strukturave qeverisëse qendrore dhe vendore, partnerëve kryesorë të zhvillimit dhe OJF-ve lokale. Reforma e Deinstitutionalizimit ka përparësi në Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë për vitet 2021–2023 dhe, në Mars 2021, qeveria aprovoi fonde për të pilotuar në dy bashki zhvillimin e shërbimeve alternative të kujdesit ndaj fëmijëve, të tilla si kujdestaria ligjore (guardianship) dhe shërbimi i kujdestarisë profesionale, që do të përshpejtojnë mbylljen e institucioneve rezidenciale.

Kohët e fundit, është rritur numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar në Shqipëri, të cilët u vendosën nën kujdesin e përkohshëm rezidencial, që është i papërshtatshëm dhe i paaftë të ofrojë kujdesin e nevojshëm për këtë kategori fëmijësh. Pengesat normative që pengojnë ofrimin e kujdesit alternativ për ata që s'janë shtetas shqiptarë, duhet të largohen sa më shpejt për të krijuar opsione të kujdesit alternativ miqësor dhe adoptueshëm për ata fëmijë që nuk mund të ribashkohen me familjet e tyre biologjike.

Fëmijët në migrim

Migrimi dhe lëvizja duket se janë faktorë të jetës së pjesës më të madhe të fëmijëve shqiptarë. Diaspora e përbërë nga 1,5 milionë persona përfshin rreth 388,000 fëmijë. Ndërkohë, lëvizja nga zonat rurale në ato urbane është e lartë dhe 10.6 për qind e të anketuarve në censusin e vitit 2011 kishin ndërruar shtëpi në dekadën e mëparshme²⁶⁶. Shifrat e INSTAT-it tregojnë se fëmijët prirën të migrojnë me prindërit ose mbeten nën kujdesin e anëtarëve të familjes së gjerë, derisa të mund të ribashkohen me prindërit e tyre.

Gjatë periudhës nga viti 2010 deri në muajin dhjetor 2019, rreth 200,000 shtetas shqiptarë aplikuan për azil për herë të parë në vendet e BE-së.²⁶⁷ Megjithatë, statistikat e BE-së tregojnë se në vitin 2018, vetëm 2,1 për qind e aplikimeve për azil nga shtetasit shqiptarë u pranuan nga vendet pritëse. Pjesa tjetër janë kthyer ose mund të kthehen në Shqipëri në të ardhmen e afërt.²⁶⁸ Gjatë tre viteve nga 2015 në 2017, Shqipëria ishte në krye të listës së vendeve për numrin e personave të kthyer nga vendet e BE-së.²⁶⁹ **Ndërkohë, ka ende numra të konsiderueshëm fëmijësh shqiptarë migrantë në kujdesin publik në vende të tjera evropiane, ndërsa vetëm në Itali, në qershor 2020, ishin 1,393 fëmijë shqiptarë të pashoqëruar.**²⁷⁰

Aktualisht, vendi po pëson një ndryshim kulturor për sa i përket migrimit. Gjatë tri dekadave të fundit, migrimi ka shërbyer si një valvul sigurie dhe si një rrjet sigurie për Shqipërinë, por ndryshimi në profilin e atyre që hyjnë në Evropë që nga viti 2015, ka kufizuar opsionet e familjeve shqiptare. Përpara vitit 2015, shumica e migrantëve në BE vinte nga Kosova²⁷¹, Shqipëria dhe Serbia,²⁷² por, në nëntë muajt e

²⁶⁵ MSHMS, 2020. *Raport Monitorimi katërvjeçar për Planin Kombëtar të Veprimit për Fëmijët 2017-2020*, puna e cituar.

²⁶⁶ Kosta B., 2014. *Albania: Looking Beyond Borders* [Shqipëri: Të shikosh përtej kufijve]. Instituti i Politikave të Migracionit, <http://www.migrationpolicy.org/article/albania-looking-beyond-borders>. Shihni dhe INSTAT, 2014. *Popullsia dhe dinamikat e popullsisë në Shqipëri: Horizonte të reja demografike?* Tiranë, f. 29.

²⁶⁷ OECD, 2019. Parashikimi për Migrimin Ndërkombëtar 2019. Botimet OECD. Paris.

²⁶⁸ Informacion nga World Data, <https://www.worlddata.info/europe/albania/asylum.php>.

²⁶⁹ Grupi i Bankës Botërore, 2019. *Supporting the Effective Reintegration of Roma Returnees in the Western Balkans* [Mbështetja e riintegritimit efikas të romëve të kthyer në Ballkanin Perëndimor]. Uashington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Botërore; Morrica V., Stavrou S., 2018. Prezantim në PowerPoint në Workshop-in e Konceptimit "Mbështetja e riintegritimit efikas të romëve të kthyer në Ballkanin Perëndimor". Vjenë, më 15 janar

²⁷⁰ Shihni <https://www.lavoro.gov.it/temi-e-priorita/immigrazione/focus-on/minori-stranieri/Documents/Report-MSNA-mese-giugno-2020.pdf>

²⁷¹ Kosova sipas UNSC 1244.

²⁷² *Direktiva e Vendeve të Sigurta* KE (shtator 2015) Bruksel, cituar në punimin e Byrne K. *Law, Policy and Practice Affecting Migrant and Refugee Children in Europe [Ligji, Politika dhe Praktika që Ndikojnë Fëmijët Migrantë dhe Refugjatë në Evropë]* Zyra e Kërkimit të UNICEF / Innocenti (nëntor 2016) Firenze.

parë të vitit 2015, kombësitë më të shumta që kërkonin azil në BE ishin sirianët (222,000; 25%), afganët (103,000; 11%) dhe irakianët (69,000; 8%).²⁷³ **Ky ndryshim në modelet e migrimit ka shkaktuar rritjen e pashmangshme të konkurrencës për vende pune në shtetet anëtare të BE-së dhe shtrëngim të kufizimeve në përgjithësi ndaj aplikimeve për azil nga vendet jo-prioritare, sikurse pasqyrohet nga rritja e numrit të aplikimeve të refuzuara dhe kthimet më të shpejta. Për më tepër, nga Shqipëria dhe vendet e tjera në fazën e para-aderimit pritet të mirëpresin pjesën e tyre të azilkërkuesve dhe emigrantëve të huaj.**

Shumica e migrantëve të parregullt në vitin 2019 në Shqipëri erdhën nga Iraku dhe Siria,²⁷⁴ dhe në vitin 2020, nga Siria (38,3%), Afganistani (16%), Iraku (15,6%) dhe Maroku (13,4%).²⁷⁵ Megjithëse fëmijët përfaqësojnë pakicë (13,6%),²⁷⁶ numri i tyre po rritet me shpejtësi dhe shumicës i nevojiten shërbime shtesë.

Gjatë dekadës së fundit, numri i kërkesave për azil të bëra nga shtetas të huaj në Shqipëri është rritur. Në vitin 2015 pati 106 kërkesa të tilla, në vitin 2017 pati 309,²⁷⁷ dhe në vitin 2019 numri shkoi në 6,677.²⁷⁸ Të dhënat e UNHCR-së për vitin 2020 tregojnë se rreth 75 për qind e azilkërkuesve janë meshkuj, dhe se 25,6 për qind janë fëmijë.²⁷⁹ Numri i fëmijëve azilkërkues u rrit nga 227²⁸⁰ në vitin 2016 në 1,709 në vitin 2020.²⁸¹ **Vendimi i Këshillit të Ministrave, i lëshuar në muajin prill 2019, për të siguruar se ky grup të gëzojë plotësisht të drejtat sipas legjislacionit shqiptar ende nuk është zbatuar plotësisht, duke i lënë familjet migrante pa mbështetjet e duhur.** Duhet patjetër të trajtohet çështjen e numrave personalë të identifikimit të papajtueshëm / pavlefshëm, të cilët nuk lejojnë që refugjatët të kenë akses të plotë në mbrojtjen sociale. Migrantët azilkërkues apo që presin vendimin përfundimtar të apelit, qëndrojnë në Qendrën Kombëtare Pritëse në Babrru. Gjatë vitit 2019, në qendër ishin 1,602 fëmijë, 124 nga të cilët ishin të pashoqëruar.²⁸² Azilkërkuesit ankohen për kushte jetese të papërshtatshme. Disa prej tyre detyrohen të lypin për ushqim dhe veshje, ose të flenë në parqe apo në rrugë.²⁸³ Kushtet janë më të vështira për fëmijët e pashoqëruar dhe fëmijët e huaj të ndarë që nuk aplikojnë për azil apo që nuk janë klasifikuar si viktima të trafikimit.²⁸⁴ Përcaktimi i moshës së tyre kryhet pa ndonjë metodë të posaçme, kryesisht nëpërmjet vetëdeklarimit. Menaxhimi i rasteve nuk zhvillohet në mënyrë të integruar. Profesionistët në fushën e mirëqënies shoqërore, të angazhuar edhe në trajtimin e rasteve të fëmijëve, kanë kapacitete të kufizuara për menaxhimin e rasteve; prania e psikologut gjatë intervistës nuk është gjithmonë e mundur për shkak të mungesës, dhe fëmijët nuk marrin shërbime të kujdesit shoqëror si pasojë e mangësive ligjore ekzistuese.

²⁷³ Rrjeti Evropian i Migrimit, 2015. *EMN Inform*. Bruksel, cituar po aty.

²⁷⁴ UNHCR, 2020. *Albania Border Protection Monitoring 2019 Report: Progressive overview [Raport Monitorimi i Mbrojtjes së Kufijve 2019 Shqipëri: Përmbledhje progresive]*.

²⁷⁵ UNHCR, 2020. *Asylum Seekers Dashboard 2020: Progressive overview [Paneli i Azilkërkuesve 2020: Përmbledhje progresive]*.

²⁷⁶ UNHCR, 2020. *Albania Border Protection Monitoring 2019. Raport: Progressive overview [Raport Monitorimi i Mbrojtjes së Kufijve 2019 Shqipëri: Përmbledhje progresive]*.

²⁷⁷ Ministria e Punëve të Brendshme, 2018. *Profili i Migrimit 2017*. Tiranë.

²⁷⁸ UNHCR, 2020. *Asylum Seekers Dashboard 2020: Progressive overview [Paneli i Azilkërkuesve 2020: Përmbledhje progresive]*.

²⁷⁹ Po aty

²⁸⁰ Xhaho A., Tandili LI A., 2019. *Vulnerable Asylum Seekers and Irregular Migrants in Albania, Trends, Challenges, and Policy Solutions [Azilkërkuesit e cenueshëm dhe Migrantët e Parregullt në Shqipëri, Trendet, Sfidat dhe Zgjidhjet e Politikave]*. Dokument politikash, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, qershor i disponueshëm në https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2019/09/policy-brief_Vulnerable-asylum-seekers-and-irregulat-migrants.pdf

²⁸¹ UNHCR., 2020. *Asylum Seekers Dashboard 2020: Progressive overview [Paneli i Azilkërkuesve 2020: Përmbledhje progresive]*.

²⁸² Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve, 2020 *Raporti vjetor 2019*. Tiranë.

²⁸³ Brakaj M., 2020. *Conditions and rights of refugees in Albania [Kushtet dhe të drejtat e refugjatëve në Shqipëri]*. Zëri i Amerikës, 20 qershor 2020. <https://www.zeriamerikes.com/a/5470608.html>

²⁸⁴ Xhaho A., Tandili LI A., 2019. *Azilkërkuesit e cenueshëm dhe Migrantët e Parregullt në Shqipëri, Trendet, Sfidat dhe Zgjidhjet e Politikave*. Përmbledhje e shkurtër e politikës, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim [Policy Brief, Institute for Democracy and Mediation], Qershor.

3.5 E DREJTA PËR PJESËMARRJE, TË DREJTA CIVILE DHE LIRI



©UNICE Albania 2016 Pirozzi

Fëmijët gëzojnë të drejta dhe liri të plota civile në Shqipëri, por në përgjithësi nuk janë të rëndësishëm në axhendën politike. Siguria, dhe mbrojtja që u ofrohet atyre brenda familjeve të zgjeruara e të lidhura me njëra-tjetrën që jetojnë në komunitete relativisht homogjene janë ekuilibruar në një farë mase nga mungesa e pavarësisë të veprimit, dhe statusit më të ulët shoqëror. Ndonëse për fëmijët shqiptarë kujdesen shumë mirë dhe janë të sigurt, ata përgjithësisht perceptohen si të varur dhe të nënshtruar ndaj drejtimit të të rriturve, veçanërisht atij patriarkal. Gjithashtu, ekziston stigma ndaj fëmijëve që konsiderohen të ndryshëm, ku përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuar, fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët nga familje të varfra, fëmijët jashtë kujdesit familjar dhe adoleshentët nga komuniteti LGBTI.²⁸⁵ **Mospërfshirja e fëmijëve në pjesëmarrjen qytetare duhet të konsiderohet në kontekstin e normave të gjera shoqërore dhe politike, ku pjesëmarrja e publikut në proceset e qeverisjes është ende një koncept relativisht i ri, besimi në institucionet qeveritare është i ulët²⁸⁶ dhe nuk ekziston një traditë e shëndoshë e përfshirjes qytetare.²⁸⁷**

Ekziston një portofol²⁸⁸ studimesh me në qendër fëmijët, i cili ofron një panoramë të pjesshme të perspektivave të fëmijëve për çështjet të kanë të bëjnë me ta. Gjetjet e Anketës 'Bota e Fëmijëve'²⁸⁹ të vitit 2019 pasqyrojnë jetën përgjithësisht të sigurt, të siguar dhe të lumtur të shumicës së fëmijëve shqiptarë. Mbi 80 për qind e konsiderojnë veten plotësisht të lumtur me familjen e tyre dhe ndihen të sigurt në të. Megjithatë, **si në këtë anketë, po ashtu edhe në studimin SSHFMSH 2018, grupmosha më e rritur (12–14 vjeç) ishin vazhdimisht më pak të kënaqur me jetën e tyre se grupi më i vogël në moshë, gjë që përkon me aftësitë e tyre kryesore në zhvillim.** Ndonëse 74,5 për qind e dhjetëvjeçarëve binin dakord se Shqipëria është një vend i sigurt për fëmijët, vetëm 56,4 për qind e 12-vjeçarëve ndanin të njëjtin mendim. Megjithëse 82,8 për qind e fëmijëve raportuan se i njohin të drejtat e tyre, vetëm 68,2 për qind pranuan se të drejtat e tyre

²⁸⁵ Shihni Rogers J. Sammon E., 2016. *We All Matter* [Të gjithë kemi rëndësi], puna e cituar.; Poni S., et al., *Being LGBT in Eastern Europe: Albania Country Report—Reducing Inequalities & Exclusion and Combating Homophobia & Transphobia experienced by LGBTI people in Albania* [Të jesh LGBT në Evropën Lindore: Raporti i Vendit për Shqipërinë - Reduktimi i pabarazive dhe përjashtimit dhe lufta kundër homofobisë dhe transfobisë që përjetojnë personat LGBTI në Shqipëri]. USAID–UNDP.

²⁸⁶ Vrugtman L., Bino B., 2021. *Opinion Poll 2020: Trust in Governance Survey Report*. [Anketë opinioni 2020: Raport i Anketës Besimi në Qeverisje] Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) Tiranë, e disponueshme në <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>.

²⁸⁷ Shihni Eurofound, 2019, puna e cituar, dhe Theksuar në *Indeksin World Giving 2018* të Fondacionit të Ndhmës për Bamirësi, CAF, i disponueshëm në https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-publications/caf_wgi2018_report_webnopw_2379a_261018.pdf.

²⁸⁸ Cuninghame, C. 2020. *Child Rights Issues in Child Participatory-Focused Documents – a Short Review* [Çështjet e të drejtave të fëmijës në dokumentet e përqendruara në pjesëmarrjen e fëmijës: një shqyrtim i shkurtër]. UNICEF në Shqipëri, puna e cituar.

²⁸⁹ Save the Children, Universiteti Marin Barletti, Universiteti i Tiranës, 2018. *Children's World—A National Survey of Children's Well-Being [Bota e Fëmijëve - Anketim Kombëtar i Mirëqenies së Fëmijëve]*Tiranë.

respektoheshin. Fëmijët e moshës nga dhjetë deri në 18 vjeç²⁹⁰ shfaqën një mungesë thelbësore besimi ndaj institucioneve dhe aktorëve në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, po ashtu dhe në atë arsimor. Kultura e heshtjes në shtëpi dhe në komunitet në lidhje me dhunën është thelbi i këtij mosbesimi.

Duke parë pjesëmarrjen e fëmijëve në Shqipëri nëpërmjet një perspektive për të drejtat e fëmijëve, është e qartë se vendi ka kapacitet të lartë për t'u dhënë fëmijëve hapësirë dhe zë, por ka ende rezistencë nga të rriturit dhe institucionet për ta bërë këtë²⁹¹. Ashtu si në pjesën më të madhe të shoqërive, fëmijët janë të hapur për diskutim dhe përfshirje në çështjet e komunitetit, por është më e vështirë t'i bësh të rriturit të dëgjojnë, se sa t'i bësh fëmijët të flasin.²⁹² Në këtë gjysmë të ekuacionit duhet të investohen më shumë burime dhe energji.

OJF-të në Shqipëri kanë aftësitë dhe ekspertizën teknike për të lehtësuar përfshirjen e fëmijëve në vendimarrje, por, aktualisht, kjo ndodh vetëm si pjesë e nismave të caktuara, zakonisht të mbështetura nga donatorë. **Në vend të kësaj, palët e interesit mund të bashkëpunojnë për të fuqizuar dhe zgjeruar rolin e Këshillave të Fëmijëve në shkolla dhe për të përfshirë realisht dhe me efikasitet fëmijët dhe prindërit në administrimin e shkollës, si dhe për të ngritur mekanizma që do të ndikojnë vendimarrjen për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët dhe adoleshentët në nivelin e NJQV-ve.²⁹³** Mund të nevojiten nisma të caktuara për të tejkaluar barrierat ndaj pjesëmarrjes së plotë në shoqëri me të cilat përballen vajzat, fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga familjet e varfra dhe fëmijët që jetojnë në zonat rurale.



²⁹⁰ Shihni Stephenson P., 2018. *Konsultimet e fëmijëve për materiale miqësore për fëmijët Ligji Kombëtar Shqiptar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 18 Gjetje dhe Rekomandime* UNICEF, Tiranë.

²⁹¹ Përshtatur nga Lundy L., 2007. *Voice is not enough: Conceptualizing Article 12 of the UNCRC* [Zëri nuk mjafton: Konceptimi i Nenit 12 të KKBDf-së], Revista Kërkimore Arsimore Britanike, V. 33, Nr. 6, f. 927–42, 2007.

²⁹² Shihni 'Zëri i Fëmijëve' në *Raportin e Zbatimit Katërvjeçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020*, puna e cituar.

²⁹³ Po aty.

Bibliografia

STUDIME DHE BOTIME

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, ASCAP, 2016. Korniza Kurrikulare Parashkollore, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Tiranë, e disponueshme në <https://ascap.edu.al/wpcontent/uploads/2018/03/Korniza-Kurrikulare-e-arsimit-parashkollorit-IZHA-Dhjetor-2016.pdf>
- Banka Botërore, 2020. *An Uncertain Recovery. Regular Economic Report on the Western Balkans No. 18*. [Një Rimëkëmbje e Pasigurt. Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor Nr. 18], i disponueshëm në <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/34644>
- Banka Botërore, 2019. *Western Balkans Regular Economic Report No. 15. Reform Momentum Needed* [Raporti Ekonomik Periodik për Ballkanin Perëndimor Nr. 15. Kërkohej Momentim me Reformën] Pranverë 2019.
- Banka Botërore 2019. *Europe and Central Asia Macro Poverty Outlook: Country-by-country Analysis and Projections for the Developing World*. [Pikëpamje makro mbi varfërinë në Evropë dhe Azinë Qendrore: Analizë nga vendi në vend dhe plane për botën në zhvillim] Uashington, <http://pubdocs.worldbank.org/en/107191492012467509/mpo-eca.pdf>
- Banka Botërore, 2018. Indeksi i Kapitalit Njerëzor. I disponueshëm në <https://www.worldbank.org/en/publication/human-capital>
- Banka e Shqipërisë, 2021. *Raporti vjetor 2020*. Tiranë, i disponueshëm në https://www.bankofalbania.org/Publications/Annual_Report_2020.html
- Banka e Shqipërisë, 2020. *Raporti vjetor 2019*. Tiranë, i disponueshëm në https://www.bankofalbania.org/Publications/Periodic/Annual_Report/Annual_Report_2019.html
- Barjaba K., Barjaba J., 2015. *Embracing Emigration: The Migration-Development Nexus in Albania* [Pranimi i Emigrimit: Lidhja midis Migrimit dhe Zhvillimit në Shqipëri]. Instituti i Politikave të Migrimit <https://www.migrationpolicy.org/article/embracing-emigrationmigration-development-nexus-albania>
- Bisha E., Sulstarova A., Shapo Zh., Ymeri H., 2019. *Faktori Web: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për adresimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike në Shqipëri*, UNICEF në Shqipëri, Shapo Consulting. Tiranë, i disponueshëm në https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2019-10/ENG_Webfactor_UNICEF%20Albania%202019.pdf
- Bradshaw J., et al., 2016. *Child Well-Being in Albania*. [Mirëqenia e Fëmijëve në Shqipëri] UNICEF. Tiranë, e disponueshme në <https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2019-01/Child%20Well-Being%20in%20Albania.pdf>
- Brakaj M., *Conditions and rights of refugees in Albania* [Kushtet dhe të drejtat e refugjatëve në Shqipëri]. Zëri i Amerikës, 20 qershor 2020. <https://www.zeriamerikes.com/a/5470608.html>
- Byrne K., 2016. *Law, Policy and Practice Affecting Migrant and Refugee Children in Europe*. [Ligji, Politika dhe Praktika që Ndikojnë Fëmijët Migrantë dhe Refugjatë në Evropë] Zyra e Kërkimit UNICEF, Innocenti, nëntor 2016. Firenze (punim i brendshëm).
- Cuningham C., 2020. *Child Rights Issues in Child Participatory-Focused Documents – a Short Review* [Çështjet e të drejtave të fëmijës në dokumentet e përqendruara në pjesëmarrjen e fëmijës: një shqyrtim i shkurtër].
- Çani B., et al., 2015. *Invisible Violence—An overview of the on violence against women and girls with disabilities in Albania* [Dhunë e padukshme - Një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave e vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri]. I disponueshëm në <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/invisible-violence—an-overview-on-the-phenomenon-of-violence-a/>
- Davy, D., dhe Metanji, B. (2020) *First Wave Survey Study on Youth Knowledge, Attitudes and Practices with Regard to Human Trafficking, in Four Regions in Albania* [Anketë e valës së parë - Njohuritë, Qëndrimet dhe Praktikrat e të Rinjve lidhur me Trafikimin e Qenieve Njerëzore, në Katër Rajone

- INSTAT, 2021. *Të ardhurat dhe niveli i jetesës në Shqipëri 2017-2019*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/media/8364/income-and-living-condition-2019.pdf>.
- INSTAT *Popullsia e Shqipërisë 2021*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/media/8305/population-on-1-january-2021.pdf>.
- INSTAT, 2020. *Burrat dhe Gratë në Shqipëri* Tiranë, i disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/publication/2020/women-and-men-in-albanian-2020/>
- INSTAT, 2020. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2016–2018*. Tiranë, i disponueshëm në <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2020/children-adolescents-and-youth-focused-wellbeing-indicators-data-from-2016-2018/>
- INSTAT, IOM, 2020. *Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri 2021*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2021/national-household-migration-survey-in-albania/>
- INSTAT, 2020. *Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë* f. 11. Tiranë, i disponueshëm në http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf
- INSTAT, 2019. *Të huajt dhe azilkërkuesit në Shqipëri* Gusht 2019, i disponueshëm në <http://instat.gov.al/media/6181/foreigners-and-asylum-seekers-2018.pdf>
- INSTAT, 2019. *Anketa e dhunës ndaj grave dhe vajzave* UNDP, UN Women. Tiranë, e disponueshme në https://data.unwomen.org/sites/default/files/inline-files/Albania_VAWG-pop-survey.pdf
- INSTAT, 2018. *Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale 2016–2017*. Të disponueshme në <http://www.instat.gov.al/media/4824/crime-and-criminal-justice-statistics.pdf>
- INSTAT, ISHP, KNF, 2018. *Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2017-18*. Instituti i Statistikave, Instituti i Shëndetit Publik, dhe KNF Tiranë, i disponueshëm në <https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf>
- INSTAT, 2011. *Anketa e Përdorimit të Kohës 2011*. Tiranë, e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/time-use-survey/>
- Indeksi i Performancës Mjedisore, 2020. *Rezultatet EPI*: të disponueshme në <https://epi.yale.edu/epi-results/2020/component/epi>
- Indeksi World Giving CAF, i disponueshëm në https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-publications/caf_wgi2018_report_webnopw_2379a_261018.pdf
- King R., Gedeshi I., 2020. *The actual and potential migration of students from Albania: a putative brain drain*. [Migracioni aktual dhe i mundshëm i nxënësve nga Shqipëria: migrim i pranuar i trurit?]. Ebert Foundation, i disponueshëm në <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17258.pdf>
- Këshilli i Evropës. *Estimates on Roma population in European countries* [Përlogaritje të Popullsisë Rome në Vendet e Evropës], sikundër renditet në Dokumentin e përgatitur nga Ekipi Mbështetës i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Çështjet Rome <https://www.coe.int/en/web/roma-and-travellers/publications>
- Kombet e Bashkuara, 1989. *Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës* Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, e disponueshme në <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>
- Kombet e Bashkuara, 2015. *Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development* [Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm] Rezoluta 70/1, e miratuar në mbledhjen e 70-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 25 shtator 2015, e disponueshme në <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës, 2016. *Qasja në drejtësi, diskriminimi dhe fëmijët. Një vështrim i vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me fëmijët, nga pikëpamja e diskriminimit dhe barazisë* Tiranë, e disponueshme në https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2018-12/2016-Access_to_Justice.pdf
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave në <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në <https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>

- Komiteti i KB për të Drejtat e Fëmijës, Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 2017a. *Komenti i përbashkët i përgjithshëm Nr. 3 (2017) i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre dhe Nr. 22 (2017) i Komitetit të të Drejtave të Fëmijës për Detyrimet e shtetit lidhur me të drejtat e njeriut të fëmijëve në kontekstin e migrimit ndërkombëtar*. OHCHR, 16 nëntor 2017. Gjenevë, e disponueshme në <http://www.refworld.org/docid/5a12942a2b.html>
- Komiteti i KB për të Drejtat e Fëmijës, Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 2017b. *Komenti i përbashkët i përgjithshëm Nr. 4 (2017) i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre dhe Nr. 23 (2017) i Komitetit të të Drejtave të Fëmijës për Detyrimet e shtetit lidhur me të drejtat e njeriut të fëmijëve në kontekstin e migrimit ndërkombëtar në vendet e origjinës, tranzitit, mbërritjes dhe kthimit*. OHCHR, 16 nëntor 2017. Gjenevë, i disponueshëm në <http://www.refworld.org/docid/5a12942a2b.html>
- Komisioni Evropian, 2019a. *Staff Working Document: Albania 2019*. [Dokument Pune i Stafit: Shqipëri 2019] Raport SWD; 215; 2019. Bruksel, i disponueshëm në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>
- Komisioni Evropian, 2019b. *Commission Staff Working Document: Economic Reform Programme of Albania 2019–2021* [Dokument Pune i Stafit të Komisionit: Programi i Reformës Ekonomike 2019-2021]. Raport SWD; 166; 2019. Bruksel.
- Komisioni Evropian, EACEA, Eurydice, 2019. *Recommended Annual Instruction Time in Full-time Education*. [Koha e rekomanduar vjetore e mësimdhënies në arsimin me kohë të plotë] Bashkimi Evropian, Luksemburg, i disponueshëm në <http://dx.doi.org/10.2797/714725> .
- Korunovska N., Jovanovic Z., 2020. *Roma in the COVID-19 Crisis [Romët në Krizën e COVID-19.]* Fondacioni Open Society, OSF. Berlin. Studimi mbuloi Bullgarinë, Hungarinë, Italinë, Rumaninë, Sllovakinë, dhe Spanjën.
- Kosta B., 2004. *Albania: Looking Beyond Borders* [Shqipëri: Të shikosh përtej kufijve]. Instituti i Politikave të Migrimit, <http://www.migrationpolicy.org/article/albania-looking-beyond-borders>
- Leoncikas T., et al., 2018. *Life and society in the EU candidate countries*. [Jeta dhe shoqëria në vendet candidate të BE-së] Eurofound. Seria e Anketave Evropiane për Cilësinë e Jetës 2016. Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian Luksemburg.
- Lundy L., 2007. *Voice is not enough: Conceptualizing Article 12 of the UNCRC*. [Zëri nuk mjafton: Konceptualizimi i Nenit 12 të KKBDF-së], Revistë Kërkimore Arsimore Britanike, V. 33, Nr. 6, f. 927-42; 2007.
- Maghnoij S., Fordham E., et al., 2020. *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania [Analiza për Vlerësimin dhe Vlerësimin* në Arsim: Shqipëri]* OECD, Paris, e disponueshme në <https://doi.org/10.1787/d267dc93-en>
- MASR, 2017. *Politikat arsimore për reduktimin e braktisjes së shkollës* Tiranë.
- MASR, 2017. *Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë - Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve*.
- MASR, 2014. *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020*
- McQuade A., Rexha J., Trimi A., 2020. *A typology of child trafficking in Albania*. [Tipologji e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri] OSBE
- Metanj B., Elezaj D., Peci Dh., 2021. *Knowledge, attitude and practices with regard to Covid-19 among the general population in Albania: Findings on national survey of second wave* [Njohuri, qëndrime dhe praktika në lidhje me COVID-19 te popullsia e gjerë në Shqipëri : Gjetje të anketës kombëtare të valës së dytë]. USAID, UNICEF në Shqipëri , IDRA.
- MSHMS, 2021. *Raport Zbatimi Katërvjeçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020* I disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>
- MSHMS, 2020. *Raport Programi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale*.
- Ministria e Drejtësisë, 2019. *Raport Monitorimi për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për Fëmijë*.
- Nikoloski Z., 2019. *Mapping Social Protection Transfers to Poor Households in Albania*. [Hartëzimi

i Transfertave të Mbrojtjes Sociale për Familjet e Varfra në Shqipëri] UNICEF Tiranë, i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore i Nismës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2021. *Exploited in plain sight - An assessment of commercial sexual exploitation of children and child protection responses in the Western Balkans* [Shfrytëzimi i dukshëm - Vlerësim i shfrytëzimit seksual ekonomik të fëmijëve dhe reagimet për mbrojtjen e fëmijëve në Ballkanin Perëndimor] Maj 2021.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, 2018. *Marriage in court? Children's rights, underage marriage and the role of the court' [Martesa në gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesat në moshë të vogël dhe roli gjykatës]* I disponueshëm në https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/07/Report2-Legal-social-analyze-underage-marriage_June2018.pdf

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, 2018. *Child Marriage Knowledge, Attitudes and Perception among Affected Communities*. [Njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet për martesat e fëmijëve në komunitetet e prekura] Tiranë, e disponueshme në <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Child-marriage-Report-Final-vesion.pdf>

OECD, 2020. *Education in a glance*, [Vështrim mbi arsimin] f. 159, i disponueshëm në https://www.oecd-ilibrary.org/education/education-at-a-glance_19991487

OECD, 2019. *TALIS 2018 Results (Volume I): Teachers and School Leaders as Lifelong Learners* [Rezultatet e TALIS 2018 (Vëllimi I): Mësuesit dhe Drejtuesit e Shkollave si Nxënës Gjatë Gjithë Jetës]. Paris, i disponueshëm në <https://dx.doi.org/10.1787/1d0bc92a-en>

OECD, 2019. *PISA 2018 Results (Volume I): What Students Know and Can Do* [Rezultatet PISA 2018 (Vëllimi I): Çfarë dinë dhe arrijnë të bëjnë nxënësit?] Paris, i disponueshëm në <https://doi.org/10.1787/5f07c754-en>

OECD, 2016. *PISA 2015 Results (Volume II): Policies and Practices for Successful Schools* [Rezultatet PISA 2015 (Vëllimi II): Politikat dhe Praktikrat për Shkollat e Suksesshme] Paris, i disponueshëm në <https://dx.doi.org/10.1787/9789264267510-en>

OBSH, 2013. *The European Mental Health Action Plan 2013–2020*. [Plani Evropian i Veprimit për Shëndetin mendor 2013-2020] Kopenhagë, i disponueshëm në http://www.euro.who.int/data/assets/pdf_file/0020/280604/WHO-Europe-Mental-Health-Acion-Plan-2013-2020.pdf

OBSH, 2018. *Primary health care in Albania: rapid assessment*. [Kujdesi shëndetësor parësor në Shqipëri : Vlerësim i shpejtë] Kopenhagë, i disponueshëm në https://www.euro.who.int/data/assets/pdf_file/0011/373718/alb-phc-ra-eng.pdf?ua=1

OBSH, 2020. *Assessment of sexual, reproductive, maternal, newborn, child and adolescent health in the context of universal health coverage in Albania* [Vlerësimi i shëndetit seksual, riprodhues, i nënave, foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve në kontekstin e mbulimit shëndetësor universal në Shqipëri].

OBSH, Banka e të Dhënave të Observatorit Botëror të Shëndetësisë, i disponueshëm në [Shkalla e vdekshmërisë nga vetëvrasia në Shqipëri](https://shkalla.e-vdekshmërisë-nga-vetëvrasia-në-shqipëri)

Pacara E., Kalemaj I., 2010. *Përpyjekjet e Shqipërisë për të arritur kriteret mjedisore të BE-së dhe perceptimi publik*. IPM. Tiranë, i disponueshëm në http://iep-al.org/docs/Albanias_Struggle_to_Meet_EU_Environmental_Criteria_and_Public_Perception.pdf

Pacara E., 2015. *Erozioni bregdetar në Shqipëri*. Instituti i Politikave Mjedisore, IPM Tiranë, i disponueshëm në <https://iep-al.org/test/wp-content/uploads/2016/02/Coastal-erosion-in-Albania.pdf>

Plaku A., 2020. *The Impact of COVID-19 on Women's and Men's Lives and Livelihoods in Albania Results of a Rapid Gender Assessment* [Ndikimi i COVID-19 në Jetët dhe Jetesën e Grave dhe Burrave në Shqipëri . Rezultatet e Vlerësimit të Shpejtë Gjinator]. UN Women. I disponueshëm në [The Impact of COVID-19 on Women's and Men's Lives and Livelihoods in Albania | UN Women – Albania](https://www.unwomen.org/en/stories/2020/12/the-impact-of-covid-19-on-women-s-and-men-s-lives-and-livelihoods-in-albania)

Plani i Veprimit për Covid-19 i disponueshëm në https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf

Psacharopoulos G., 2017. *Albania The Cost of Underinvestment in Education: And ways to reduce it*. [Shqipëri Kostoja e Investimeve të Ulëta në Arsim dhe Mënyrat për ta Reduktuar] UNICEF.

- Projekti Mario, 2010. *Raport vëzhgimi: shfrytëzimi i fëmijëve shqiptarë në situatë rruge në Kosovë* [Observation Report: Exploitation of Albanian Children in Street Situation in Kosovo. [Shfrytëzimi i Fëmijëve shqiptarë në Situatë Rruge në Kosovë], i disponueshëm në <https://www.slideshare.net/Tdinfancia/observation-report-exploitationofalbanianchildreninstreetsituationinkosovaoriginal>
- Qeveria e Shqipërisë, 2015. *National Action Plan for Integration of Roma and Egyptians in the Republic of Albania* [Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë] 2015–2020. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2016) Tiranë, i disponueshëm në https://www.rcc.int/romaintegration2020/download/docs/2015%20Action_Plan_Albania%202015%20
- Raport kombëtar i dorëzuar në përputhje me pikën 5 të shtojcës së Rezolutës së Këshillit të të Drejtave të Njeriut Nr. 16/21* Shqipëri. Shkurt 2019. I disponueshëm në <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx>
- Renditja Botërore e Universiteteve QS, e disponueshme në <https://www.topuniversities.com/qs-world-university-rankings>
- Rekomandimi i KM/Rec (2020)2 i Komisionit të Ministrave për Shtetet Anëtare për përfshirjen e historisë së Romëve dhe/ose Udhëtuesve në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore*, miratuar nga Komisioni i Ministrave më 1 korrik 2020, në mbledhjen e 1380 të Zëdhënësve të Ministrave, i disponueshëm në https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016809ee48c
- Rogers J., Sammon E., 2018. *We All Matter* [Të gjithë jemi të rëndësishëm]. UNICEF, Tiranë, i disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/reports/we-all-matter>
- Save the Children, 2009. *Keeping Children Out of Harmful Institutions: Why we should be investing in family-based care*. [Përse duhet të investojmë në kujdesin e bazuar në familje.] I disponueshëm në <http://www.savethechildren.org.se/3067>
- Save the Children, 2012. *Regional Report on Child Begging: Prevalence, Prevention and Suppression of Child Begging* [Raport Rajonal për Lypjen nga Fëmijët: Prevalenca, Parandalimi dhe Reduktimi i Lypjes nga Fëmijët]. Sarajevë, i disponueshëm në <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/regional-report-child-begging>
- Save the Children, 2018. *Children's World—A National Survey of Children's Well-Being* [Bota e Fëmijëve - Anketim Kombëtar i Mirëqenies së Fëmijëve] Save the Children, Universiteti Marin Barletti. Tiranë.
- Stephenson P., 2018. *Children's Consultations on Child Friendly Materials Albanian National Child Rights and Protection Law 18 Findings and Recommendations*. [Konsultimet e fëmijëve për materiale miqësore për fëmijët Ligji Kombëtar Shqiptar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 18 Gjetje dhe Rekomandime] UNICEF. Tiranë.
- Të dhëna shëndetësore, <https://shendetesia.gov.al/>
- Të dhënat e INSTAT-it për mbrojtjen sociale, të disponueshme në <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab2>
- Të Dhënat e Hendekut Gjini, <https://jp.weforum.org/reports/gender-gap-2020-report-100-years-pay-equality>
- Të dhënat e OECD-së për të Ardhurat Tatimore, të disponueshme në <https://data.oecd.org/tax/tax-revenue.htm>
- Të dhënat e Bankës Botërore, të disponueshme në <https://data.worldbank.org/indicator/SP.RUR.TOTL.ZG?locations=AL>
- Të dhënat e Bankës Botërore për ndryshimet klimatike, <https://www.worldbank.org/en/country/albania/brief/climate-change-in-albania>
- Të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara. Baza e të dhënave të Organit të Traktatit në https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=173&Lang=EN
- Terre des homes, 2020. *Report on the implementation of the Law no. 18/2017* [Raport për zbatimin e Ligjit Nr. 18/2017] BE, ANTTARC.
- Tomini F., Tomini S., 2019. *Can people afford to pay for health care? New evidence on financial protection in Albania. Summary. Summary* [A munden njerëzit të përballojnë kujdesin shëndetësor? Evidenca

- të reja për mbrojtjen financiare në Shqipëri.] Kopenhagë: Zyra Rajonale për Evropën e OBSH-së, e disponueshme në <https://www.euro.who.int/en/publications/abstracts/can-people-afford-to-pay-for-health-care-new-evidence-on-financial-protection-in-europe-2019>
- UNCRC, 2012. *61st Session Consideration of reports submitted by States parties under article 44 of the Convention. Concluding Observations: Albania* [Seanca e 61-të për shqyrtimin e raporteve të dorëzuara nga Shtetet Palë në kuadër të Nenit 44 të Konventës. Vëzhgime Përfundimtare: Shqipëri] [Aksesi i barabartë i fëmijëve në drejtësi, Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Azia Qendrore] Gjenevë.
- UNDP, Banka Botërore, 2010. *Albania, the New Growth Agenda: A Country Economic Memorandum* [Shqipëria: Agjenda e re e rritjes: Memorandumi Ekonomik i një Vendi]. Raport i Bankës Botërore Nr. 53599-AL. Uashington DC:
- UNDP, 2021. Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2020. *The next frontier - Human development and the Anthropocene* [Fronti i radhës: Zhvillimi Njerëzor dhe Antropoceni]. Nju Jork, i disponueshëm në [hdr2020.pdf \(undp.org\)](https://hdr2020.pdf(undp.org))
- UNDP, Banka Botërore, KE., 2017. *Regional Roma Survey—Albania* [Anketim Rajonal për Romët - Shqipëri]
- UNECE, 2018. *Environmental Performance Review of Albania Third Review* [Vlerësim i Performancës Mjedisore të Vlerësimit të Tretë të Shqipërisë]. Gjenevë, i disponueshëm në https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/epr/epr_studies/ECE.CEP.183_Eng.pdf
- UNHCR, 2020. *Albania Border Protection Monitoring 2019. Progressive overview* [Raport Monitorimi i Mbrojtjes së Kufijve 2019 Shqipëri: Përmbledhje progresive].
- UNHCR, 2020. *Asylum Seekers Dashboard 2020: Progressive overview* [Paneli i Azilkërkuesve 2020: Përmbledhje progresive].
- UNICEF, 2015. *Albania. Child Friendly Cities* [Shqipëri. Qytete miqësore me fëmijët]. Tiranë.
- UNICEF, Zyra Rajonale për CEE/CIS, 2015. *Children's Equitable Access to Justice, Central and Eastern Europe and Central Asia* UNICEF, Gjenevë
- Vathi Z. 2014. *Children and Adolescents on the Move Involved in Street Work in Albania and Kosovo: Transnational and Internal Patterns*. Fëmijët dhe Adolehentët në Lëvizje të Përfshirë në Punën e Rrugës në Shqipëri dhe Kosovë: Modelet transnacionale dhe të brendshme] Projekti Mario, i disponueshëm në http://tdh-europe.org/upload/document/7231/Mario_Albania_Kosovo_Web.pdf
- Vizard P., Burchardt T., Obolenskaya P., Shutes I., Battaglini M., 2018. *Child poverty and multidimensional disadvantage: Tackling "data exclusion" and extending the evidence base on "missing" and "invisible" children* [Varëfria e fëmijëve dhe disavantazhi shumëdimensional: Trajtimi i "përrjashtimit të të dhënave" dhe shtrirja e bazës së evidencave për fëmijët e "humbur" dhe të "padukshëm"] Raporti CASE 114. Shkolla Ekonomike e Londrës, shkurt 2018. Londër.
- Vrugtman L., Bino B., 2020. *Opinion Poll 2020: Trust in Governance Survey Report*. [Anketë opinioni 2020: Raport i Anketës së Besimit në Qeverisje] Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) Tiranë, e disponueshme në <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>
- Watson HL., Downe S., 2017. *Discrimination against childbearing Romani women in maternity care in Europe: a mixed-methods systematic review* [Diskriminimi ndaj grave romë në moshë riprodhimi në kujdes lindjeje në Evropë: shqyrtim sistematik me metoda të përziera]. I disponueshëm në Williamson J., Greenburg A., 2010. *Families not Orphanages*. [Familje, jo jetimore] Better Care Network, UNICEF. Gjenevë, e disponueshme në <http://www.crin.org/docs/FamiliesNotOrphanages.pdf>
- Wort M., Pupovci D., Ikononi E., 2019. *The Mid-term Appraisal of the Pre-University Education Strategy 2014–2020* [Vlerësimi Afatmesëm i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020]. Tiranë.
- Webometrics Ranking of World Universities* [Renditja Botërore e Universiteteve Webometrics], e disponueshme në <http://www.webometrics.info/en>
- Xhaho A., Tandili A., 2019. *Vulnerable Asylum Seekers and Irregular Migrants in Albania, Trends, Challenges, and Policy Solutions* [Azilkërkuesit e cenusshëm dhe Migrantët e Parregullt në Shqipëri, Trendet, Sfidat dhe Zgjidhjet e Politikave]. Dokument politikash, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë, i disponueshëm në https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2019/09/policy-brief_Vulnerable-asylum-seekers-and-irregular-migrants.pdf

unicef 

for every child